

A L B A N I A N

Basic Course

Volume VIII

Lessons 73 - 90

February 1969
Revised November 1982

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE
FOREIGN LANGUAGE CENTER

PREFACE

This is Volume 8 of the 10-volume Albanian Basic Course. It is the largest volume, containing 18 lessons. The subjects range from the seasons in Albania to the Korean War.

The format is a little different from previous volumes. Each lesson begins with a longer Dialogue than usual. This is because the Dialogue tells a story that would be incomplete if shortened. After reading the entire Dialogue, the student will be given approximately half of it to memorize.

The Dialogue is followed by a Grammar Review which has been added to refresh the student's memory.

Next is the Reading Text, the basis for the Dialogue. The student is expected to read this Text at home and come to class prepared to answer questions about it.

Each lesson concludes with two familiar parts: Homework and Vocabulary.

TABLE OF CONTENTS

Lesson		Page
73	THE CHESTNUT CLUB Features: The imperfect subjunctive preceded by simple past	1
74	THE PIPE AND THE DOG Features: Verbal nouns of the group ending with (<u>m</u>) <u>je</u> The present perfect tense of the admirative mode	15
75	TWO STORIES (one sad and one humorous) Features: Neuter nouns	30
76	RELIGIOUS HOLIDAYS IN ALBANIA Features: Review of fractions Some conjunctions that go with the subjunctive mode	43
77	THE EVIL MISER Features: Quasi-compounds The interrogative pronoun <u>çfarë</u>	56
78	A BAD JOKE Features: The present progressive	71
79	TRAPPED Features: The present indicative with the present subjunctive	82
80	A SAILOR LANDS IN NEW YORK Features: Direct and indirect speech	94
81	WINTER Features: Review of passive voice (verbs)	108

Lesson		Page
82	SPRING Features: Antonyms	120
83	THE RING Features: The present and past (perfect) conditional	132
84	THE FIRST SNOW Features: Prepositions and cases they take Prepositional phrases	143
85	THE WAR IN KOREA Features: The past and the future progressive	152
86	AUTUMN Features: The second and the third future forms	164
87	THE REWARD OF BEING SILENT Features: The usage of the participle <u>pa</u> with the present participle The declension of the Albanian indefinite noun followed by a possessive pronoun	176
88	THE BEAR'S HIDE Features: The optative mode A review of the formation of conditional sentences	187
89	PJERINI (PETER, PETE) Features: The indicative imperfect tense: for telling stories	198
90	SUMMER Features: Albanian idioms	209

Klubi i Kështejavet

1. A keni shumë punë në gazetën ku punoni, Zotni Treska?
Jo, unë jam i ngarkuem të shkruiej përralla për të qeshë në faqen e mbrendshme të gazetës.
2. Ç'keni përgatitë për nesër?
Kam tregue ngjarjen e "Klubit të Kështejavet". Sigurisht ju do t'a dini at përrallë!
3. Po, unë di shumë përralla, por këtë të Klubit të Kështejavet nuk më duket t'a kem ndigjue ndonjiherë.
Në Slloboví ekzistonte dikur Klubi i Kështejavet...
4. Anëtarët e të cilit merreshin me rritjen e kështejavet!
Jo, jo, anëtarët ishin njerëz të dijshëm; këta në rregulloren e tyne kishin caktue që, për t'u-pranue një anëtar i ri në Klub, ky duhet të tregonte një përrallë që asnjë prej tyne mos t'a kishte ndigjue ndonjiherë.
5. Po, po, e kam ndigjue shumë kohë më parë, por nuk më bje në mend fundi. Vazhdoni, ju lutem!
Kandidati fillonte me tregue përrallën e vet dhe, në qoftë se anëtarët e dijshin, ata i a pritshin fjalën në gojë tue bërtitë: "Kështejja, kështejja...!"
6. E kuptoj, kështu që kandidati të tregonte diçka tjetër.
Po. Një ditë prej ditësh u-paraqit i biri i një arkeologu të famshëm. Filloi të tregonte një përrallë që ai e mbante si të rrallë.
7. Mirëpo ata e kishin ndigjue dhe filluen me bërtitë: "Kështejja, kështejja...!"
Pikërisht ashtu ngjau dhe filloi një tjetër edhe më të rrallë, por edhe këtë herë u-ndigjue fjalët: "Kështejja, kështejja...!"

8. Natyrisht, filloi për të tretën herë...
- Po, por kësaj here ky deshi të tregonte diçka më fort për t'i tallë anëtarët se sa për të fitue të drejtën me u-bâ anëtar.
9. Duket se "kështejat" e anëtarëvet e kishin zemrue kandidatin!
- Filloi tue thënë se i ati e kishte pasë marrë me vete në një ekspedicion arkeologjik dhe se një ditë kishte pasë vendosë me i vizitue vetë piramidat e atij vendi.
10. D.m.th. pa t'anë?
- Po. Mandej vazhdoi: "Ishte terr e tue zbritë poshtë ndigjova një zâ që vînte si nëpër dhë. Desha me u-këthye nga frika, por m'erdhi turp".
11. Natyrisht, ai ngjarjen e tregon me fjalë të frikshme e me hollësi, për të tërhjekë vrejten e anëtarëvet.
- Ashtu âsht. Zbriti poshtë deri sa e gjeti vendin nga vînte zani. Luejti një rrasë vorri nga vendi dhe pà një mumje tue luejtë buzët e tue thënë: "Më këthe përmbys, më këthe përmbys!"
12. Vazhdoni, vazhdoni, tash më duket se po më bje në mend.
- "Pse donte mumja me u-këthye përmbys?" e pyetën anëtarët. "Edhe unë e pyeta mumjen" tha kandidati dhe ajo m'u-përgjegj: "Kështu që anëtarët e Klubit të Kështejavet të m'a puthin shpinën".
13. Të lumtë! Shumë e bukur dhe e preftë paska qenë tallja e kandidatit.
- Mirëpo anëtarët nuk u-zemruen aspak; përkundrazi të gjithë njizani e pranuen kandidatin si anëtar.

THE IMPERFECT SUBJUNCTIVE PRECEDED BY THE SIMPLE PAST

The imperfect tense of the subjunctive mode is used mostly with the simple past indicative mode.

Examples:

Ai deshë të tregonte përrallën, por ...
(He wanted to tell the story, but ...)

Filluen të bërtitshin me zë të naltë.
(They started to shout in a loud voice[s].)

Ai filloi të flitë, por ia prenë fjalë në gojë.
(He started to talk, but they interrupted him.)

In most cases, the subjunctive corresponds to the English infinitive.

If you see the simple past used with the present subjunctive sometimes, don't be discouraged. Grammar rules are occasionally broken in most languages.



Shë me dy hyrje, Lis, Mat

Në Sllobovf, ku ndodhin ngjarjet më të çuditshme të botës, ekzistonte edhe një klub, që quhesh "Klubi i Kështejavet". Për t'u-bâ anëtar i këtij klubi duhesh që kandidati të kallxonte një përrallë, të cilën, asnjë nga anëtarët e klubit mos t'a kishte ndigjue ndonjiherë. Po t'a kishin ndigjue ndonjiherë, bërtitshin të gjithë "Kështeja, kështeja, kështeja"!

Një kandidat u-paraqit në një mbledhje të përgjithshme të këtij klubi dhe i u-dha rasa me fillue t'a kallxojë përrallën e vet dhe filloi: "Zotni të ndershëm; ishem njëherë tue udhëtue më një kalë të bardhë dhe do të kalojshem një lumë. Kur u-afrova pranë bregut të...", por anëtarët e klubit bërtitën tue i a pré fjalën në gojë: "Kështeja, kështeja"!

Atëherë ky filloi një përrallë tjetër. "Kishte pasë qenë njëherë një grue që jetonte në një shpellë dhe...", por edhe një herë u-ndie zani i anëtarëve, që bërtitshin "Kështeja, kështeja"!

Më në fund, kandidati pak i mërzitun, i u-lut anëtarëve me i dhënë rasë t'a mbaronte së kallxuemi përrallën që do të tregonte tash, mbasi ishte një qind për qind i sigurtë se nuk e kishin ndigjue ndonjiherë, se i kishte ngjã atij vetë dhe se nuk i a kishte kallxue asnjë njeriu të gjallë. Dhe për të tretën herë filloi:

"Kur ishem i ri, im át më mori me vete në një ekspedicion arkeologjik n'Egjipt. Ndërsa im át punonte, vendosa

me vizitue një nga piramidat e atij vendi. Ishte terr, por kishem një kandil që lëshonte një dritë të zbetë e të vogël, sa të shifshem ku të vejshe kambën. Tue zbritë poshtë fillova me ndigjue një zâ që vinte si nëpër dhë. Sa më poshtë që zbritshem aq më i qartë vinte tue u-bâ zani. Mâ në fund fillova me i kuptue fjalët "Më këthe përmbys, më këthe përmbys!" dhe ky zâ më bante me u-dridhë nga frika. Desha me u-këthye, shtati më përqethesh e djersë të ftofta m'a kishin mbulue ballin, por mblodha veten dhe vijova me zbritë. Mbas një zbritje shumë të gjatë mrrijta te një vorr prej nga dukesh se dilte zani. Largova rrasën dhe tmeri e frika m'u-shtuen kur pashë buzët e një mumje që lëvizshin tue thënë "Më këthe përmbys, më këthe përmbys!" Tue mos dijtë çka të bëj i a preva fjalën në gojë tue e pyetë": "Pse"? Dhe mumja m'u-përgjegj menjherë: "Kështu që të gjithë anëtarët e Klubit të Kështejavet të vijnë dhe të m'a puthin shpinën".

Brohorí dhe duertrokitje të mëdhaja shpërthyen në sallën e mbledhjes dhe të gjithë njizani e pranuen kandidatin si anëtar.

QUESTIONS-PYETJE

A ekzistonte në Slloboví, ku ndodhin ngjarjet më të çuditshme të botës, edhe një klub, që quresh "Klubi i Kështejavet"? Çka ekzistonte në Slloboví, ku ndodhin ngjarjet më të çuditshme të botës? Ku ekzistonte edhe një klub, që

quhesh "Klubi i Kështejavet"? Si quhesh klubi që ek-
 zistonte në Sllobovf? Ku ndodhin ngjarjet më të çu-
 ditshme të botës? Për t'u-bâ anëtar i këtij klubi, a
 duhesh që kandidati të kallxonte një përrallë? Kush
 duhesh të tregonte një përrallë, për t'u-bâ anëtar i
 këtij klubi? Pse duhesh të kallxonte një përrallë
 kandidati? A duhesh që kandidati të tregonte një
 përrallë, të cilën asnjë nga anëtarët mos t'a kishte
 ndigjue ndonjiherë? Çfarë përralle duhesh të tregonte
 kandidati? Po t'a kishin ndigjue ndonjiherë, a bërtit-
 shin të gjithë "Kështeja, kështeja"? Çka bājshin të
 gjithë po t'a kishin ndigjue përrallën ndonjiherë? Qysh
 bërtitshin të gjithë po t'a kishin ndigjue përrallën
 ndonjiherë? A u-paraqit një kandidat në një mbledhje
 të përgjithshme të këtij klubi? Kush u-paraqit në një
 mbledhje të përgjithshme të këtij klubi? Cili u paraqit
 në një mbledhje të përgjithshme të këtij klubi? Çka
 bëni një kandidat? A i u-dha rasi me fillue t'a
 kallxojë përrallën e vet? Kujt i u-dha rasi me fillue
 t'a kallxojë përrallën e vet? Çka i u-dha rasi me bā
 kandidatit? A e filloi përrallën tue thānē: "Zotni të
 ndershēm; ishem njiherē tue udhētue më një kalē të
 bardhē dhe do të kalojshem një lumē"? Kush e filloi
 përrallën e vet tue thānē: "Zotni të ndershēm; ishem
 njiherē tue udhētue më një kalē të bardhē dhe do të
 kalojshem një lumē"? Qysh e filloi përrallën kandidati?


Çka ishte tue bâ njiherë kandidati? Çka do të kalonte ky? A filluen me bërtitë anëtarët "Kështeja, kështeja" kur kandidati vijoi tue thënë: "kur u-afrova pranë bregut të..."? Cilët filluen me bërtitë: "Kështeja, kështeja", kur kandidati vazhdoi tue thënë: "Kur u-afrova pranë bregut të..."? Çka bënë anëtarët kur kandidati vijoi tue thënë: "Kur u-afrova pranë bregut të..."? Kur filluen me bërtitë anëtarët? Atëherë a filloi ky një përrallë tjetër? Kush filloi atëherë një përrallë tjetër? Çka filloi atëherë kandidati? A e filloi përrallën me fjalët: "Kishte pasë qenë njiherë një grue që jetonte në një shpellë dhe..."? Qysh e filloi përrallën tjetër kandidati? Kush e filloi përrallën me fjalët: "Kishte pasë qenë njiherë një grue që jetonte në një shpellë dhe..." Por, a u-ndie edhe një herë zani i anëtarëve që bërtitshin "Kështeja, kështeja"? Çka u-ndie edhe një herë? Qysh bërtitshin anëtarët? Mâ në fund, kandidati pak i mërzitun, a i u-lut anëtarëve me i dhënë rasë t'a mbaronte së kallxuemi përrallën që do të tregonte tash? Kush i u-lut anëtarëve me i dhënë rasë t'a mbaronte së kallxuemi përrallën që do të tregonte tash? Qysh ishte kandidati, kur i u-lut anëtarëve me i dhënë rasë t'a mbaronte së kallxuemi përrallën që do të tregonte tash? A tha se ishte një qind për qind i sigurtë se nuk e kishin ndigjue ndonjiherë? Kush ishte një qind për qind i sigurtë se nuk e kishin ndigjue ndonjiherë? Cilët nuk e kishin ndigjue ndonjiherë përrallën që do të tregonte kandidati tash? A tha edhe se i kishte ngjã atij vetë e se nuk i a kishte tregue asnjë njeriu të gjallë? Kujt i kishte ngjã

e nuk i a kishte tregue asnji njeriu të gjallë? A filloi për të tretën herë me tregue se kur ishte i rí, i ati e mori me vete në një ekspedicion arkeologjik? Çka filloi të tregonte kandidati për të tretën herë? Kush e mori me vete, kur ishte i rí, në një ekspedicion arkeologjik? Kur e mori i ati me vete në një ekspedicion arkeologjik? Kë mori i ati me vete në një ekspedicion arkeologjik në Egjipt? Ku e mori i ati me vete kandidatin kur ishte i rí? Ndërsa i ati punonte, a vendosi me vizitue një nga piramidat e atij vendi? Çka vendosi me bâ, ndërsa i ati punonte? Kur vendosi ai me vizitue një nga piramidat e atij vendi? Mbasi ishte terr, a kishte një kandil që lëshonte një dritë të zbetë sa të shifte ku të vente kambën? Pse kishte me vete një kandil? Çfarë drite lëshonte kandili? Tue zbritë poshtë, a filloi me ndigjue një zâ që vñte si nëpër dhé? Kur filloi me ndigjue një zâ që vñte si nëpër dhé? Çka filloi me ndigjue tue zbritë poshtë? A vñte tue u-bâ mâ i qartë zani, sa mâ poshtë që zbritte? Qysh vñte tue u-bâ zani, sa mâ poshtë që zbritte? Mâ në fund, a filloi me i kuptue fjalët "Më këthe përmbys, më këthe përmbys"? Kur filloi me i kuptue fjalët "Më këthe përmbys, më këthe përmbys"? Çka filloi me kuptue ky, mâ në fund? A e bante ky zâ me u-dridhë nga frika? Çka e bante me u-dridhë nga frika? A deshi me u-këthye mbasi shtati i përqethesh e djersë të ftofta i a kishin mbulue ballin? Pse deshi të këthehesh? A e mblodhi veten dhe vazhdoi me

zbritë? Çka bëni ai? Mbas një zbritje të gjatë, a mrrijti te një vorr prej ku dukesh se dilte zani? Kur mrrijti te një vorr prej nga dukesh se dilte zani? Ku mrrijti mbas një zbritje të gjatë? A e largoi rrasën e vorrit? Cilën rrasë largoi? A i u-shtuen tmeri dhe frika kur pa buzët e një mumje që lëvizshin tue thënë: "Më këthe përmbys, më këthe përmbys!" Kujt i u-shtuen tmeri dhe frika kur pa buzët e një mumje që lëvizshin tue thënë: "Më këthe përmbys, më këthe përmbys!" Kur i u-shtuen tmeri dhe frika? Tue mos dijtë çka të bëjë, a i a preu fjalën në gojë tue e pyetë: "Pse"? Kush i a preu fjalën në gojë tue e pyetë: "Pse"? Pse i a preu fjalën në gojë tue e pyetë: "Pse"? A u-përgjegj mumja menjherë: "Kështu që të gjithë anëtarët e Klubit të Kështejavet të vijnë e të m'a puthin shpinën"? Kush u-përgjegj menjherë: "Kështu që të gjithë anëtarët e Klubit të Kështejavet të vijnë e të m'a puthin shpinën"? Qysh u-përgjegj mumja? A shpërthyen në sallën e mbledhjes brohorit dhe duertrokitje të mëdhaja porsa kandidati e mbaroi përrallën së kallxuemi? Ku shpërthyen brohorit dhe duertrokitje të mëdhaja porsa kandidati e mbaroi përrallën së kallxuemi? Çka shpërtheu në sallën e mbledhjes porsa kandidati e mbaroi përrallën së kallxuemi? A e pranuen të gjithë njizani si anëtar? Cilët e pranuen kandidatin si anëtar? Kë pranuen si anëtar të gjithë njizani?

Translate the following sentences into Albanian:

1. He had fallen face down.
2. It was dark when I entered the house.
3. I found the oil lamp on the small table.
4. They wanted to move, but they couldn't.
5. My body was covered with sweat.
6. I started to shiver; I had a pain in my back.
7. This has never happened to me.
8. What's her age? (Use the Albanian noun for "age.")
9. Please don't interrupt me!
10. She doesn't remember the end of the story.



Tumë ilire pas gërmimit - Kënetë (Kukës)



Ojnohe bronxi dhe fibul ilire prej bronxi
hekurit)

arkeolog, -u arkeologë, -t	(m.)	archaeologist
brohori, -t	(f.)	cheers, acclamation
i, të çuditshëm e, të çuditshme	(adj. m. & f.)	strange, odd; surprising
me u-dashë (më, të, i etj. duhet)	(v.)	to have to...; to be necessary
i, të dijshëm e, të dijshme	(adj. m. & f.)	wise, learned
dikur	(adv.)	long time ago; some day (in the future)
djersë, -a djersë, -t	(f.)	sweat, perspiration
e drejtë, -a të drejta, -t	(f.)	right, justice; truth
me u-dridhë (unë dridhem)	(v.)	to shiver, tremble
duertrokitje, -t	(f. pl.)	applause
me u-dhënë (unë epem)	(v.)	to be given
ekspedicion, -i ekspedicione, -t	(m.)	expedition
me ekzistue (unë ekzistoj)	(v.)	to exist
i, të frikshëm e, të frikshme	(adj. m. & f.)	frightful; coward
i, e, të gjallë të gjalla	(adj. m. & f.)	alive, living; lively, active
hollësi, -ja hollësi, -t	(f.)	thinness, fineness; in pl. details
të kallxuem, -it	(neut.)	narrating; telling
kandil, -i kandila, -t	(m.)	oil lamp, lantern

kështejë, -a kështreja, -t	(f.)	chestnut
me u-lutë (unë lutem)	(v.)	to beg, ask for; to pray
me mbledhë (unë mbledh)	(v.)	to gather, collect; to pick (fruit, flowers, etc.); to add (arithmetic)
me mbledhë veten (unë mbledh veten)	(v.)	to pull oneself together
mumje, -a mumje, -t	(f.)	mummy
ndërsa	(adv.)	while; whereas
me u-ndie (unë ndihem)	(v.)	to be heard; to feel
me u-paraqitë (unë paraqitem)	(v.)	to report to; to introduce oneself; to be introduced
me u-përgjegjë (unë përgjegjem)	(v.)	to answer, reply
përmbys	(adv.)	face down, upside down
me u-përqethë (unë përqethem)	(v.)	to shudder, shiver
pikërisht	(adv.)	exactly
piramidë, -a piramida, -t	(f.)	pyramid
i, e, të preftë të prefta	(adj. m. & f.)	sharp
me puthë (unë puth)	(v.)	to kiss
i, e, të qartë të qarta	(adj. m. & f.)	clear; evident, obvious
rasë, -a rasa, -t	(f.)	occasion, chance, opportunity, case; case (gram.)

LESSON 73

rrasë, -a rrasa, -t	(f.)	slab, slate (flat piece of stone)
rritje, -a	(f.)	breeding, rearing, raising, growing cultivation
me shpërthye (unë shpërthej)	(v.)	to break out, break in, burst out, erupt; to disintegrate; to unbutton
shpinë, -a shpina, -t	(f.)	back, spine
shtat, -i	(m.)	body
me u-shtue (unë shtohem)	(v.)	to accrue, grow, increase, multiply
me tallë (unë tall)	(v.)	to laugh at..., make fun of..., tease
tallje, -a tallje, -t	(f.)	mockery, teasing, joke
terr, -i	(m.)	darkness, dark
me tërhjekë vrejtjen (unë tërhjek vrejtjen)	(v.)	to draw one's attention; to reprimand
tmër, -i	(m.)	terror
me vijue (unë vijoj)	(v.)	to continue
vorr, -i vorre, -t	(m.)	tomb, grave
njizani	(adv.)	unanimously
i, e, të zbetë të zbeta	(adj. m. & f.)	pale; dim
<u>Shënime:</u>		
me pré fjalën (në gojë) (unë pres fjalën)	(v.)	to interrupt (speaking)

nji ditë prej ditësh

one day

kishte pasë qenë njëherë


once upon a time
there was a....

me rá në mend (v.)
(më, të, i etj. bje
në mend)

to remember,
recall

me ardhë turp (v.)
(më, të, i etj. vjen
turp)

to be ashamed; to
be shy



**THE
MONUMENTAL
FOUNTAIN**

Çibuku e Qeni

1. Hyp këtu, pse po shkon aq larg?
Nga dritorja pashë të shkrue-
me se n'at vagon është i
lejuem të pimit e duhanit.
2. Atëherë duhet të shkojmë deri në fund të trenit; zakonisht, aty e lidhin vagonin për pasagjerët që nuk e pijnë duhanin.
S'kemi çka të bëjmë, duhet të shkojmë deri atje, sepse nuk e duroj tymin e duhanit.
3. As unë nuk e pij duhanin, por mue nuk më trazon aspak tymi.
A e di përrallën e zojushës dhe të qenit?
4. Jo, m'a kallxo!
Po, por prit sa të hypim e të zëmë vend.
5. Qe, ky duhet të jetë vagoni ynë.
Qenka pothuejse bosh!
6. Tash që i rregulluem valixhet, m'a trego përrallën!
Nji zojushë, me nji qen në prehën, u-ul në tren pranë nji studenti që po pinte çibuk.
7. Kur pá se studenti po pinte çibuk zojusha u-largue...
Jo, i tha studentit të largohesh, mbasi tymi nuk i pëlqente qenit.
8. A tha me të vërtetë kështu?
Po, bile foli në nji mënyrë të pakëndshme.
9. Ç'bâni studenti?
Ai s'luejti prej vendit, por filloi me e thithë çibukun edhe mâ me forcë, tue qitë tym për hundësh e për goje.
10. A ishte i lejuem të pimit e duhanit n'at vagon?
Tamam at gjâ i theksoi studenti, d.m.th. të shkante në nji vagon tjetër, por ajo i a kapi çibukun dhe i a hodhi nga dritorja.

11. Zojusha s'paska qenë fort e sjellshme!
12. Po studenti çka bânî?
13. I shkreti qen!
14. A mos deshën vallë t'a hjedhin studentin nga dritorja?
15. Dhe zojusha zbriti të merrte qenin dhe studenti çibukun...
16. Sigurisht se po: çibuku!
17. Çka tjetër mund t'ishte?
18. Nga e gjithë kjo ngjarje më vjen keq për qenin e pafajshëm.
19. Shpresoj mos të na ulet afër ndonji student me çibuk!
- Ishte nga ato grát pak të shkueme në moshë dhe të pamartueme.
- Ai, pa bâ as nji as dy, kapi qenin dhe e hodhi po nga ajo dritore.
- Zojusha filloi të shante, të bërtitte e të qante dhe të gjithë u-çuen më kambë dhe i u-afruen studentit.
- Ndoshta, por për fat të mirë, n'at çast treni mrrijti në stacion dhe u-ndal.
- Jo. Të gjithë zbritën tue shikue nga fundi i trenit dhe panë qenin tue ngá në drejtim të tyne; diçka i varesh prej gojës. A mund t'a marrish me mend se çka ishte ajo gjâ që varesh?
- Ashtu kujtuen edhe të tjerët.
- Gjuha e vet!
- Treni po lëviz; na qoftë udha e mbarë!
- Na s'kemi qen, por mund të na i hjedhi valixhet nga dritorja.

VERBAL NOUNS OF THE GROUP ENDING WITH (m)je

1. This is an important noun group which we covered in the previous volume. Because of its importance, we will review it for reinforcement and retention.

Nouns derived from verbs ending in single long vowels (such as a, e, i, u, y, and the diphthong ye) are formed by adding the suffix (m)je to the infinitive.

Example:

me lá	(to wash)	lamje	(washing)
me pré	(to cut)	premje	(cutting)
me shkri	(to melt, smelt)	shkrimje	(melting, smelting)
me pru	(to bring)	prumje	(bringing)
me ndërhy	(to interfere)	ndërhyemje	(interference)
me fye	(to insult)	fyemje	(insult)

Actually the suffix je (without the m) could be attached to almost any infinitive ending in a consonant to form a noun.

So we see once again that the verb is a very important and productive part of speech.

THE PRESENT PERFECT TENSE OF THE ADMIRATIVE MODE

2. As we learned before, Albanian has a verb mode (or mood) that English doesn't: the mode of surprise or the "admirative" mode (an English misnomer).

It usually has two tenses: present (which we already know) and present perfect.

The present perfect tense is used with the auxiliary verbs paskam, "to have," or genkam, "to be," in the present tense admirative or surprise mode, plus the infinitive (participle) of the verb you want to use.

For example, you have opened your window to see snow on the ground. If it was unexpected and you were surprised, you might exclaim: Paska ra bore! "Why it has snowed!"

If you happened to be at the scene of a murder, you wouldn't say: Ky njeri ka vdeke, "This man has died/is dead," unless you had some previous knowledge about his death. In this case, the Albanian police might like to question you. But we shall presume that you know nothing about it and want to go home; then you might say: Ky njeri paska vdeke! "Oh, this man is really dead!"



Partial view of the Shkodra fortress, one of the oldest Albanian castles.

Në një qytet të vogël, jo shumë larg Bostonit, banonte Nexhati me prindët e tij. Nexhati ndiqte një shkollë mjeshtrish në Boston. Çdo mëngjes, merrte trenin për të shkue në shkollë. Kishte zgjedhë degën e zdrukthëtaris. Kishte vendosë me u-bâ zdrukthëtari më i mirë i asaj krahine. Ishte i pari i klasës si në teori ashtu edhe në praktikë. E kishte marrë me qejf punën dhe nuk i vinte aspak e rëndë. Kishte fillue të blente edhe veglat më të mira. Kishte blé disa zdruktha, sharra, turjela etj., të cilat i ruente si shtë e ballit dhe kujdesohesh shumë për to.

I ati kishte një dyqan ku shitte vaj, benzinë dhe pjesë të ndryshme automobilash. Ishte mjaft i pasun.

Nexhatit i kishte hë në krye edhe me mësue me pë çibuk, dhe kur merrte trenin, shkonte në vagonin ku të pimit e duhanit ishte i lejuem. Nxirte kutin e duhanit dhe mbasi e mbushte çibukun mirë e mirë, e ndizte tue e thithë me të gjithë fuqin e mushkënvet të tija. Nganjihërë i kalonte tymi përtej fytit dhe kollesh, por, megjithatë, s'hiqte dorë. I ishte mbushë mendja me e mësue. I dukesh vetja sikur t'ishte një njeri me rëndësi me çibuk.

Një ditë, u-ul pranë tij një zojushë, pak e shkueme në moshë, e cila mbante një qen në prehën. Porsa u-ul i tha, në një mënyrë të pakëndshme, mos të pinte duhan sepse nuk i pëlqente qenit. Mbasi nuk i pëlqeu as mënyra e të folunit dhe as zojusha, i tha vetëm se mbasi nuk i pëlqente qenit

duhani, mund të shkonte në një vagon ku pimja e duhanit ishte e ndalueme, dhe vijoi me e thithë çibukun edhe më me forcë, tue qitë tym për hundësh e për goje.

Zojusha s'luejti prej vendit. I tha edhe një dy herë tjera mos të pinte duhan, po n'at mënyrë e po me at zâ, por Nexhati nuk u vûni vesh fjalëvet të saja. Ishte zani i një njeriu që mëninte (urrente) çdo gjâ që u epte gëzim të tjerëve dhe prandej, ai jo vetëm që nuk i ishte bindë, por ishte mundue me bâ të kundërtën.

Pak para se të mrrînte treni në stacion, zojusha tue e pasë humbë durimin, i a hoqi studentit çibukun prej gojës dhe i a hodhi jashtë nga dritorja. Studenti për pak kohë mbeti shtang, por mandej s'bâni as një as dy, kapi qenin dhe e hudhi jashtë prej dritores. Zojusha filloi të bërtitte e të shante. Të gjithë u-çuen më kambë, filloi një shamatë e një zhurmë e madhe dhe zojusha kishte fillue me qá. Ndërsa pasagjerët i kërkojshin spiegime studentit, treni u-ndal. Kishte mrrîjtë në stacion. Zbritën të gjithë tue shikue në drejtim prej nga kishte ardhë treni. Kur, çka me pá! Qeni ishte tue ngá në drejtim të tyne e prej gojës së tij shifesh një gjâ që varesh përjashta: ishte ...gjuha.

QUESTIONS-PYETJE

A banonte Nexhati me prindët e tij në një qytet të vogël, jo shumë larg Bostonit? Prej cilit qytet nuk ishte larg qyteti i vogël, në të cilin banonte Nexhati me prindët e tij? Ku banonte Nexhati me prindët e tij? A ndiqte Nexhati një

shkollë mjeshtrish në Boston? Ku gjindesh shkolla që ndiqte Nexhati? Çfarë shkolle ndiqte Nexhati? A merrte trenin çdo mëngjes për të shkue në shkollë? Çka merrte Nexhati çdo mëngjes për të shkue në shkollë? Sa herë në javë e merrte trenin Nexhati? A kishte zgjedhë degën e zdrukthëtaris? Çfarë dege kishte zgjedhë? A kishte vendosë me u-bâ zdrukthëtari mâ i mirë i asaj krahine? Çka kishte vendosë me u-bâ Nexhati? Kishte vendosë me u-bâ zdrukthëtari mâ i mirë i cilës krahinë? A ishte i pari i klasës si në teori ashtu edhe në praktikë? Ishte i pari i klasës si në teori ashtu edhe në çka tjetër? Në çka ishte Nexhati i pari i klasës? A e kishte marrë me qejf punën? Çka kishte marrë me qejf? A i vînte ndopak e rândë? Pse nuk i vînte aspak e rândë puna? A kishte fillue të blente edhe veglat mâ të mira? Çka kishte fillue të blente? Çka kishte fillue të bânte? A kishte blé disa zdruktha, sharra, turjela etj.? Çka kishte blé? A i ruente këto si sÿt e ballit? Qysh i ruente? A kujdesohesh shumë për to? Sa vegla kishte blé? Si kujdesohesh për to? A kishte i ati një dyqan? A shitte voj, benzinë dhe pjesë të ndryshme automobilash? Kush kishte një dyqan ku shitte voj, benzinë dhe pjesë të ndryshme automobilash? Çka kishte i ati? Çka shitte i ati n'at dyqan? A ishte mjaft i pasun? Kush ishte mjaft i pasun? A i kishte hÿ në krye Nexhatit me mësue me pÿ çibuk? Kujt i kishte hÿ në krye me mësue me pÿ çibuk? Çka i kishte hÿ në krye Nexhatit me mësue? Kur merrte trenin, a shkonte në një vagon ku të pimit e duhanit ishte i lejuem?

Në cilin vagon shkante Nexhati kur merrte trenin? A e nxirte kutin e duhanit dhe e mbushte çibukun mirë e mirë? Kush e nxirte çibukun dhe e mbushte mirë e mirë? Çka bante ai dhe e mbushte çibukun mirë e mirë? Qysh e mbushte çibukun? Mbasi e mbushte, a e ndizte tue e thithë me të gjithë fuqin e mushkënavet të tija? Çka bante Nexhati porsa hynte në vagonin ku të pimit e duhanit ishte i lejuem? A i kalonte tymi përtej fytit nganjherë? Pse kollesh Nexhati? Çka i kalonte përtej fytit nganjherë dhe kollesh? Por, megjithatë, a hiqte dorë? Nga çka nuk hiqte dorë Nexhati? Pse nuk hiqte dorë? A i ishte mbushë mendja me e mësue? Çka i ishte mbushë mendja me mësue? A i dukesh vetja sikur t'ishte një njeri i rëndësishëm me çibuk? Qysh i dukesh vetja me çibuk? A u-ul pranë tij, një ditë, një zojushë pak e shkueme në moshë? Kush u-ul pranë tij një ditë? A ishte e ré zojusha që u-ul pranë tij një ditë? A mbante zojusha në prehën një qen? Çka mbante në prehën zojusha? A i tha, porsa u-ul mos të pinte duhan? A i a tha këto fjalë në një mënyrë të pakëndshme? Në çfarë mënyrë i a tha këto fjalë zojusha? A i tha mos të pinte duhan se nuk i pëlqente qenit? Çka i tha Nexhatit zojusha? Pse i tha mos të pinte duhan? A i pëlqeu Nexhatit mënyra e të folunit? Po zojusha, a i pëlqeu? Çka nuk i pëlqeu Nexhatit? A i u-përgjegj Nexhati se mbasi nuk i pëlqente qenit duhani, mund të shkante në ndonjë vagon ku pimja e duhanit ishte e ndalueme? Ku i tha zojushës me shkue? Pse i u-përgjegj në këtë mënyrë? Si i u-përgjegj zojushës Nexhati? A vijoi me e thithë çibukun edhe më me forcë tue qitë tym për

hundësh dhe për goje? Çka vazhdoi me bâ Nexhati? Qysh
 vazhdoi me e thithë çibukun? Nga qitte tym? A luejti zojusha
 prej vendit? Prej nga nuk luejti zojusha? A i tha edhe nja dy
 herë tjera mos të pinte duhan? Kujt i tha edhe nja dy herë
 tjera mos të pinte duhan? A i tha po n'at mënyrë e po me at
 zâ? Në ç'mënyrë i tha edhe nja dy herë tjera mos të pinte
 duhan? A u vûni vesh fjalëvet të saja Nexhati? Cilave fjalë
 nuk u vûni vesh Nexhati? A ishte zani i nji njeriu që mëninte
 çdo gjâ që u epte gëzim të tjerëve? Kush urrente çdo gjâ që
 u epte gëzim të tjerëve? Zani i çfarë njeriu ishte? A i
 ishte bindë Nexhati urdhënit të zojushës? Për çfarë arsyeje
 nuk i ishte bindë Nexhati zojushës? A ishte mundue me bâ të
 kundërtën? Jo vetëm që nuk i ishte bindë, por ishte mundue
 me bâ çka? Pse ishte mundue me bâ të kundërtën? A e humbi
 durimin zojusha? Çka humbi zojusha? A i a hoqi studentit
 çibukun prej gojës dhe i a hodhi jashtë nga dritorja? Çka i
 hoqi studentit prej gojës dhe i a hodhi jashtë nga dritorja?
 Pak para se të mrrînte treni në stacion, a i a hoqi studentit
 çibukun prej gojës dhe i a hodhi jashtë nga dritorja? A i a
 hodhi çibukun jashtë nga dritorja mbasi e pati humbë durimin?
 Çka i hoqi prej gojës studentit zojusha? Ku i a hodhi çibukun?
 Pse e bâni kët gjâ zojusha? Çka bâni zojusha mbasi e pati
 humbë durimin? A mbeti shtang studentit për pak kohë? Si
 mbeti studentit për pak kohë? Kush nuk bâni as nji as dy, kapi
 qenin dhe e hodhi jashtë prej dritores? Çka hodhi jashtë prej
 dritores studentit? Ku e hodhi studentit qenin? A filloi të
 bërtitte e të shante zojusha? Çka filloi të bânte zojusha?

A u-çuen të gjithë më kambë? Kush u-çue më kambë? A filloi
 një shamatë e një zhurmë e madhe? Ku filloi një shamatë e një
 zhurmë e madhe? A kishte fillue me qá zojusha? Kush kishte
 fillue me qá? Çka kishte fillue me bâ zojusha? A u-ndal
 treni ndërsa pasagjerët i kërkoshin spjegime studentit? Çka
 u-ndal ndërsa pasagjerët i kërkoshin spjegime studentit?
 Çka ngjau ndërsa udhëtarët i kërkoshin spjegime studentit?
 A kishte mrrijtë treni në stacion? Çka kishte mrrijtë në
 stacion? Ku kishte mrrijtë treni? A zbritën të gjithë?
 Çka bënë të gjithë? A zbritën të gjithë tue shikue në
 drejtim prej nga kishte ardhë treni? Të gjithë zbritën tue
 bâ çka në drejtim prej nga kishte ardhë treni? Në cilin
 drejtim ishin tue shikue të gjithë? A e panë qenin tue ngá
 në drejtim të tyne? Çka panë tue ngá në drejtim të tyne?
 A shifesh një gjâ që varesh përjashta gojës së qenit? Çka
 shifesh që varesh përjashta gojës së qenit? A u-çuditën
 njerzit kur e panë qenin tue ngá në drejtim të tyne? A
 u-çuditën edhe mâ tepër kur panë se prej gojës së tij shifesh
 një gjâ që varesh përjashta? A ishte çibuku që varesh për-
 jashta gojës së qenit? Çka ishte? A ishte çibuku, apo gjuha
 e tij që varesh përjashta? A kujtuen një herë të gjithë se
 ishte çibuku?

Translate the following sentences into Albanian:

1. This is one of the most beautiful sights I have ever seen.
(Use the verbal noun ending in (m)je.)
2. In this region, there isn't a single good cabinetmaker.
3. My car needs oil and gasoline.
4. In that shop they sell saws and planes.
5. The smoke could be seen beyond the hill.
6. Why, he is not here; he has gone!
7. I don't hate anybody.
8. The traveler started to scold me without having any reason.
9. Do you have some milk?
10. I want to go abroad.



Kullë kala, Patin, Mat Fotot: Autori

PJESA E PESTË
FJALORI

LESSON 74
PART V
VOCABULARY

benzinë, -a	(f.)	gasoline
bile	(conj.)	as a matter of fact
me u-bindë (unë bindem)	(v.)	to be convinced, persuaded; to obey
çast, -i çaste, -t	(m.)	instant, moment
durim, -i	(m.)	endurance, patience
për fat të mirë	(adv.)	fortunately
të folun, -it	(neut.)	speaking, talking
gëzim, -i gëzime, -t	(m.)	joy, pleasure
me hjedhë (unë hjedh)	(v.)	to throw, toss
me u-kollë (unë kollen)	(v.)	to cough
i, të lejuem e, të lejueme	(adj. m. & f.)	permissible, allowed
me mbetë shtang (unë mbes shtang)	(v.)	to be dumbfounded, petrified, stunned
megjithatë	(conj.)	nevertheless
me mëni (unë mënij)	(v.)	to hate
me u-mundue (unë mundohem)	(v.)	to try, make an effort, struggle
me ndezë (unë ndez)	(v.)	to light, ignite; to turn on (a light, a stove, an engine, etc.)
i, të pafajshëm e, të pafajshme	(adj. m. & f.)	innocent

LESSON 74

i, të pakândshëm e, të pakândshme	(adj. m. & f.)	unpleasant
i, të pamartuem e, të pamartueme	(adj. m. & f.)	unmarried
pasagjer, -i pasagjerë, -t	(m.)	passenger
të pîm, -it	(neut.)	drinking; smoking
pimje, -a	(f.)	drinking; smoking
prehën, prehni	(m.)	lap
me ruejtë si sÿt e ballit (unë ruej si sÿt e ballit)	(v.)	to take good care of; to guard jealously
i, të sjellshëm e, të sjellshme	(adj. m. & f.)	well-behaved, well- mannered, of good conduct
spiegim, -i spiegime, -t	(m.)	explanation
shamatë, -a shamata, -t	(f.)	brawl, row, argument; noise
sharrë, -a sharra, -t	(f.)	saw
i, e, të shkretë të shkreta	(adj. m. & f.)	poor, wretched, miserable; deserted, abandoned
i, të shkruem e, të shkrueme	(adj. m. & f.)	written
me trazue (unë trazoj)	(v.)	to bother, disturb; to agitate, mix, stir
turjelë, -a turjela, -t	(f.)	drill (borer)
tym, -i	(m.)	smoke

me theksue (unë theksoj)	(v.)	to stress, emphasize
me thithë (unë thith)	(v.)	to suck, draw, puff
vagon, --i vagona, -t	(m.)	train car
me vû vesh (unë vë vesh)	(v.)	to pay attention
me zënë vend (unë zâ vend)	(v.)	to take a seat; to take up residence; to stay; to take up room (space)
zdrukth, -i zdruktha, -t	(m.)	plane (tool); pl., shavings
zdrukthëtar, -i zdrukthëtarë, -t	(m.)	cabinetmaker
zdrukthëtarí, ja	(f.)	cabinetwork
 <u>Shënime:</u>		
i, të shkuem në moshë e, të shkueme në moshë		advanced in age
pa bâ as një as dy		at once, immediately
me marrë me mend (unë marr me mend)	(v.)	to guess, imagine
Të, i etj. qoftë udha e mbarë!		Have a nice trip!
me marrë me qejf (diçka) (unë marr me qejf diçka)	(v.)	to enjoy doing something
me ardhë e rëndë (më, të, i etj. vjen e rëndë)	(v.)	to find something hard (to do)
me hÿ në krye (më, të, i etj. hÿn në krye)	(v.)	to have a fixed idea; to have an obsession

me hjekë dorë
(unë hjek dorë)

(v.)

to give up

me u-mbushë mendja
(më, të, i etj. mbushet
mendja)

(v.)

to make up one's
mind; to be
convinced

I dukesh vetja njeri i rëndësishëm.

He thought he was an
important person.

Kur, çka me pá!

When/what do I
(we, they) see!



Kalá dibrance

Dy Përralla

1. Si mund t'a kalojmë kohën mbasi berberi qenka zânë? Ti më kallxo një përrallë mue e unë po të tregoj një përrallë t'ý deri sa të na vijë radha.
2. Mirë, fillo ti! Kishte pasë qenë njëherë një druvar e ndërsa po kalonte një lumë i rá sëpata n'ujë.
3. Dhe rryma i a mori me vete... Po, atëherë filloi me qá e me fshâ nga dëshpërimi.
4. Paska qenë shumë i vorfën! Perendija i ujnavet pati mëshirë për të dhe i prûni një sëpatë ari.
5. Kjo do të thotë se fat-keqësija vjen nganjherë edhe për të mirë. Mirëpo ai nuk e pranoi, tue thânë se ajo sëpatë nuk ishte e tija. Atëherë Perendija i prûni një sëpatë argjendi.
6. As atë s'e deshi? Jo; së fundi i dha të tijën dhe druari bërtiti me gëzim: "Kjo është sëpata ime". Perendija pá se druari ishte i ndershëm dhe i drejtë e i a fali të trija sëpatat. Tash fillo ti!
7. Njutoni, matematikani i famshëm, kishte një maçok të madh e një të vogël. A është e nevojshme t'i dallojsh maçokët se njëni ishte i madh dhe tjetri i vogël?
8. Po, po! E nga kjo ngjarje provohet se edhe kryet e njerëzvet të mëdhaj nganjherë është bosh. Mos harro se kjo është një përrallë e jo një ngjarje.
9. Dacat flêjshin në grunár dhe çdo mëngjes e çdo mbrâmje Njutoni ishte i detyruem t'u a hapte derën. Me fjalë tjera Njutoni ishte i bezdisun prej dacavet.

10. Vendosi, pra, që në derë të grunarit të bante dy bira: një të madhe e një të vogël dhe ti e merr vesh pse. Po, që ducat të hËjshin e të dilshin pa qenë nevoja me shkue me u a hapë derën.
11. Mirë! As ti nuk u-kujtove. Posa mbaroi të çelunit e biravet i erdhi për vizitë një mik. Si quhesh miku i tij?
12. S'ka rëndësi! I tregoi mikut hallin që kishte pasë dhe me krenari punën që kishte bâ. Pse me krenari?
13. Sepse ai nuk ishte zdrukthë-târ! Dhe menjherë miku i a priti: "Pse ke bâ dy bira? Edhe maçoku i vogël mund të kalonte nëpër vrimë të madhe". Au! Nuk i vËna mend mirë përrallës sate, sepse do t'ishem kujtue.

ARTI I LASHTE I MASKAVE



NEUTER NOUNS

This is a continuation of Lesson 57, pp. 69-70.

In Albanian, there are only a few neuter nouns that are derived from verbs. They are mainly abstract nouns. For example: *Zakon*

Zakonisht nji mendim i bukur del nga të menduemit thellë.
(A good idea usually comes out of deep thinking.)

Here the idea or thought is the result of thinking.

Neuter nouns are usually declined in the nominative and ablative cases. For example:

Të nuhatunit e ca kafshëve është më i mprehtë se ai i njerëzvet.
(Some animals' sense of smell is sharper than that of humans.)

But in the sentence *Ai e mbaroi përrallën së kallxuemi*, "He finished telling the story," së kallxuemi is in the ablative case, indefinite singular.

Here is a list of neuter nouns with their corresponding verbal nouns, masculine and feminine.

Verbs	Verbal nouns (m. & f.)	Verbal nouns (neut.)
<i>me pá</i>	<i>pamje</i> (f.) (sight)	<i>të pamit</i> (seeing)
<i>me pí</i> (to drink)	<i>pimje</i> (f.) (drinking)	<i>të pimit</i> (drinking)

Verbs	Verbal nouns (m. & f.)	Verbal nouns (neut.)
me ndigjue (to listen, to hear)	ndigjim (m.) (listening, hearing)	të ndigjuemit (listening, hearing)
me folë (to speak, to talk)	folje (f.) (verb)	të folunit (speaking, talking)
me mendue (to think)	mendim (m.) (thought, opinion)	të menduemit (thinking, contemplation)
me shijue (to taste)	shijim (m.) (tasting)	të shijuemit (tasting)
me nuhatë (to sniff)	nuhatje (f.) (sniffing, smelling, sense of smell)	të nuhatunit (sense of smell)
me prekë (to touch)	prekje (f.) (touch, touching)	të prekunit (touch, touching)

Nji katundari i rá sèpata në lumë. Prej idhnimit u-ul në breg të lumit dhe filloi me qá. Zoti i ujnavet e ndigjoi vajin e tij dhe, mbasi pati dhimbë për têt, i prûni një sèpatë ari prej lumit e i tha:

- Qe, kjo është sèpata jote.

- Jo, nuk është imja - i u-përgjegj fshatari.

Zoti i ujnavet i prûni një tjetër argjendi, por katundari përsëriti:

- Jo, as kjo nuk është sèpata ime.

Atëherë Zoti i ujnavet i pruni sèpatën e tij. Katundari i gëzuem bërtiti:

- Po, kjo është sèpata ime.

Zoti i ujnavet tue pá se katundari ishte burrë i drejtë dhe i ndershëm, i a fali të trija.

* * * * *

Njutoni kishte dy daca: një të madh e një të vogël.

Porsa vînte mbrâmja, të dy shkojshin me fjetë në magazin e grunit (grunár) dhe dilshin posa fillonte me zbardhë.

Njiherë Njutoni tha: "Kjo është me të vërtetë një bezdí e madhe: jam i shtërnguem t'u a çel dacavet magazin e grunit përditë, në mëngjes e në mbrâmje. Asht një trazim për mue, sepse më duhet të lã punët e mija, të ngas, t'u a çel e t'u a mbyll derën dacavet. Prandej, mâ mirë po bâj dy bira në derë të magazines, kështu që dacat mund të hýjnë e të dalin

kur t'u teket".

Mori sharrën dhe turjelën dhe hapi dy vrima në derë, një të madhe e një të vogël. Mbas mbaroi të çelunit e biravet e ndërsa po kënaqesh për punën e bëmë, një mik i tij erdhi t'i bënte një vizitë.

Njutoni i spiegoi mikut hallin që kishte pasë me ducat dhe çka kishte bërë, porse miku i tha: "A nuk do të kishte mjaftue një birë? Pse keni bërë dy?"

"Po, por unë kam dy daca, një të madh e një të vogël", i u-përgjegj mikut.

"Po a s'mund të kalonte nëpër birën e madhe edhe daci i vogël?" e pyeti rishtas miku.

"Au, po vërtetë!" tha Njutoni, "Këtë nuk e kishem mendue fare".

QUESTIONS-PYETJE

Ai i rra një katundari sëpata në lumë? Kujt i rra sëpata në lumë? Çka i rra një fshatari në lumë? Ku i rra sëpata një katundari? Çka i ngjau një katundari? Prej idhnimit, a u-ul në breg të lumit dhe filloi me qá? Kush u-ul breg të lumit prej idhnimit dhe filloi me qá? Për ç'arsye u-ul katundari në breg të lumit dhe filloi me qá? Çka bëni fshatari prej idhnimit? Ku u-ul katundari dhe prej idhnimit filloi me qá? Pse u-ul katundari në breg të lumit dhe filloi me qá? A e ndigjoi Zoti i ujnavet vajin e tij? Kush e ndigjoi vajin e tij? Vajin e kujt e ndigjoi Zoti i ujnavet? Çka ndigjoi Zoti i ujnavet? A i pruni një sëpatë ari prej

lumit, mbasi pati dhimbë për të? Kush i prûni një sëpatë
 ari prej lumit, mbasi pati dhimbë për të? Për këtë pati dhimbë
 Zoti i ujnavet? A i u-dhims katundari Zotit t'ujnavet?
 Kujt i u-dhims katundari? A i prûni Zoti i ujnavet katun-
 darit një sëpatë ari mbasi i u-dhims? Pati dhimbë për të
 dhe i prûni çfarë sëpate prej lumit? Pati dhimbë për të dhe i
 prûni një sëpatë ari prej nga? A i tha: "Qe, kjo është
 sëpata jote"? Kush i tha: "Qe, kjo është sëpata jote"?
 Kujt i tha Zoti i ujnavet: "Qe, kjo është sëpata jote"? A
 u-përgjegj katundari: "Jo, nuk është imja"? Kujt i u-për-
 gjegj katundari: "Jo, nuk është imja"? A i prûni mandej Zoti
 i ujnavet një tjetër argjendi? Kujt i prûni një tjetër ar-
 gjendi Zoti i ujnavet? Çka i pruni Zoti i ujnavet fshatarit
 për të dytën herë? Çfarë sëpate i solli Zoti i ujnavet
 fshatarit të dytën herë? Por, a përsëriti katundari: "Jo,
 as kjo nuk është sëpata ime"? Kush përsëriti: "Jo, as kjo
 nuk është sëpata ime"? Kujt i tha fshatari: "Jo, as kjo nuk
 është sëpata ime"? Atëherë, a i a prûni Zoti i ujnavet sëpa-
 tën e tij"? Çka i solli atëherë Zoti i ujnavet? A bërtiti
 katundari i gëzuem: "Po, kjo është sëpata ime"? Kush bërtiti:
 "Po, kjo është sëpata ime"? Si qe katundari kur bërtiti:
 "Po, kjo është sëpata ime"? Pse ishte i gëzuem fshatari? Tue
 pá se katundari ishte burrë i drejtë dhe i ndershëm, kush i
 a fali të trija? Tue pá se kush ishte burrë i drejtë dhe i
 ndershëm, Zoti i ujnavet i a fali të trija? Çka i fali Zoti
 i ujnavet fshatarit tue pá se ky ishte burrë i drejtë dhe i

ndershëm? Zoti i ujnavet tue pá se katundari ishte çfarë burri i a fali të trija sëpatat? Pse i a fali Zoti i ujnavet katundarit të trija sëpatat?

Kush kishte dy daca, një të madh e një të vogël? Çka kishte Njutoni? Cilët shkojshin me fjetë në magazinën e grunit, porsa vînte mbrâmja? Ku shkojshin me fjetë të dy, porsa vînte mbrâmja? A dilshin, porsa fillonte me zbardhë? Prej nga dilshin dacat porsa të zbardhte? Për kê ishte një bezdë e madhe t'u a çelte dacavet magazinën e grunit përditë, në mëngjes e në mbrâmje? Pse ishte i detyruem Njutoni t'a çelte grunarin përditë, në mëngjes e në mbrâmje? Për kê ishte një trazim të lënte punët e tija, të ngitte, t'u a çelte e t'u a mbyllte derën dacavet? Çka i duhesh Njutonit të lënte që të ngitte, t'u a çelte e t'u a mbyllte derën dacavet? Kush vendosi të bënte dy bira në derë të magazines, kështu që dacat mund të hÿjshin e të dilshin kur t'u tekesh? Çka vendosi të bënte Njutoni në derë të magazines kështu që maçokët mund të hÿjshin e të dilshin kur t'u tekesh? Pse vendosi Njutoni të bënte dy bira në derë të magazines? Kush mori sharrën dhe turjelën dhe hapi dy vrima në derë? Çka bëni Njutoni me sharrë e turjelë? Në cilën derë hapi dy vrima Njutoni? Kush erdhi t'i bënte një vizitë Njutonit mbasi ky mbaroi të çelunit e vrimavet, e në sa po kënaqesh për punën e bame? Pse po kënaqesh Njutoni? Kur erdhi një mik i tij t'a vizitonte? A i a spiegoi Njutoni mikut hallin që kishte pasë me

dacat dhe çka kishte bâ? Çka i spiegoi Njutoni mikut? Çfarë halli kishte pasë Njutoni me maçokët? Kujt i tha miku: "A nuk do të kishte mjaftue një birë, pse keni bâ dy"? Çka i tha miku Njutonit? Kujt i u-përgjegj Njutoni: "Po, por unë kam dy daca, një të madh e një të vogël"? Qysh i u-përgjegj Njutoni mikut? Kë pyeti miku: "Po a s'mund të kalonte nëpër birën e madhe edhe daci i vogël"? Qysh e pyeti miku Njutonin? A tha Njutoni: "Au, po vërtetë! Këtë nuk e kishem mendue fare"? Çka tha Njutoni? A nuk e kishte mendue fare Njutoni se të dy dacat, si i madhi ashtu edhe i vogli, mund të kalojshin nëpër vrimë të madhe? Çka nuk kishte mendue Njutoni? A mund të kalojshin të dy dacat nëpër të njëjtën birë?

A mund të shkoni në qytet sa herë të ju teket? A shkojmë na në kinema sa herë të na teket? A mund të pijnë duhan ata kur t'u teket? A e keni zakon me u vû mend mësimet? A i vëni mend një njeriu kur flet me jû? A ju dhimbet një fëmijë kur qán? Kujt i dhimset një kafshë kur âsht e sëmundë? A fshâj unë kur jam i mërzitun? Kur fshâni ju? A âsht gruni bereqet? A âsht e fortë rryma e Shkumbînit? Rryma e cilit lumë nuk âsht e fortë? A mund t'i dalloni ngjyrat? Kush nuk mund t'i dallojë mirë ngjyrat?

Translate the following sentences into Albanian:

1. The door of the warehouse is on the right side.
2. How many holes does it have?
3. Wheat is an agricultural product.
4. Tell me, what's your trouble?
5. I want to open the window; it's smoky in here!
6. I often get the notion to go to Europe, but I haven't enough money.
7. This is the same person I met last night.
8. Speaking English in class is not permitted.
(Use the neuter noun.)
9. I opened the book again, but I couldn't find the page.
10. Will this water be enough? (Use the verb "to suffice.")



Kullat e Dukatit para dhe pas restaurimit.



ár, -i	(m.)	gold
i, të bâmë e, të bâme	(adj. m. & f.)	done, made
bereqet, -i bereqete, -t	(m.)	farm product, crop
bezdí, -ja	(f.)	trouble, annoyance discomfort, bother
i, e, të bezdisun të bezdisuna	(adj. m. & f.)	bothered, annoyed
birë, -a bira, -t	(f.)	hole
me çelë (unë çel)	(v.)	to open; to bloom (for flowers); to clear (for the weather)
të çelun, -it	(neut.)	opening
dac, -i daca, -t	(m.)	tomcat
i, të detyruem e, të detyrueme	(adj. m. & f.)	obliged, compelled
dëshpërim, -i dëshpërime, -t	(m.)	despair, depression
i, e, të drejtë të drejta	(adj. m. & f.)	right, righteous, just
druar, -i druarë, -t	(m.)	woodsman
me u-dhimsë (unë (i) dhimsem)	(v.)	to have the sympathy of; compassion of others; to feel sorry
fatkeqësi, -ja fatkeqësi, -t	(f.)	misfortune
me fshâ (unë fshâj)	(v.)	to sigh
së fundi	(adv.)	finally, at last

i, të gëzuem e, të gëzueme	(adj. m. & f.)	happy, glad
grunár, -i grunarë, -t	(m.)	granary
hall, -i halle, -t	(m.)	trouble, problem, misery, plight, predicament
idhnim, -i idhnime, -t	(m.)	grief, bitterness; anger
me u-kënaqë (unë kënaqem)	(v.)	to be pleased, satisfied; to have fun
krenarí, -ja	(f.)	pride; arrogance
me u-kujtue (unë kujtohem)	(v.)	to recall; to realize
maçok, -u maçokë, -t	(m.)	tomcat
magaze, magazja magaze, -t	(f.)	store, warehouse
matematikan, -i matematikanë, -t	(m.)	mathematician
mëshirë, -a	(f.)	mercy
në sa	(conj.)	while
Perendí, -ja	(m.)	God
përditë	(adv.)	everyday
me i a pritë (unë i a pres)	(v.)	to retort
me u-provue (unë provohem)	(v.)	to be proved, tried, tested
rishtas	(adv.)	recently; again, anew
rrymë, -a rryma, -t	(f.)	current, stream; tendency, trend
sëpatë, -a sëpata, -t	(f.)	ax

i, të shtërnguem e, të shtërngueme	(adj. m. & f.)	obliged, forced, constrained, compelled; tightened, fastened
me u-tekë (më, të, i etj. teket)	(v.)	to feel like (doing), to get the notion to
trazim, -i trazime, -t	(m.)	disturbance, agitation, bother, trouble
vâj, -i vaje, -t	(m.)	crying, weeping
me zbardhë (unë zbardh)	(v.)	to whiten; to dawn (3rd pers. sing.)
<u>Shënime:</u>		
me (i) vû mend (unë (i) vë mend)	(v.)	to pay attention to

Festat Fetare në Shqipëri

1. Sa fé ka në Shqipëri? Trif fé: feja myslimane ortodokse e katolike.
2. Cila fé ka më shumë besnikë? Feja myslimane. Pothuej dy të tretat e popullsisë shqiptare janë myslimane.
3. Çfarë festash fetare kanë të krishtenët? Të krishtenët, si në të gjithë botën, kanë dy festa kryesore: Krishtlindjet dhe Pashkët.
4. Po myslimanët? Edhe këta kanë dy festa: Bajramin e Madh e Bajramin e Vogël.
5. Me ç'datë bijnë këto festa? Bajrami i Vogël bje dy muej mbas Bajramit të Madh, por ky i fundit nuk ka një datë të caktueme.
6. Si dihet data e festës? Këtë e cakton zyra e Komunitetit Mysliman.
7. Çka është Ramazani? Ramazan quhet mueji i agjinimit dhe Bajrami i Madh është pikërisht festa e mbarimit të këtij mueji.
8. Me agjinue, a d.m.th. mos me hangër disa lloje gjellësh? Jo, me agjinue d.m.th. mos me hangër aspak; as të pimit e duhanit nuk është i lejueshëm.
9. Mos me hangër për një muej?! Jo, vetëm gjatë ditës; ata që agjinojnë mund të hanë vetëm në mbrâmje deri para se të gdhijë.
10. Si quhet ndryshe Bajrami i Vogël? Myslimanët e quejnë këtë edhe me një fjalë arabe: Kurban Bajram.
11. Pse quhet kështu? Sepse për Bajram të Vogël është zakon që çdo familje të bájë kurban një ase më shumë desh.

12. Pse bëjnë kurban?
Asht një zakon i vjetër për të nderuar Perëndinë.
13. A janë zyrtare të gjitha këto festa?
Po, si festat myslimane ashtu edhe ato të krishterë janë zyrtare, d.m.th. zyrtar qeveritarë dhe ato private qëndrojnë mbyllë.
14. Sido që të jetë kam marrë vesh se regjimi komunist në të vërtetë sot e ndalon ushtrimin e fevet në Shqipëri.
Po, është e vërtetë, por kjo s'd.m.th. se populli nuk e ushtron fën privatisht në banesën e tij.



Rare photo of Mother Teresa, autographed in Albanian.

REVIEW OF FRACTIONS

As we have explained in Lesson 46, Volume IV, in Albanian the part of the fraction below the line, the denominator, is declined like a feminine adjective preceded by articles i, e, të and së only in definite form. The numerator of the fraction, the number above the line, is not declined.

Use of fractions in sentences

a. with numerator nji (1):

- Nom. Nji e treta e klasës mori nota të shkëlqyeshme.
(One-third of the class received excellent grades.)
- Gen. Notat e nji së tretës së klasës janë të mira.
(Grades of one-third of the class are good.)
- Dat. Mësuesit i dhanë nota të mira nji së tretës së klasës.
(Teachers gave good grades to one-third of the class.)
- Acc. Nji të tretën e klasës e dërguen në kinema.
(They sent one-third of the class to the movie.)
- Ab1. I mora detyrat e shtëpis prej nji së tretës së klasës.
(I got the homework from one-third of the class.)

b. with numerator more than one:

- Nom. Për arsye të gripit dje nuk erdhën tri të katërtat e nxënësve.
(Because of the flu, three-fourths of the students didn't show up yesterday.)
- Gen. Mungesat e tri të katërtave të nxënësve janë t'arsyeshme.
(The absences of three-fourths of the students are justifiable.)
- Dat. Tri të katërtave të klasës u dhanë leje të rrijnë në shtëpi.
(Three-fourths of the class were given permission to stay home.)
- Acc. Tri të katërtat e klasës i dërguen n'infermeri.
(They sent three-fourths of the class to the infirmary.)
- Ab1. Morëm lajme të mira prej tri të katërtave të klasës.
(We received good news from three-fourths of the class.)

SOME CONJUNCTIONS THAT GO WITH THE SUBJUNCTIVE MODE

a. The conjunctions (për)para se , "before," and mbasi, "after," precede the subjunctive mode, but mbasi also precedes tenses of other modes.

Examples:

Mbyllni dyert e dritoret përpara se të dilni!
(Close the doors and windows before you leave!)

Rojet mrrijtën në vendin e caktuem para se të gdhinte.
(The guards arrived at the designated place before it dawned.)

Shkoni me luejtë mbasi t'a mbaroni punën!
(Go and play after you finish your work!)

b. mbas vs. mbasi

The adverb and preposition mbas used in this lesson means also "after" like the conjunction mbasi. However, the latter always precedes a verb, whereas mbas precedes anything but a verb.



Vlorë - XHAMIA E MURADIES

Pothuej dy të tretat e popullsisë shqiptare janë myslimane (muhamedane). Pjesa tjetër është ortodokse e katolike.

Të krishtenët kanë dy festa kryesore: Krishtlindjet dhe Pashkët.

Muslimanët ase muhamedanët kanë edhe këta dy festa kryesore: Bajramin e Madh e Bajramin e Vogël. Bajrami i Vogël quhet edhe Kurban Bajram.

Bajrami i Madh është festa e mbarimit të Ramazanit. Ramazan quhet mueji i agjinimit për muslimanët. Për tridhetë ditë rresht, prej lindjes së diellit e deri në prendim, muslimanët fetarë agjinojnë, d.m.th. gjatë kësaj kohe, nuk shtijnë kurrgjâ në gojë. Porsa prendon dielli, hoxha thërret në minare të xhamisë me u lajmue besnikëvet prishjen e agjinimit. Zakonisht, në këtë kohë zbrazet edhe një top. Sofrat janë të shtrueme. Për yftár e syfyr gatohen gjellët mâ të mira.

Darka në Ramazan quhet yftár. Të pasunit kanë pothuej gjithmonë miq për yftár. Netët kalohen tue vizitue njëni-tjetrit ase tue luejtë kumár në shtëpit e njëni-tjetrit ase ndër kafe. Në këtë muej ndër kafe ka zakonisht ahengje.

Pak para se të gdhijë, të ramit e lodravet lajmon se po afrohet koha me e fillue agjinimin. Të gjithë agjinuesit e Ramazanit çohen prej gjumit ase vijnë në shtëpi për të ngranë. Ngrania në mëngjes, në Ramazan, quhet syfyr. Mbas ngranies bje edhe një herë topi, i cili lajmon se agjinimi filloi. Kështu vazhdon për tridhetë ditë me radhë, deri sa vjen

Bajrami i Madh, që festohet tri ditë.

Dy muej mbas Bajramit të Madh bje Bajrami i Vogël, që festohet katër ditë. Bajrami i Vogël quhet edhe Kurban Bajram, sepse për këtë festë secila familje, që është në gjendje të mirë, bën kurban një ose më shumë desh. Ato më pasanike (zengjine) u a dajnë mishin e kurbanëve të vorfënvet (fukaravet).

Në Shqipëri, të trija fëta i respektojnë festat e njëntjetrës. Si zyrtar qeveritare, ashtu edhe ato private, nuk punojnë në këto ditë. Tregu, përveç kafëve, restorantavet dhe vendëvet të dëfrimit, nuk çel.

QUESTIONS-PYETJE

A janë pothuaj dy të tretat e popullsisë shqiptare myslimane? Dy të tretat e cilës popullsi janë muhamedane? Çfarë feje kanë dy të tretat e popullsisë shqiptare? A është pjesa tjetër ortodokse e katolike? Cila pjesë është ortodokse e katolike? Një e treta e cilës popullsi është ortodokse e katolike? Çfarë feje ka një e treta e popullsisë shqiptare? A kanë të krishtenët dy festa kryesore: Krishtlindjet dhe Pashkët? Cilat janë festat kryesore të të krishtenëve shqiptarë? Po myslimanët, a kanë edhe këta dy festa kryesore: Bajramin e Madh e Bajramin e Vogël? Cilat janë festat kryesore të myslimanëve shqiptarë? A quhet Bajrami i Vogël edhe Kurban Bajram? Cila festë quhet edhe Kurban Bajram? A është Bajrami i Madh festa e mbarimit të Ramazanit? Cila është festa e mbarimit të Ramazanit? A quhet Ramazan mueji i agjinimit për myslimanët? Qysh quhet mueji i agjinimit për myslimanët? A agjinojnë myslimanët fetarë për tridhjetë ditë rresht, prej

lindjes së diellit e deri në prendim? Çka bëjnë myslimanët fetarë për tridhetë ditë rresht, prej lindjes së diellit e deri në prendim? A agjinojnë, d.m.th. gjatë kësaj kohe nuk shtijnë kurrgjâ në gojë? Çka bëjnë myslimanët fetarë në Ramazan? A thërret hoxha në minare të xhamis me u lajmue besnikëvet prishjen e agjinimit? Kur thërret hoxha nga minarja e xhamis me u lajmue besnikëvet prishjen e agjinimit? Çka u lajmon hoxha besnikëvet prej minares së xhamis, porsa prendon dielli? Zakonisht, a zbrazet edhe një top në këtë kohë? Zakonisht çka zbrazet kur hoxha, nga minarja e xhamis, u lajmon besnikëvet prishjen e agjinimit? A janë të shtrueme sofrat? Kur janë të shtrueme sofrat? A gatuhet gjellët më të mira për yftár dhe syfyr? Kur gatuhet gjellët më të mira? A quhet yftár darka në Ramazan? Qysh quhet darka në Ramazan? A kanë të pasunit gjithmonë miq për yftár? Kush ka gjithmonë miq për yftár? A kalohen netët tue vizitue njëni-tjetrin? Kur kalohen netët tue vizitue njëni-tjetrin? Si kalohen netët në muejin e Ramazanit? A kalohen netët tue vizitue njëni-tjetrin ase tue luejtë kumár në shtëpit e njëni-tjetrit ase ndër kafe? Cilët luejnë kumár ndër kafe ase në shtëpit e njëni-tjetrit në muejin e Ramazanit? Ku luhet kumár ndër netët e Ramazanit? A ka zakonisht ahengje ndër kafe në këtë muej? Zakonisht, ku ka ahengje në këtë muej? A lajmon të ramit e lodravet, pak para se të gdhijë, se po afrohet koha me fillue agjinimin? Çka lajmon të ramit e lodravet, para se të gdhijë? A çohen nga gjumi ase vijnë në shtëpi për të ngranë të gjithë

agjinuesit e Ramazanit? Kush çohet nga gjumi ase vjen në shtëpi për të hangër, kur bijnë lodrat në mëngjes? Çka bëjnë agjinuesit e Ramazanit, kur bijnë lodrat në mëngjes? A quhet syfyfyr ngrania në mëngjes, në Ramazan? Qysh quhet ngrania në mëngjes, në Ramazan? Mandej, mbas ngranies, a bje edhe një herë topi, i cili lajmon se agjinimi filloi? Çka zbrazet edhe një herë mbas syfyrit që lajmon fillimin e agjinimit? Çka lajmon ramja e topit mbas syfyrit? A vazhdon kështu për tridhetë ditë rresht, deri sa vjen Bajrami i Madh? Për sa ditë rresht vazhdon agjinimi? Çfarë feste vjen mbas tridhetë ditësh agjinimi? A festohet tri ditë Bajrami i Madh? Cila festë festohet tri ditë? A bje Bajrami i Vogël dy muej mbas Bajramit të Madh? Çfarë feste bje dy muej mbas Bajramit të Madh? Kur bje Bajrami i Vogël? A festohet katër ditë Bajrami i Vogël? Cili Bajram festohet katër ditë? A quhet edhe Kurban Bajram, Bajrami i Vogël? Cila festë quhet edhe Kurban Bajram? A quhet Kurban Bajram sepse në këtë festë secila familje, që është në gjendje të mirë, bën kurban një ase më shumë desh? Çka bën secila familje që është në gjendje të mirë? A u a dajnë mishin e kurbanevet të vorfënvjet? Cilëve u a dajnë mishin e kurbanevet? Çka u dajnë fukaravet familjet më zengjine? Cilëve u a dajnë mishin e kurbanevet familjet më pasanike? A i respektojnë festat e njëna-tjetrës të trija fét, në Shqipëri? Cilat fé i respektojnë festat e njëna-tjetrës, në Shqipëri? A punojnë zyrat qeveritare dhe ato private, në këto ditë? Cilat zyra nuk punojnë në këto ditë? Kur nuk punojnë zyrat qeveritare as ato private? A çel tregu,

përveç kafevet, restaurantatvet e vendevet të dëfrimit? Në ç'vend nuk çel tregue, përveç kafevet, restaurantatvet e vendevet të dëfrimit ndër festat e të trija fevet?

A keni luejtë ndonjiherë kumár? Në cilin shtet t'Amërikës luhet shumë kumár? A është e lejueshme me luejtë kumár në Kaliforní? A e kaloj unë kohën tue lexue? Si e kalon ai kohën? A e kalojnë ata kohën tue bisedue me njëni-tjetrin? A ju pëlqen me e pá diellin tue prendue? Kur shkoni në shtëpí, a është sofra e shtruese? Kush e shtron sofrën, zakonisht? A dini ju me shtrure një sofër? A zgjoheni para, apo mbasi të gdhíjé? A është tue fjetë ai kur gdhín? A ka njerëz që gdhíjnë pa shkue me fjetë? A gdhíjmë na të sëmundë nganjíherë? A keni gdhí ndonjiherë me dhimbë koke? A falen myslimanët në xhamí? Si quhet vendi ku falen myslimanët? Cilët falen në xhamí? A luten të krishtenët në kishë? Ku luten të krishtenët? Cilët luten në kishë?

A. Plotësoni fjalit që vijojnë tue i shkruet thyesat me fjalë e jo me numra:

1. Mbramë përsërita three-fourths e mësimit.
2. Four-fifths e klasës janë tue dhanë gjak sot.
3. Hangra one-third e ambëlsinës; _____
Two-thirds i a dhashë nji shoku.
4. Nuk kemi marrë letra prej four-fifths të
të miqvet.
5. One-fourth e rrogës së tij është 250 lekë.

B. Translate the following sentences into Albanian:

6. There are rich and poor here.
7. Some mosques have two minarets.
8. His brother is very religious.
9. This is a government building.
10. I don't feel sorry for him.

agjinim, -i agjinime, -t	(m.)	fasting
me agjinue (unë agjinoj)	(v.)	to fast
agjinues, -i agjinues, -it	(m.)	a fasting person
aheng, -u ahengje, -t	(m.)	folk music orchestra
arab, -e arabë	(adj. m. & f.)	Arabic
besnik, -u besnikë, -t	(m.)	a loyal person; a faithful person; a believer; a follower
i, të caktuem e, të caktueme	(adj. m. & f.)	set, fixed, designated; assigned
dash, -i desh, -t	(m.)	ram
me u-falë (unë falem)	(v.)	to pray, worship (for Moslems); to be pardoned, forgiven
fukará, -ja fukará, -t	(m.)	a poor person (not rich)
hoxhë, -a hoxhallarë, -t	(m.)	a Moslem pastor
katolik, -e katolikë	(adj. m. & f.)	Catholic
kokë, -a koka, -t	(f.)	head
komunitet, -i komunitete, -t	(m.)	community (for religion)
kurban, -i kurbane, -t	(m.)	sacrifice (an animal consecrated and offered to God)
kurrgjâ	(pron.)	nothing

me lajmue (unë lajmoj)	(v.)	to notify
lodër, lodra lodra, -t	(f.)	drum; game; toy
mbarim, -i	(m.)	ending, end
mbyllë	(adv.)	closed, shut
minare, minarja minare, -t	(f.)	minaret
me nderue (unë nderoj)	(v.)	to honor, respect; to salute
ndryshe	(adv.)	differently; otherwise
me ngranë (unë há)	(v.)	to eat
ngranie, -a	(f.)	eating
ortodoks, -e ortodoksë	(adj. m. & f.)	Orthodox
pasanik, -e pasanikë	(adj. m. & f.)	rich, wealthy
i pasun, -i të pasun, -it	(m.)	a rich person
me prendue (prendon)	(v.)	to set (for the sun); to fade away, to go down
të rám, -it	(neut.)	fall, falling; striking
Ramazan, -i	(m.)	Ramadan (Moslem fasting month)
syfyr, -i syfyre, -t	(m.)	breakfast in Ramadan
me shtrve (unë shtroj)	(v.)	to set, lay out; to pave; to subject, conquer
top, -i topa, -t	(m.)	ball; cannon (gun)

treg, -u tregje, -t	(m.)	market, market place; business district
i vorfën, i vorfni të vorfën, të vorfnit	(m.)	a poor person
yftár, -i yftarë, -t	(m.)	supper in Ramadan
me u-zbrazë (unë zbrazem)	(v.)	to be emptied, vacated; to be fired (weapon)
zengjin, -e zengjinë	(adj. m. & f.)	rich, wealthy
zyrtár, -e zyrtarë	(adj. m. & f.)	official

Shënime:

me bâ kurban (unë bâj kurban)	(v.)	to slaughter an animal as a sacrifice
----------------------------------	------	--

Koprraci Shpirtkeq

1. Po, është shumë e vërtetë ajo që thoni; njeriu zakonisht nuk kënaqet kurrë me ato që ka, por nganjihërë e tepron.
Tregohet se kishte pasë qenë njëherë një njeri shumë i pasun...
2. A është përrallë, apo ngjarje kjo që po më tregoni tash?
Asht përrallë, por tregon sa shpirtkeq është njeriu nganjihërë. Kishte shumë toka, shumë shtëpi e shumë punëtorë.
3. Kush, njeriu i pasun?
Po. Ndër këta punëtorë kishte edhe një shërbëtor, që kujdesohesh me u çue bukën bujqvet.
4. E kuptoj, shumë kohë më parë ka qenë zakon që pronari t'u epte me hangër punëtorëvet.
Një ditë, mbasi mbaroi shpërdamjen e bukës, tue u-këthye me kuaj, pá diçka që shëndritte.
5. Ku pá diçka që shëndritte?
Në tokë; atëherë largoi dhën dhe gjeti dy qypa plot me pare ari dhe një veg ari.
6. Me fjalë tjera, gjeti një thesar.
Pa humbë kohë i ngarkoi mbi kuaj dhe porsa mrrijti në shtëpi lajmoi zotnín dhe së bashku i shkarkuen kuajt.
7. Pse e lajmoi zotnín?
Sepse ishte shërbëtor besnik. Zotnija i premtoi gjymsën dhe e porositi mos t'i tregonte asnjë njeriu të gjallë.
8. Pse nuk duhet t'i kallxonte asnjë njeriu të gjallë?
Duket se zotnija kishte në mend diçka të keqe dhe me të vërtetë pak kohë më vonë e helmoi shërbëtorin.
9. Natyrisht, që t'i merrte edhe gjymsën që i kishte premtue.
A e shifni çka bëni zemra e keqe e një koprraci shpirtkeq?

10. Ç'ngjau pastaj?

Hapi lajmin që shërbëtori i kishte ikë, por pak kohë më vonë ai doli lugat.

11. Ç'd.m.th. kjo?

Kjo d.m.th. se shërbëtori mbas vdekjes, dukesh në shtëpi në forma të ndryshme. Filloi me bâ dame, tue u shti tmerin njerëzvet të shtëpis.

12. Deri kur vazhdoi kjo gjâ?

Deri sa zotnija dhe njerzit e tij vdiqën të gjithë nga terrori.

13. Asht për t'ardhë keq për familjen e tij të pafajshme.

Thuhet mandej se me pasunin e zotnis u-bâ jetimorja e parë e qytetit ku ai jetonte.



QUASI-COMPOUNDS

1. We have talked about the so-called quasi-compounds in Lessons 33 (Volume III) and 60 (Volume VI). This time we are reviewing them briefly to reinforce the use of such an important group of nouns.

A quasi-compound is made of two separate nouns, the first noun defined by the second. It can be used in the singular and plural, masculine and feminine, in indefinite and definite forms. Conversely, in English the first noun defines the second.

Examples:

Indefinite singular feminine
(Ablative)

Supë pule
(Chicken soup)

Indefinite singular masculine
(Ablative)

Sahat xhepi
(Pocket watch)

Indefinite plural feminine
(Ablative)

Rroba grash
(Women's clothes)

Indefinite plural masculine
(Ablative)

Kostume burrash
(Men's suits)

Definite
(Genitive)

Supa e pulës
(The chicken soup)

Definite
(Genitive)

Sahati i xhepit
(The pocket watch)

Definite
(Genitive)

Rrobat e gravet
(The women's clothes)

Definite
(Genitive)


Kostumet e burravet
(The men's suits)

As mentioned previously, the first noun (indefinite) is in the nominative case, and the second (also indefinite) is in the ablative case. When they become definite, the first noun stays in the nominative, whereas the second one takes the possessive case.

THE INTERROGATIVE PRONOUN çfarë

2. The Albanian interrogative pronoun çfarë is used in front of nouns in the ablative case, singular and plural, masculine and feminine, to ask for the nature, type, features or characteristics of an object or being. The noun endings are: i, u for masculine singular, e, je for feminine singular, and sh for masculine and feminine plural.

A quasi-compound noun is quite frequently the answer to a question with the interrogative pronoun çfarë.

ARKEOLOGJIFoto: Refik
Veseli**LISSUSI I LASHTE**

Kishte pasë qenë njëherë një tregtar shumë i pasun. Përveç tregtis së madhe që bënte, kishte edhe shumë pasuri të patundshme. Kishte bujq që punojshin për të. Kishte edhe një vneshtë të madhe, të cilën e mbikëqyrte vetë dhe e punonte me punëtorë me pagë ditore. Shtëpia kishte një lulishtë me gjithfarë lulesh; mbrapa, kishte një kopsht barishtesh dhe një kopsht pemësh.

Përveç punëtorëve, kishte edhe një shërbëtor. Ky kujdesohesh me u çue bukën punëtorëve. Një ditë, kur po u çonte bukën punëtorëve, pa në dhë një gjë që shëndritte prej rrezet të diellit. I u-afrue vendit dhe, pa e largue mirë dhën që e mbulonte at send, e njofti se ishte ar. E mbuloi edhe një herë, vëni një shëj dhe vijoi udhëtimin. Kur u-këthye, e gjeti vendin dhe filloi të gërmihi me kazëm e bel, tue e largue dhën me lopatë. Gjeti një veg ari dhe dy qypa me pare ari. I futi ndër thasë dhe i ngarkoi mbi kuaj. Porsa merrti në shtëpi, lajmoi zotnin mbi thesarin që kishte gjetë. Kur e pa zotnija visarin që kishte gjetë shërbëtori i tij, mbeti me gojë hapët. Menjherë i premtoi gjymsën dhe i ndihmoi me i shkarkue. E porositi gjithashtu mos t'i kallxonte asnjë njeriu të gjallë.

Nuk shkoi shumë kohë dhe zotnija u-pendue për premtimin që kishte bërë. E helmoi shërbëtorin dhe e varrosi në ahri në shtëpi. Zemra e keqe e këtij koprraci shpirtkeq, që nuk ngihesh me ato që kishte, e shtyni me e mbytë shërbëtorin besnik.

Hapi lajmin që shërbëtori i kishte ikë dhe kështu mendoi se me kaq puna u-mbyll.

Nuk shkoi shumë kohë dhe shërbëtori doli lugat. Merrte gjithfarë formash: herë dukesh si gogol e herë si hije. Kur njerzit e shtëpis uleshin me hangër, dikush e fikte dritën e kandilit. Kurrgjâ nuk shifesh; ndihesh vetëm fryma që shuente dritën. N'ahër ndihesh tue u-derdhë vena prej fuçivet. Shkojshin atje, kontrollojshin gjithandej, por nuk shifshin ndokënd. Njerëzvet të shtëpis u kishte hÿ tmër. Zotnija, që e dinte nga rridhshin këto, ishte bâ asht e lëkurë. As hante, as pinte e as nuk mund të flênte. Ishte ndërgegjja që nuk e lênte të qetë (rehat).

Nji frikë e madhe u hÿnte të gjithëve, sidomos kur ndigjojshin lodrën e lugatit. Mbas mesnate ase në të gdhim ndihesh lodra që i binte lugati. Fillonte larg dhe vazhdonte tue u-afrue zhurma, si t'ishte njaty dhe pastaj prap largohesh.

Mâ në fund, nga frika e tmeri (terrori), të gjithë njerzit e shtëpis vdiqën nji mbas nji. Familja e tij e pafajshme dhe zotnija e paguen shtrêjt gjakun e shërbëtorit. Krejt ajo familje u-shfarue.

Në testamentin që gjetën, panë që shtëpin dhe të gjithë pasunin u a kishte lânë jetimavet të qytetit.

Mbas vdekjes së tij u-krijue n'at qytet jetimorja e parë.

QUESTIONS-PYETJE

A kishte pasë qenë njiherë nji tregtar shumë i pasun? Kush kishte pasë qenë njiherë? Çfarë tregtari kishte pasë qenë njiherë? Përveç tregtis së madhe që bante, a kishte edhe shumë pasun të patundshme? Kush kishte edhe shumë pasun të patundshme, përveç tregtis së madhe që bante? Çka kishte tregtari i pasun, përveç tregtis së madhe që bante? A kishte bujq që punojshin për të? Kush kishte bujq që punojshin për të? Kë kishte tregtari i pasun që punonte për të? A kishte edhe nji vneshtë të madhe, të cilën e mbikëqyrte vetë? Çka kishte tregtari i pasun, të cilën e mbikëqyrte vetë? A e punonte vneshtën me punëtorë me pagë ditore? Çka punonte tregtari me punëtorë me pagë ditore? A ishte e madhe shtëpia e tij? Qysh ishte shtëpia e tregtarit? A kishte shtëpia përpara nji lulishtë me gjithfarë lulesh? Çka kishte shtëpia e tregtarit përpara? Po mbrapa, a kishte nji kopsht barishtesh e nji kopsht pemësh? Çka kishte mbrapa shtëpia e tregtarit? Çfarë kopshtesh kishte mbrapa shtëpia e tregtarit të pasun? Përveç punëtorëvet, a kishte edhe nji shërbëtor? Kush kishte edhe nji shërbëtor përveç punëtorëvet? A kujdesohesh ky me u çue bukën punëtorëvet? Kush kujdesohesh me u çue punëtorëvet bukën? Për çka kujdesohesh shërbëtori? Nji ditë, kur po u çonte bukën punëtorëvet, a pá nji gjâ që shëndritte në dhé? Ku e pá shërbëtori gjën që shëndritte, ndërsa po u çonte bukën punëtorëvet? Çka po u çonte shërbëtori punëtorëvet?


A shëndritte prej rrezetve të diellit gjâja që pá ai në dhé, kur po u çonte bukën punëtorëve? Prej se shëndritte gjâja që pá shërbëtori në dhé, ndërsa po u çonte bukën punëtorëve? A i u-afrue vendit dhe pa e largue mirë dhén që e mbulonte at send, e njofti se ishte ár? Kush i u-afrue vendit dhe pa e largue mirë dhén që e mbulonte at send, e njofti se ishte ár? Çka ishte ajo gjâ që pá shërbëtori, kur po u çonte bukën punëtorëve në vneshtë? A e mbuloi edhe një herë, vûni një shêj dhe vijoi udhëtimin? Çka bâni ai mbasi e mbuloi sendin? A e gjeti vendin kur u-këthye? Pse mundi t'a gjejë vendin? A filloi të gërmihet me kazëm dhe bel, tue e largue dhén me lopatë? Kush filloi të gërmihet me kazëm dhe bel tue e largue dhén me lopatë? Çka bâni shërbëtori? A gjeti një veg ari dhe dy qypa me pare ari? Çfarë vegu gjeti ai? Çka tjetër gjeti shërbëtori? A i futi ndër thasë dhe i ngarkoi mbi kuaj? Çka futi ai ndër thasë dhe i ngarkoi mbi kuaj? Ç'bâni shërbëtori? A e lajmoi zotnin porsa mrrijti në shtëpi mbi thesarin që kishte gjetë? Kë lajmoi shërbëtori mbi thesarin që kishte gjetë, porsa mrrijti në shtëpi? A mbeti me gojë hapët zotnija, kur e pá visarin që kishte gjetë shërbëtori i tij? Kush mbeti me gojë hapët, kur e pá visarin që kishte gjetë shërbëtori i tij? Çka pá zotnija që mbeti me gojë hapët? A i a premtoi menjherë gjymsën atij dhe i ndihmoi me i shkarkue? Kush i a premtoi menjherë gjymsën shërbëtorit dhe i ndihmoi me i shkarkue? A e porositi gjithashtu mos t'i kallxonte asnjë njeriu të gjallë? Kush e porositi mos t'i kallxonte asnjë njeriu të

gjallë? Qysh e porositi zotnija shërbëtorin? A shkoi shumë kohë dhe zotnija u-pendue për premtimin që kishte bâ? Sa kohë shkoi dhe zotnija u-pendue për premtimin që kishte bâ? A e helmoi shërbëtorin dhe e varrosi n'ahrin e shtëpis? Kê helmoi zotnija dhe e varrosi n'ahrin e shtëpis? Ku e varrosi zotnija trupin e shërbëtorit? A qe zemra e keqe e atij koprraci shpirtkeq, që e shtëyni me e mbytë shërbëtorin besnik? Kê shtëyni zemra e keqe me e mbytë shërbëtorin e tij? Çka e shtëyni zemra e keqe zotnin me bâ? A ngihesh zotnija me ato që kishte? A e hapi lajmin se i kishte ikë shërbëtori? Kush e hapi lajmin se i kishte ikë shërbëtori? A mendoi se me kaq puna u-mbyll? Kush mendoi se me kaq puna u-mbyll? Çka mendoi zotnija? A shkoi shumë kohë dhe shërbëtori doli lugat? Kush doli lugat mbas pak kohe? A merrte lugati gjithfarë formash? Çfarë formash merrte lugati? A dukesh herë si gogol e herë si hije? Kush dukesh herë si gogol e herë si hije? Si dukesh lugati? A e fikte dikush dritën e kandilit, kur njerzit e shtëpis uleshin me hangër? Kush u a fikte dritën e kandilit njerëzvet të shtëpis, kur uleshin me hangër? A shifesh gjâ? Çka nuk shifesh? A ndihesh vetëm fryma që shuente dritën? Çka ndihesh që shuente dritën? A ndihesh n'ahër tue u-derdhë vena prej fuçivet? Ku ndihesh tue u-derdhë vena? A shkojshin atje e kontrollojshin gjithandej, por nuk shifshin ndokënd? Çka bâjshin njerzit e shtëpis? Kush ishte bâ asht e lëkurë? Pse ishte bâ zotnija asht e lëkurë? Si ishte bâ zotnija që e dinte nga rridhshin këto? A hante, a pinte dhe a mund të flênte zotnija? Kush nuk hante, as pinte e as nuk mund të

flente? A ishte ndërgjegjja që nuk e lënte të qetë? Kë nuk lënte rehat ndërgjegjja? Çka ishte që nuk e lënte rehat zotnën? A u hënte një frikë e madhe të gjithëve, kur ndigjojshin lodrën e lugatit? Cilëve u hënte një frikë e madhe, sidomos kur ndigjojshin lodrën e lugatit? Çka u hënte njerëzvet të shtëpisë, sidomos kur ndigjojshin lodrën e lugatit? A i binte lugati lodrës mbas mesnate ase në të gdhim? Kur ndihesh lodra e lugatit? A fillonte zhurma larg dhe vazhdonte tue u-afër, si t'ishte njatë? Mandej, a largohesh prap? Çka largohesh mandej prap? Më në fund, a vdiqën një mbas një të gjithë njerzët e shtëpisë? Kush vdiq nga frika e tmerit? Pse vdiqën një mbas një të gjithë njerzët e shtëpisë? A e paguen shtrëjt gjakun e shërbëtorit zotnija dhe familja e tij e pafajshme? Kush e pagoi shtrëjt gjakun e shërbëtorit? Çka paguen shtrëjt zotnija dhe familja e tij e pafajshme? A u-shfarue krejt ajo familje? Cila u-shfarue krejt? Në testamentin që gjetën, a panë se shtëpinë dhe të gjithë pasunin u a kishte lënë jetimavet të qytetit? Kush u a kishte lënë shtëpinë dhe të gjithë pasunin jetimavet të qytetit? Ku e panë se tregtari i pasun u a kishte lënë shtëpinë dhe të gjithë pasunin jetimavet të qytetit? A u-krijue n'at qytet jetimorja e parë mbas vdekjes së tij? Mbas vdekjes së kujt u-krijue jetimorja e parë n'at qytet? Çka u-krijue n'at qytet mbas vdekjes së tregtarit të pasun? Ku u-krijue jetimorja e parë mbas vdekjes së tregtarit të pasun?

Translate the following sentences into Albanian:

1. My conscience was bothering me.
2. She has become like a skeleton (skin and bones).
3. Thus we thought that the case was closed.
4. I just put it out, thank you.
5. Nobody likes to hear bad news.
6. Why did the ancient people keep their money in
in earthen pots?
7. How does a person feel when he is declared innocent?
8. What are bones used for?
9. Albanians eat corn bread and wheat bread.
10. There is a beautiful flower garden in front of their house.



Festival rreth një shatërvani.



Dyvegjake ilire – shek. VI-V.

ahër, ahri ahra, -t	(m.)	stable, cellar
asht, -i eshtna, -t	(m.)	bone
me bâ dam (unë bāj dam)	(v.)	to damage, to harm
bel, -i bele, -t	(m.)	spade; waist
dam, -i dame, -t	(m.)	damage, harm
me u-derdhë (derdhet)	(v.)	to be spilled; to be shed
ditor, -e	(adj. m. & f.)	daily
me fikë (unë fik)	(v.)	to put out, extinguish; to ruin
fuçí, -ja fuçí, -t	(f.)	barrel, drum, keg
të gdhim, -it	(neuter)	dawn
me gërmihë (unë gërmih)	(v.)	to dig
gogol, -i gogola, -t	(m.)	bogey, bugbear
gjithandej	(adv.)	everywhere, all over
gjithfarë	(adj.)	all kinds of
me helmue (unë helmoj)	(v.)	to poison
me ikë (unë iki)	(v.)	to escape, flee; to go, leave
jetimore, jetimorja jetimore, -t	(f.)	orphanage
kazëm, kazma kazma, -t	(f.)	pick

koprrac, -i koprracë, -t	(m.)	a stingy person
me u-krijue (krijohet)	(v.)	to be created
lopatë, -a lopata, -t	(f.)	shovel; oar
lugat, -i lugetën, -it	(m.)	hogey, vampire
lulishtë, -a lulishta, -t	(f.)	garden, park
me mbikëqyrë (unë mbikëqyr)	(v.)	to supervise
me mbytë (unë mbys)	(v.)	to kill (except with a firearm); to slaughter; to sink; to flood
ndërgjegje, ndërgjegjja	(f.)	conscience
me u-ngi (unë ngihem)	(v.)	to be satisfied (especially from eating), to be satiated
njaty	(adv.)	right there
pagë, -a paga, -t	(f.)	wage
pastaj	(adv.)	then, afterwards
me u-pendue (unë pendohem)	(v.)	to regret, repent
me premtue (unë premtoj)	(v.)	to promise
qyp, -i qypa, -t	(m.)	earthen pot
rehat	(adv.)	comfortably; well off
rreze, rrezja rreze, -t	(f.)	ray, beam
shêj, -i shêje, -t	(m.)	mark, sign; target; symptom

shërbëtor, shërbëtori shërbëtore, -t	(m.)	servant
me u-shfarue (unë shfarohem)	(v.)	to be wiped out, exterminated, annihilated
me shkarkue (unë shkarkoj)	(v.)	to unload; to discharge, to exonerate
shpërdamje, -a	(f.)	distribution; dis- persion; delivery
shpirtkeq, shpirtkëqij shpirtkeqe, shpirtkëqija	(adj. m.&f.)	wicked, malicious
me shtí tmerin (unë shtij tmerin)	(v.)	to terrorize
me shtÿ (unë shtÿj)	(v.)	to push; to shovel; to urge, instigate; to postpone, put off; adjourn
me shue (unë shuej)	(v.)	to put out, extinguish; to wipe out; to quench
testament, -i testamente, -t	(m.)	will, testament
terror, -i	(m.)	terror
me u-tregue (unë tregohe)	(v.)	to be told, narrated; to be indicated, pointed out; to show oneself
thes, -i thasë, -t	(m.)	sack
thesár, -i thesare, -t	(m.)	treasure
me varrosë (unë varros)	(f.)	to bury
veg, -u vegjë, -t	(m.)	loom

visár, -i (m.) treasure
 visare, -t

vneshtë, -a (f.) vineyard
 vneshta, -t

Shënime:

me dalë lugat (del lugat) to appear as a bogey

me mbetë me gojë hapët (unë mbes me gojë hapet) to be surprised, dumfounded, stunned


Peizazh nga Shijaku, punuar nga Abaz Hodo.



Nji Shaka e Rëndë

1. Para se të hëjmë në klasë, më thuej çka ka ngjã sot në mëngjes në kazermën tuej. Si e di ti se ka ngjã diçka?
2. Nga dritorja pashë tue u-ndalë para kazermës suej një autoambulancë dhe disa automobila. Nga një shaka doli një fat-keqësí që gati qe tue u-bã serioze.
3. Fol, si qe puna? Posa mrríjtëm mbrãmë në kazermë, Aliu shkoi me fjetë dhe e zûni gjumi. Atëherë na menduem me i bã një shaka.
4. Çfarë shakaje? I a hoqëm batanijet dhe i a zhyem fytyrën me bojë këpucësh.
5. A nuk ndjeu gjã, ndërsa po i a lyejshi fytyrën me bojë? Jo, sepse mbrãmë kemi qenë në fejesën e një shoku dhe Aliu kishte pí pak mã shumë se zakonisht.
6. E mandej, çka ngjau? Kur u-zgjue Aliu, mbasi na pá tue qeshë, u-kujtue se ishim tue u-tallë me të.
7. D.m.th. mendoi se i kishi bã diçka të keqe. Po. Atëherë, mbasi u-mat me na gjuejtë me këpucë, kapi një taketuke dhe na gjuejti me të.
8. Kujt i rá taketukja? I rá Sotirit në bark.
9. A u-vrá shumë? Po, filloi t'i rrjedhi gjak, sepse kandi i preftë i tavllës së duhanit i a kishte shkye këmishën e natës dhe i kishte hý në mish.
10. Për këtë arsye paska ardhë autoambulanca! Po, e thirri në telefon njëni prej nesh. Erdhën menjisherë edhe Gjyqtari Hetues, Prokurori i Shtetit dhe Komiseri i Policís.

11. Çka tha doktori? I tha se plaga nuk ishte e madhe dhe se nuk kishte asnji rrezik.
12. Si do të përfundojë, vallë, çashtja? Unë besoj se Sotiri do të kërkojë që të mbyllet çashtja, mbasi të gjithë kemi pak faj.
13. Po, ka disa njerëz që shakatë nuk i durojnë. Dhe disa tjerë që shakatë i bëjnë të rënda.



THE PRESENT PROGRESSIVE

In Lessons 33 (Volume III) and 38 (Volume IV), you learned the formation and use of the present progressive in Albanian. This corresponds to the English present progressive ending with "ing." This is a review for reinforcement and clarification.

Example:

Ai është tue punue (po punon). Mos e trazo tash.
(He is working. Don't bother him now.)

As you can see, the version in the parenthesis (particle po plus indicative present) is also equal to the English progressive. However, the version using po indicates only the moment in which the action is taking place.

Examples:

Pse po ecën kaq shpejt?
(Why are you walking so fast?)

Dikush po troket në derë.
(Somebody is knocking at the door.)

Now compare the following sentences.

Ti je tue shkue shpesh në Tiranë. (As a habit.)
(You are often going to Tiranë)

Ku po shkon?
(Where are you going?)

Po shkoj në Tiranë. (He is about to get on the bus.)
(I am going to Tiranë)

However, the first form of the present progressive jam tue shku can be used in both cases: for intermittent actions or for one action happening one time only.

Aliu u-zgjue tue fërkue sÿt e tue shá. Shokët, mbasi i a kishin zhye fytyrën me bojë këpucësh, i a kishin hjekë batanijet dhe kishte mbetë i zbuluem. U-mat me i gjuejtë me këpucët e tija, por ndërroi mendim. Kapi taketuken (tavllën e duhanit) dhe i gjuejti me të. Fatkeqësisht taketukja i rá njānit prej shokëvet në stomak. Prej dhimbës u-mblodh tue zānë barkun me dorë dhe rá përmbys. Kandi i preftë i take-tukes prej gatarje, i a kishte shkye këmishën e natës dhe i kishte hÿ në mish. Gjaku filloi t'i rrjedhi rrëkajë. Shokut të plagosun i rá të fikët. Shokët u-trembën. Dikush kapi telefonin dhe thirri ambulancën e bashkís. E vūnë shokun në nji vig që kishte sjellë autocambulanca dhe e dërguen në spital. Kishin mrrÿjtë edhe Gjyqtari Hetues, Prokurori i Shtetit e bashkë me ta edhe Komiseri i Policís.

Ata i filluen hetimet dhe mbajtën nji procesverbal. Djelmt diftuen se natën përpara kishin festue fejesën e njānit prej shokëvet. Festimi kishte shkue krejt mirë, plot këngë, pije e lojëna dhe nuk kishte ndodhë as mǎ e vogla grindje a mosmarrë-veshje. Shokët deklaruen se kishin dashë me u-tallë me Alín. Ndërsa flēnte, i kishin vū mustakë me bojë këpucësh dhe i a kishin hjekë batanít.

Aliu, që në fillim ishte zemrue, pse nuk i kishte pëlqye ajo tallje, mǎ vonë ishte pendue. I vīnte keq për shokun e tij. Por ishte pak vonë me zhbā, atē që kishte bā. Ajo që filloi si nji shaka, kishte marrë nji ngjyrë krejt serioze.

Faji nuk ishte vetëm i Aliut.

Shokun që kishin dërgue në spital do t'a operojshin. Megjithëqë plaga nuk ishte e madhe, do t'i a pastrojshin dhe do t'i a qepshin. Shoku do të qëndronte në spital vetëm pak ditë dhe kishte kërkuë që çashtja të mbyllesh.

QUESTIONS-PYETJE

A u-zgjue Aliu tue fërkue sÿt e tue shá? Aliu u-zgjue tue fërkue sÿt e tue bâ çka tjetër? Kush i a kishte zhye fytyrën Aliut? Kush i a kishte hjekë batanijet? Mbasi i a kishin zhye fytyrën me bojë këpucësh, a i a kishin hjekë shokët batanijet? Çka i kishin hjekë shokët që kishte mbetë i zbuluem Aliu? A u-mat me i gjuejtë me këpucët e tija, por ndërroi mendim? Kë deshi me gjuejtë me këpucët e tija, por ndërroi mendim? Çka deshi të bante Aliu para se të ndërronte mendim? A e kapi taketuken dhe i gjuejti me têt? Me çka i gjuejti shokët Aliu? Çka bani Aliu? A i rá njânit prej shokëvet në stomak, fatkeqësisht? Ku i rá taketukja njânit prej shokëvet? A u-mblodh shoku prej dhimbës, tue zânë barkun me dorë dhe rá përmbys? Çka zûni me dorë ai? Pse u-mblodh? Qysh rá? A i a kishte shkye këmishën dhe kishte hÿ në mish, kandi i preftë i taketukes prej gatarje? Çka kishte bâ kandi i preftë i taketukes prej gatarje? Ku kishte hÿ kandi i preftë i tavllës së duhanit mbasi i a kishte shkye këmishën? Cila pjesë e tavllës së duhanit i a kishte shkye këmishën dhe i kishte hÿ në mish? Prej se ishte tavlla e duhanit? A filloi t'i rrjedhi gjaku rrëkajë? Qysh filloi t'i rrjedhi gjaku?

A i rá të fikët shokut të plagosun? Çka i ngjau shokut të plagosun? A u-trembën shokët? Cilët u-trembën? A e kapi dikush telefonin dhe thirri ambulancën e bashkís? Çka bëni dikush? Cilën ambulancë thirri dikush? A e vùnë shokun në një vig, që kishte sjellë autoambulanca dhe e dërguen në spital? Kë vùnë në një vig, që kishte sjellë autoambulanca? Çka kishte sjellë autoambulanca? Kë dërguen në spital? A kishin mrríjtë edhe Gjyqtari Hetues dhe Prokurori i Shtetit? Kush tjetër kishte mrríjtë bashkë me ta? Bashkë me kë kishte mrríjtë edhe Komiseri i Policís? A kishin ardhë me e hetue ngjarjen? Çka kishin ardhë me bā? A i filluen hetimet? Çka filluen? A mbajtën një procesverbal? Çka mbajtën? A diftuen djelmt se, natën përpara, kishin festue fejesën e njānit prej shokëvet? Çka diftuen djelmt se kishin bā natën përpara? Fejesën e kujt kishin festue natën përpara? A kishte shkue festimi krejt mirë? A kishte shkue festimi plot kāngë, pije e lojëna? Si kishte shkue festimi? Çka kishte shkue plot kāngë, pije e lojëna? A kishte ndodhë ndonji grindje a mos-marrëveshje? Çka nuk kishte ndodhë? A deklaruen shokët se kishin dashë me u-tallë me Alín? Me kë kishin dashë me u-tallë shokët? Çka deklaruen shokët? A i kishin vū mustakë me bojë këpucësh ndërsa ai flēnte? Çka i kishin vū me bojë këpucësh ndërsa ai flēnte? A i a kishin hjekë edhe batanijet? Çka i kishin hjekë? A ishte zemrue në fillim Aliu? A ishte pendue mā vonë? A i kishte pëlqye ajo tallje? Aliu, që në fillim ishte zemrue, a ishte pendue mā vonë? A ishte zemrue në fillim

sepse nuk i kishte pëlqye ajo shaka? Pse ishte zemrue në fillim Aliu? Çka nuk i kishte pëlqye Aliut? A i vñite keq për shokun e tij? Pse ishte pendue m̃a vonë? A ishte pak vonë me zhb̃a at̃e që kishte b̃a? Çka ishte pak vonë me zhb̃a? Çka kishte b̃a Aliu? A kishte marr̃e një ngjyr̃e krejt serioze ajo, që filloi si një shaka? Çka kishte marr̃e një ngjyr̃e krejt serioze? A ishte vet̃em faji i Aliut? I kujt ishte faji? A do t'a operojshin shokun, që e kishin d̃ergue në spital? Çka do t'i b̃ajshin shokut, që e kishin d̃ergue në spital? Kush do t'a operonte shokun, që e kishin d̃ergue në spital? A do t'i a pastrojshin plag̃en doktorat? A do t'i a qepshin plag̃en? Çka do t'i b̃ajshin, megjith̃eq̃e plaga nuk ishte e madhe? A do t̃e q̃endronte në spital vet̃em pak dit̃e? Kush do t̃e q̃endronte në spital vet̃em pak dit̃e? Kush i kishte th̃añe se do t̃e q̃endronte në spital vet̃em pak dit̃e? A kishte k̃erkue që t̃e mbyllesh çashtja? Kush kishte k̃erkue që çashtja t̃e mbyllesh? Çka kishte k̃erkue shoku i plagosun?

A ju ka r̃a t̃e fik̃et ndonjiher̃e? Kujt nuk i ka r̃a t̃e fik̃et kurr̃e? Sa kande ka kjo tryez̃e? Cila tryez̃e ka kat̃er kande? Kush e ka zhye librin? Çka kam zhye uñe?

Translate the following sentences into Albanian:

1. He began to rub his arm.
2. My face was covered with perspiration.
3. He had a pain in the abdomen.
4. I got frightened when I saw him on a stretcher.
5. She was badly wounded in the stomach.
6. I didn't want to soil the wall.
7. Where is the district attorney's office located?
8. The judge came as (when) they were leaving.
9. The city hall and the police department are in the same building.
10. Why are you measuring this room?

autoambulancë, -a autoambulanca, -t	(f.)	ambulance
bashkí, -ja bashkí, -t	(f.)	city hall
bojë këpucësh	(f.)	shoe polish
me diftue (unë diftoj)	(v.)	to tell, narrate; to show, indicate, point out
me durue (unë duroj)	(v.)	to stand (endure); to be patient; to tolerate
festim, -i festime, -t	(m.)	celebration
me fërkue (unë fërkoj)	(v.)	to rub
gastare, gastarja gastare, -t	(f.)	glass (material); pieces of broken glass
gjyqtár hetues	(m.)	coroner, investigating judge
hetim, -i hetime, -t	(m.)	investigation
kand, -i kande, -t	(m.)	corner, angle
komiser, -i komiserë, -t	(m.)	chief (of police)
komiser policije	(m.)	chief of police
me lye (unë lyej)	(v.)	to paint; to spread (butter, etc.)
me u-matë (unë matem)	(v.)	to aim; to be measured; to hesitate
mosmarrëveshje, -a mosmarrëveshje, -t	(f.)	disagreement, misunderstanding

mustak, -u mustakë, -t musteqe, -t	(m.)	mustache
me ndërrue mendim (unë ndërroj mendim)	(v.)	to change one's mind
me operue (unë operoj)	(v.)	to operate on (surgery)
me pasë faj (unë kam faj)	(v.)	to be at fault; to be blamed
me përfundue (unë përfundoj)	(v.)	to conclude, end
i, e, të plagosun të plagosuna	(adj. m. & f.)	wounded
me qepë (unë qep)	(v.)	to sew, stitch
rrëkajë	(adv.)	gushing; pouring down
stomak, -u	(m.)	stomach
me shkye (unë shkyej)	(v.)	to tear, rip
taketuke, taketukja taketuke, -t	(f.)	ash tray
tavllë, -a tavllë, -t	(f.)	ash tray; backgammon
tavllë duhani	(f.)	ash tray
me u-trembë (unë trembem)	(v.)	to get scared, to be frightened
i, të zbuluem e, të zbulueme	(adj. m. & f.)	uncovered, discovered; revealed, disclosed
me zhbâ (unë zhbâj)	(v.)	to undo
me zhye (unë zhyej)	(v.)	to dirty, soil, foul, smear

Shënime:

me bâ operacion
(unë bāj operacion)

(v.)

to operate on

me u-bâ operacion
(unë bâhem operacion)

(v.)

to be operated on

Si qe puna?

What happened?

kishte marrë një ngjyrë krejt serioze

had become a serious
matter

me (i) ra të fikët
(mue më bje të fikët)

(v.)

to faint



Kujtim Buza: «Rrugë karakteristike në Prizren».

Në Kurthë

1. A e dini në se duhet të ndërrojmë tren në kufi?
Po, duhet t'a vazhdoni udhëtimin me tren jugosllav. Në cilin qytet të Jugosllavis do të shkoni?
2. Do të shkoj në Beograd për të vizitue Panairin Ndërkombëtar.
A mos jeni tregtar?
3. Jam përfaqësues për të gjithë Shqipnín për disa maqina e vegla bujqësore si traktora, parmenda etj.
Ku e keni zyrën qendrore të përfaqësimit?
4. Në Durrës, por kam degë pothuej në të gjitha qytetet e Shqipnís; ajo e Beratit është më e rëndësishmja.
Pse është më e rëndësishmja?
5. Sepse atje maqinat bujqësore shiten më shumë.
Ashtu duhet të jetë; harrova se Berati është në zonën e Myzeqës, fusha më e madhe dhe më pjellore e gjithë Shqipnís.
6. Sidomos atje, plugjet primitive kanë fillue të zavendësohen me maqina bujqësore moderne.
Jemi tue i u-afrue kuffinit; báni mirë t'i ulni poshtë valixhet.
7. Sa mirë që m'a kujtuet: duhet të rregulloj cingaret.
Pse, a nuk i keni rregullue kur u-nisët?
8. Nuk më kuptuet! Kam shumë paqeta me cingare dhe nuk më mjaftojnë të gjithë xhepat.
A s'keni vend në valixhe?
9. Po t'i lâ në valixhe do të m'i shofin nëpunësit e doganës dhe do të m'i konfiskojnë.
S'ka arsye pse të ju a konfiskojnë në goftë se pagueni taksën doganore.

10. Pikërisht për këtë arsye jam në hall, sepse nuk due të paguej taksën doganore. Me fjalë tjera, cingaret doni t'i nxirni kontrabandë!
11. Prandej, a mund të m'i merrni këto njizet paqeta cingare dhe të m'i këtheni kur t'a kalojmë kuffinin? Pse jo, por fatkeqësisht nuk mund të ju a këthej më.
12. Pse nuk mund të m'i këtheni? Sepse jam Inspektor Dogane! Bile, kur të mrrijmë në doganë, do të flasim edhe për cingaret që keni ndër xhepa!



Grykë pusi (Shkodër).

THE PRESENT INDICATIVE WITH THE PRESENT SUBJUNCTIVE

In Lesson 73, we learned that the imperfect subjunctive is mostly used with the simple past. Now we are dealing with the present subjunctive, a tense used primarily with the present indicative mode. Here we like to add that the present subjunctive is also used with the present indicative and the future.

Examples:

Ai vjen gjithnji të na shofi.
(He always comes to see us.)

Ai ka ardhë të mësojë gjuhën shqipe.
(He has come to study the Albanian language.)

Ajo do të vijë këtu që t'api disa leksione.
(She will come here to give some lectures.)

As we have said before, in most cases the subjunctive corresponds to the English infinitive. However, with certain verbs that cause others to act (such as command, order, forbid, demand, request, etc.), you will see a form of the English subjunctive used.

Example:

Kapiteni e urdhënoi atë ta kryejë punën sot.
(The captain ordered that he finish the job today.)

Treni që shkonte për Jugosllaví po i avitesh kufinit. Vasili, që po udhëtonte në klasë të parë, nxori prej dy valixhevet të tija shumë paqeta cingare dhe i futi ndër xhepa. Mirëpo, për fat të keq, Vasili kishte m̃a pak xhepa se paqeta cingare, prandej i u-drejttue një zotnije, i cili ishte i vetmi shok udhëtimi n'at vagon, dhe i tha se ishte në hall të madh mbasi nuk dinte ku t'i futte të gjitha paqetat. Zotnija, mbasi e shikoi me çudí, i u-përgjegj se nuk e merrte vesh pse ishte në hall. Atëherë Vasili i spiegoi se ndër xhepa kishte futë paqeta me cingare shumë të mira dhe se i kishin mbetë ndër valixhe paqeta tjera me cingare edhe m̃a të mira.

Zotnija ende nuk e kuptonte se ku donte me dalë shoku i tij i udhëtimit dhe i a priti: "Gëzohem shumë". Vasili, tue buzëqeshë, vazhdoi tue thënë se cingaret ndër valixhe nuk ishin të sigurta e, me siguri, dogana do t'i a konfiskonte të gjitha.

Kët radhë zotnija e mori vesh fare mirë hallin e Vasilit, por megjithatë la me kuptue edhe një herë se nuk e kishte të qartë çashtjen e xhepavet, të valixhevet dhe të cingarevet, prandej i u-lut të spiegehesh m̃a mirë.

Vasili, tue shikue cingaret dhe tue fshã, i vûni në dukje zotnís se nuk dishronte të paguente taksën doganore dhe se e vetmja mënyrë për t'i shpëtue taksës ishte që zotnija të kishte mirësin t'i merrte një njizet paqeta cingare, t'i fshehte ndër xhepa e pastaj t'i a këthente kur të kalojshin kufinin.

Atëherë zotnija i u-përgjegj se do t'i a merrte me gjithë qejf cingaret, porse fatkeqësisht, nuk mund t'i a këthente më.

Vasili i çuditun pyeti: "Pse?".

"Sepse jam Inspektor Dogane" i u-përgjegj shoku i udhëtimit.

QUESTIONS-PYETJE


A po i avitesh kuffinit treni që shkonte për Jugosllaví? Treni që shkonte për ku po i avitesh kuffinit? A po udhëtonte Vasili në klasë të parë? Kush ishte tue udhëtue në klasë të parë? Në cilën klasë ishte tue udhëtue Vasili? A nxori Vasili prej dy valixhevet të tija shumë paqeta cingare dhe i futi ndër xhepa? Kush nxori prej dy valixhevet të tija shumë paqeta cingare dhe i futi ndër xhepa? Prej ku nxori Vasili shumë paqeta cingare dhe i futi ndër xhepa? Sa paqeta cingare nxori Vasili prej dy valixhevet të tija? Ku i futi Vasili paqetat që nxori nga valixhet e tija? Për fat të keq, a kishte Vasili më pak xhepa se paqeta cingare? Kush kishte më pak xhepa se paqeta cingare? A i u-drejtue një zotnije tue i thënë se ishte në hall të madh? Kujt i u-drejtue Vasili tue i thënë se ishte në hall të madh? Në çfarë halli ishte Vasili? A ishte zotnija i vetmi shok udhëtimi n'at vagon? Sa shokë udhëtimi kishte Vasili në vagon? A i tha edhe se nuk dinte ku t'i futte të gjitha paqetat? Kush i tha shokut t'udhëtimit se nuk dinte ku t'i futte të gjitha paqetat? Çka i tha Vasili shokut t'udhëtimit? Kujt i tha Vasili se nuk dinte ku t'i futte të gjitha paqetat?

A i u-përgjegj zotnija, mbasi e shikoi me çudí, se nuk e merrte vesh pse ishte në hall? Kujt i u-përgjegj zotnija se nuk e merrte vesh pse ishte në hall? Si i u-përgjegj zotnija Vasilit, mbasi e shikoi me çudí? Atëherë, a i spiegoi Vasili se ndër xhepa kishte futë paqeta me cingare shumë të mira? Çka i spiegoi Vasili zotnís? Ku kishte futë Vasili paqeta me cingare shumë të mira? Çfarë cingaresh kishte futi Vasili ndër xhepa? Po paqetat që kishin mbetë ndër valixhe, a ishin me cingare edhe mǎ të mira? Paqeta me çfarë cingaresh i kishin mbetë Vasilit ndër valixhe? Ku i kishin mbetë Vasilit paqeta me cingare edhe mǎ të mira se ato që kishte futë ndër xhepa? A e kuptoi zotnija se ku donte me dalë shoku i tij i udhëtimit? Kush nuk e kuptonte ende se ku donte me dalë shoku i tij i udhëtimit? Çka nuk kuptonte ende zotnija? A i a priti: "Gëzohem shumë"? Kush i a priti "Gëzohem shumë"? Qysh i a priti zotnija? Vasili, tue buzëqeshë, a vazhdoi tue thǎnë se cingaret ndër valixhe nuk ishin të sigurta? Kush tha, tue buzëqeshë, se cingaret ndër valixhe nuk ishin të sigurta? Çka vazhdoi tue thǎnë Vasili? Cilat cingare nuk ishin të sigurta? A tha edhe se me siguri dogana do t'i a konfiskonte të gjitha? Kush do t'i a konfiskonte Vasilit të gjitha cingaret? Çka do të bǎnte dogana? Çka do t'i konfiskonte dogana Vasilit? A e mori vesh zotnija kët herë hallin e Vasilit? Kush e mori vesh kët radhë hallin e Vasilit? Çka mori vesh fare mirë kët radhë zotnija? Por, a la me kuptue edhe një herë se nuk e kishte të gartë çashtjen e xhepave, të valixheve e të cingareve?

Kush la me kuptue se nuk e kishte të qartë çashtjen e xhepavet, të valixhevet dhe të cingarevet? Çka la me kuptue zotnija? Prandej, a i u-lut Vasilit që të spiegolesh më mirë? Kujt i u-lut zotnija të spiegolesh më mirë? Vasili, tue shikue cingaret dhe tue fshâ, a i vûni në dukje zotnîs se nuk dishronte të paguente taksën doganore? Çka vûni në dukje Vasili? Cilën taksë nuk donte të paguente Vasili? Çka nuk donte të bânte Vasili? A vazhdoi tue thânë se e vetmja mënyrë për t'i shpëtue taksës ishte që zotnija t'i merrte nja njizet paqeta cingare? Cila ishte e vetmja mënyrë për t'i shpëtue taksës doganore? Për t'i shpëtue Vasili cilës taksë, zotnija duhet të merrte nja njizet paqeta cingare? Çka duhet të bânte zotnija kështu që Vasili t'i shpëtonte taksës? A i u-lut që t'i a këthente kur të kalojshin kuffnin? Çka duhet t'i këthente zotnija Vasilit kur të kalojshin kuffnin? Kur duhet t'i a këthente zotnija cingaret Vasilit? Atëherë, a i u-përgjegj zotnija se do t'i a merrte cingaret me gjithë qejf, porse, fatkeqësisht, nuk mund t'i a këthente më? Si i u-përgjegj zotnija Vasilit? Çka do t'i merrte zotnija Vasilit? Çka nuk mund t'i këthente më? A pyeti Vasili, i çuditun: "Pse"? Si pyeti Vasili, i çuditun? Qysh ishte Vasili kur pyeti: "Pse"? A i u-përgjegj shoku i udhëtimit: "Sepse jam Inspektor Dogane"? Qysh i a priti shoku i udhëtimit? Çfarë detyre kishte zotnija që po udhëtonte në të njëjtin vagon me Vasilin?

Kush i avitet tryezës kur do me hangër? Çka bâni ju kur

doni me hangër? A punohet toka me parmendë? Me çka punohet toka? Cilët e punojnë tokën me traktora? Me çka e punojnë tokën disa bujq? A kanë Shtetet e Bashkueme përfaqësues në Shqipëri? Ku s'kanë përfaqësues Shtetet e Bashkueme? A është toka e Kalifornisë pjellore? Toka e cilit shtet është pjellore? Në sa lagje është e ndame Tirana? Cili qytet është i ndamë në shumë lagje?



Translate the following sentences into Albanian:

1. How many suitcases will you take with you?
2. Have you ever gone outside the U.S. boundaries?
3. They caught him trying to smuggle in some merchandise.
4. Will you be so kind as to give me a cigarette?
5. When are you going to return the book to me?
6. Do you understand why this is so?
7. He brought the matter to my attention.
8. Myzeqe is located in the central part of Southern Albania.
9. Do you know how much this house was sold for?
10. Come a little closer to the table, please.

me u-avitë (unë avitem)	(v.)	to approach, get closer
me buzëqeshë (unë buzëqesh)	(v.)	to smile
çudí, -ja çudí, -t	(f.)	surprise, astonishment, wonder
i, e, të çuditun të çudituna	(adj. m. & f.)	surprised, astonished
me u-drejtue (unë drejtohem)	(v.)	to straighten out; to turn to (usually for help); to be headed for
për fat të keq	(adv.)	unfortunately
fatkeqësisht	(adv.)	unfortunately
me fshehë (unë fsheh)	(v.)	to hide, conceal
inspektor, -i inspektora, -t	(m.)	inspector
jugosllav, -e jugosllavë	(adj. m. & f.)	Yugoslav
Jugosllaví, -ja	(f.)	Yugoslavia
me konfiskue (unë konfiskoj)	(v.)	to confiscate
kontrabandë, -a kontrabanda, -t	(f.)	contraband
kurthë, -a kurtha, -t	(f.)	trap
i, të ndamë e, të ndame	(adj. m. & f.)	divided, separated
panair, -i panaire, -t	(m.)	fair (competitive exhibition)
parmendë, -a parmenda, -t	(f.)	plow

me pasë mirësín (A keni mirësín? A do të kishi mirësín?)	(v.)	Would you be so kind?
përfaqësim, -i	(m.)	representation
plug, -u plugje, -t	(m.)	plow
primitiv, -e primitivë	(adj. m. & f.)	primitive
me spiegue (unë spiegoj)	(v.)	to explain
me u-spiegue (unë spiegohem)	(v.)	to explain oneself; to be explained
me u-shitë (unë shitem)	(v.)	to be sold
taksë doganore	(f.)	customs duty
traktor, -i traktora, -t	(m.)	tractor
me ulë (unë ul)	(v.)	to lower
i vetmi, të vetmit	(m.)	the only one, unique
e vetmja, të vetmet	(f.)	the only one, unique
me u-zavendësue (unë zavendësohem)	(v.)	to be replaced

Shënime:

bāni mirë të ...		you had better
Nuk kuptonte se ku donte me dalë.		He didn't know what he was driving at.
me nxjerrë kontrabandë (unë nxjerr kontrabandë)	(v.)	to smuggle out
me futë kontrabandë (unë fus kontrabandë)	(v.)	to smuggle in

kët radhë

this time

i vûni në dukje

he brought to his
attention

me lânë me kuptue
(unë lâ me kuptue)

(v.)

to imply

me siguri

for sure




Këngëtari popullor Besim Murati

Nji Detár Zbarkon
në Nju Jork

1. Si ju quejnë? Fred Smith.
2. Nga jeni? Nga Oklahoma Siti.
3. Pse keni ardhë në Nju Jork? Jam këthye dje mbasdreke nga Koreja, mbas tri vjetësh shërbimi ushtarak.
4. Në cilin hotel keni rá? Në hotelin Uallkot, në rrugën e 31-të.
5. A keni folë në hotel me ndonji njeri, përveç portierit? Jo. Porsa mrrifja aty shkova në banjë me u-lá dhe mbasi u-rrova shkova e mora një automobil me qirá.
6. Ku shkuet me automobil? Shkova në një lokal këcimi me emnin Komodorë.
7. E dij çfarë lokali është. Me kë u-shoqnuet aty? Me një vajzë bjonde; më tha se quhesh Rozë.
8. A e dini ku banon? Jo. E përcolla deri në shtëpi, por nuk i vuna mend rrugës; ishem i hutuem nga ngjarja.
9. Më tregoni çka keni folë me vajzën. I tregova mbi jetën në Korë, i thash se atje s'kam pasë rasë me u-dëfrye dhe...
10. Dhe se kishi me vete shumë të holla; a është e vërtetë? Po, ashtu është; i tregova edhe sa: 760 dollarë.
11. Gjatë kohës që ishi së bashku në lokal, a e patë vajzën tue folë me ndokënd? Jo, por u-çue nga tryeza dy herë. Mos mendoni keq për vajzën, sepse...
12. Mos u-báni merak. Vazhdoni, ç'ngjau mandej? Kur u-mbyll lokali hypëm n'automobil dhe shkum në një zonë pak t'errët, në periferi të qytetit.

- | | |
|--|---|
| <p>13. Sa kohë kishte që ishi aty, para se të dukesh grabitsi?</p> | <p>Nja dhetë minuta. Papritmas një burrë i maskuem m'u-kërcënue me revolver që t'i dorëzojshem të gjitha të hollat që kishem në xhep.</p> |
| <p>14. Po pastaj?</p> | <p>Pastaj hoqi nga gishti i vajzës një unazë me një xhevahír dhe iku.</p> |
| <p>15. Kush ju porositi me ardhë ke unë?</p> | <p>Askush. Adresën tuej e pashë në numërorin telefonik në faqen e detektivavet privatë.</p> |
| <p>16. Do të ju thërras unë nesër; për tash mos u-bâni merak!</p> | <p>Si urdhënoni, Zotní. Ju falem nderit.</p> |

MJESHTER SHQIPTAR I ARMEVE TE ZJARRIT



Pushka e gjatë "Karajfilja" e armëtarit Ali Grabovë (Gramsh) e zbukuruar me sovát, rreth shekullit XVIII.

DIRECT AND INDIRECT SPEECH

Direct speech: Albanian does not have the verb "to quote" as English has. This verb is sometimes used in English speech to signal the beginning of a quotation. An Albanian removes the conjunction "that" used after the verbs "to say," "to tell," "to ask," etc., and inserts the quote verbatim.

The same rule is also applied in writing, but a colon is used after the introductory verb. This is followed by quotation marks indicating the beginning and the end of the quoted matter.

In dialogues, dashes are used instead of quotation marks.

Indirect speech: To convert direct speech to indirect, all you have to do is reinstate the conjunction "that," se, and change the person and tense of the verb to third person.

Examples:

Direct speech:

Rifati i tha Dalipit:
"Nesër do të shkoj në
spital për një vizitë
mjekësore."
(Rifat said to Dalip,
"Tomorrow I'll go to
the hospital for a
medical checkup.")

"Nga po vjen e ku po
shkon?" e pyeti plaku
udhëtarin.
("Where are you coming
from and where are you
going?" the old man
asked the traveler.)

Indirect speech:

Rifati i tha Dalipit
se nesër do të shkojë
në spital për një
vizitë mjekësore.
(Rifat told Dalip that
tomorrow he will go
to the hospital for a
medical checkup.)

Plaku e pyeti udhëtarin
se nga po vinte e ku po
shkonte.
(The old man asked the
traveler where he was
coming from and where
he was going.)

Ismeti i tha Hysniut:
"Shko e merre makinën
e shkrimit!"
(Ismet said to Hysni,
"Go and get the type-
writer!")

Ismeti i tha Hysniut
të shkonte e të merrte
makinën e shkrimit.
(Ismet told Hysni to go
and get the typewriter.)

Note: As you can see in the last example, the conjunction "that" is not used in indirect speech when the verb in the direct speech is in the imperative mode.



Nji detár u këthye n'atdhé prej Lindjes së Largme. Zbriti në Nju Jork dhe mbasi kishte qenë larg qytetnimit për mâ se trí vjet, vendosi me kalue nja dy a tri ditë në kët qytet të famshëm para se të nisesh për n'Oklahoma, ku banojshin prindët e tij.

Mori një dhomë në një hotel të mirë dhe mbasi u-rrue dhe bëni një banjë, doli me bā qejf. Shkoi në një lokal këcimi ku u-njoft me një vajzë flokverdhë dhe të bukur. Mbasi këcyen dhe pinë, deri afër mesnatës, detari i u-lut vajzës që t'a lejonte me e shoqñue deri në shtëpí, dhe vajza e pranoi propozimin e tij. Gjatë mbrāmjës, detari i kishte kallxue vajzës se, për tri vjet nuk kishte pasë rasë me u-dëfrye dhe se kishte ruejtë shumë të holla, të cilat i kishte me vete. Kur u-mbyll lokali, vajza dhe detari hypën në një automobil, që ky kishte marrë me qirá. Mbasi u-larguen pak, detari e ndaloi automobilin dhe filloi me bā dashuní me vajzën. Por nuk shkoi shumë kohë e pa pritë e pa kujtue, një burrë i maskuem i a vûni detarit revolverin në brinjë tue i thānë t'i a dorëzonte të gjitha të hollat, menjisherë. Ky, tue e pá veten ngusht, s'pati çka me bā dhe i a dorëzoi. Grabitsi mori edhe nga vajza një unazë ari me një xhevahír të madh, që ajo kishte në gisht dhe u-zhduk. Kështu detari i shkretë mbeti pa asnjë lek në xhep.

Çoi vajzën në shtëpí dhe pa humbë kohë thirri në telefon një detektiv privat. Detektivi, megjithëqë kishte qenë tue fjetë, pati dhimbë për të dhe i tha të shkonte menjisherë në

shtëpí të tij. Detari i a spiegoi ngjarjen prej fillimit deri në mbarim tue e përshkrue, sa mundi, burrin që i a kishte grabitë të 760 dollarët dhe vajzën, e cila kishte pasë rasë, gjatë mbrâmjes, me i pá ato të holla. Detektivi e siguroi detarin se do të bñante çka ishte e mundun për t'a gjetë grabitsin.

Të nesërmen, detektivi që ishte një burrë i fortë dhe i trashë nga trupi, por i hollë nga mendja, shkoi në lokalin ku kishte qenë detari dhe bëni pikërisht çka kishte bë detari natën përpara. Gjeti vajzën dhe simbas përshkrimit edhe grabitsin, dhe pá se vajza kishte në gisht një unazë me një xhevahir të madh. Gjatë mbrâmjes e pá vajzën tue folë, një dy herë, me grabitsin dhe e kuptoi se ajo ishte një bashkëpunëtore e tij.

Kur u-mbyll lokali, detektivi e mori vajzën në veturë të vet dhe mbasi u-larguen pak u-ndaluen me bë dashuní. Por detektivi i mbante sýt çelë për grabitsin mbasi ishte i sigurtë se do të dukesh shpejt. Gjatë mbrâmjes, me qëllim, i kishte thënë vajzës se kishte me vete më shumë se 2000 dollarë.

Nuk shkoi shumë kohë dhe grabitsi u-duk dhe deshi me bë me detektivin po atë që kishte bë me detarin. Kur grabitsi i a mori portofolin detektivit dhe deshi me i a marrë unazën vajzës, detektivi, me një shpejtësi të madhe, i a kapi grabitsit dorën që mbante revolverin dhe e detyroi t'a hudhte në tokë. Mbasi u a lidhi duert të dyve, i a dorëzoi Policífs.

Ndër xhepat e grabitsit u-gjetën të 760 dollarët, të cilët Policija i a këtheu marinarit dhe e porositi që një

herë tjetër t'ishte më i kujdesshëm me njerëz të panjoftun e sidomos me bjonde që e kanë qendrën ndër lokale publike.

QUESTIONS - PYETJE

A u-këthye një detar n'atdhë prej Lindjes së Largme? Ku u-këthye një detar prej Lindjes së Largme? Kush kishte qenë larg qytetnimit për më se tri vjet? Për sa vjet kishte qenë larg qytetnimit detari? A vendosi detari me kaluar një dy a tri ditë në Nju Jork? Kush vendosi me kaluar një dy a tri ditë në Nju Jork? Ku banojshin prindët e tij? Kush do të niseshte për Oklahoma, mbasi të kalonte një dy a tri ditë në Nju Jork? Kush mori një dhomë në një hotel të mirë? Çka bënte detari? A u-rrue dhe bënte një banjë detari para se të dilte me një qejf? Kush shkoi në një lokal këcimi? Ku shkoi detari? Kush u-njoft me një vajzë flokverdhë dhe të bukur? Me kë u-njoft detari? Si ishte vajza, me të cilën u-njoft marinari? Me kë këceu dhe piu detari deri afër mesnatës? Çka bënte detari dhe vajza deri afër mesnatës? Kush i u-lut vajzës që t'a lejonte me e shoqëru deri në shtëpi? Kujt i u-lut detari që t'a lejonte me e shoqëru deri në shtëpi? A e pranoi vajza propozimin e tij? Kush e pranoi propozimin e detarit? Çka pranoi vajza? A i kishte treguar detari vajzës, gjatë mbrëmjes, se për tri vjet nuk kishte pasë rasë me u-dëfrue? Çka i tregoi detari vajzës? A kishte shumë të holla me vete detari? Kush kishte shumë të holla me vete? A hypën në një automobil vajza dhe detari kur u-mbyll lokali? Cilët hypën në një automobil?

Ç'bânë vajza dhe detari kur u-mbyll lokali? A e kishte marrë me qirá automobilin detari? Çka kishte marrë me qirá detari? Kush filloi me bâ dashuní me vajzën? Me kê filloi me bâ dashuní detari? A i a vûni revolverin në brîjë, pa pritë e pa kujtue, një burrë i maskuem? Kush i a vûni detarit revolverin në brîjë pa pritë e pa kujtue? Çka i ngjau detarit pa pritë e pa kujtue? A i tha burri i maskuem detarit t'i a dorëzonte të hollat menjherë? Çka i tha burri i maskuem detarit? A e pá veten ngusht detari? Qysh e pá veten detari? A pati çka me bâ? A i a mori grabitsi vajzës unazën? Kujt i a mori grabitsi unazën? A kishte unaza një xhevahír të madh? Kush e pati unazën në gisht? Ku e kishte vajza unazën? A u-zhduk grabitsi me të hollat dhe me unazën? Çka bâni grabitsi? Kush mbeti pa asnjë lek në xhep? Kush e çoi vajzën në shtëpí? Kê çoi detari në shtëpí? A thirri në telefon një detektiv privat pa humbë kohë? Çka bâni detari pa humbë kohë? A kishte qenë tue fjetë detektivi? Kush kishte qenë tue fjetë? Çka kishte qenë tue bâ detektivi? A pati dhimbë detektivi për detarin? Kush pati dhimbë për detarin? Kush i tha marinarit të shkonte menjherë në shtëpí të tij? A i a spiegoi detari ngjarjen detektivit prej fillimit deri në mbarim? Kush i a spiegoi ngjarjen detektivit prej fillimit deri në mbarim? A i a përshkroi, sa mundi, burrin e maskuem që i a kishte grabitë të 760 dollarët? Kush i a përshkroi, sa mundi, burrin e maskuem që i a kishte grabitë të 760 dollarët? A i a përshkroi edhe vajzën? Kush e siguroi detarin se do të bante çka ishte e

mundun për t'a gjetë grabitsin? A shkoi detektivi të nesërmen në lokalin ku kishte qenë detari? Çka bëni detektivi të nesërmen? A ishte detektivi një burrë i fortë dhe i trashë nga trupi, por i hollë nga mendja? Çfarë burri ishte detektivi? A bëni detektivi tamam atë që kishte bërë detari natën përpara? Kush bëni po atë që kishte bërë detari natën përpara? A e gjeti detektivi, simbas përshkrimit, vajzën dhe grabitsin? Kë gjeti detektivi? A kishte vajza në gisht një unazë me një xhevahir të madh? Çka bëri detektivi në gishtin e vajzës? A e bëri detektivi vajzën tue folë me grabitsin, gjatë mbrëmjes? Me kë e bëri detektivi vajzën tue folë? A e kuptoi detektivi se vajza ishte bashkëpunëtorja e grabitsit? Çka kuptoi detektivi? A e mori vajzën në veturë të vet detektivi, kur u-mbyll lokali? Ç'bëni detektivi kur u-mbyll lokali? A u-ndaloi detektivi me bërë dashuri me vajzën, mbasi u-larguen pak? Ç'bëni detektivi mbasi u-larguen pak? Kush i mbante shtet çelë për grabitsin? Si i mbante detektivi shtet? A ishte i sigurtë detektivi se do të dukesh shpejt grabitsi? Kush i kishte thënë me qëllim vajzës gjatë mbrëmjes, se kishte me vete më shumë se 2000 dollarë? Çka i kishte thënë detektivi vajzës me qëllim? A shkoi shumë kohë deri sa u-duk grabitsi? Kush u-duk? Kush desh i me bërë me detektivin po atë që kishte bërë me detarin? Çka desh i me bërë me detektivin grabitsi? Kush i a mori portofolin detektivit? Kujt i a mori portofolin grabitsi? Kush desh i me i a marrë vajzës unazën? Çka bëni detektivi kur grabitsi desh i me i a marrë vajzës unazën? Kush i a kapi grabitsit dorën që

mbante revolverin? A e detyroi detektivi grabitsin t'a hudhte revolverin në tokë? Kë detyroi detektivi që t'a hudhte përdhë revolverin? A u a lidhi duert të dyve, detektivi? Cilëve u a lidhi duert detektivi? A i a dorëzoi Policis grabitsin dhe vajzën? Kujt i a dorëzoi detektivi grabitsin dhe vajzën? A u-gjetën ndër xhepat e grabitsit të 760 dollarët? Ku u-gjetën të 760 dollarët? A i a këtheu Policija të hollat detarit? Kush i a këtheu të hollat detarit? Ç'bani Policija? A e porositi detektivi marinarin që një herë tjetër t'ishte më i kujdesshëm me njerëz të panjof-tun? Kë porositi detektivi që një herë tjetër t'ishte më i kujdesshëm me njerëz të panjof-tun e sidomos me bjonde që e kanë qendrën ndër lokale publike?



Vallja e shpatave

Translate the following sentences into Albanian:

1. Can you describe the robber to me?
2. It seemed to me that he was very dumb.
3. Do not throw the lit cigarette anywhere!
4. Many famous people remained unknown for a long time.
5. Don't forget to sign that official circular (memorandum).
6. "I saw myself in a tight spot; therefore, I had to do it," said the defendant.
7. The robber got out of the airplane and disappeared.
8. The president said, "I'll talk about taxes some other time, not today."
9. This room is dark; I can't work here.
10. "Bring in the soldier for questioning!" the officer said to the guard.

adresë, -a adresa, -t	(f.)	address
bashkëpunëtore, bashkëpunëtorja bashkëpunëtore, -t	(f.)	collaborator, cooperator, co-worker
bjond, -e	(adj. m.&f.)	blond(e)
brîjë, -a brîjë, -t	(f.)	rib
çelë	(adv.)	open
detár, -i detarë, -t	(m.)	sailor, seaman
detektiv, -i detektivë, -t	(m.)	detective
me detyrue (unë detyroj)	(v.)	to oblige, compel
me u-dëfrye (unë dëfrehem)	(v.)	to have fun; to enjoy oneself
i, e, t'errët t'errta	(adj. m.&f.)	dark
fillim, -i fillime, -t	(m.)	beginning, start
flokverdhë	(adj. m.&f.)	blond(e)
me grabitë (unë grabis)	(v.)	to rob; to kidnap; to hijack
grabitës, -i grabitës, -it	(m.)	robber; kidnapper; hijacker
me hudhë (unë hudh)	(v.)	to throw, toss
i, të hutuem e, të hutueme	(adj. m.&f.)	absentminded, confused

këcim, -i këcime, -t	(m.)	dance, dancing; jump, jumping
me u-kërcënuë (unë kërcënohem)	(v.)	to be threatened, menaced; to threaten, menace
Lindja e Largme	(f.)	Far East
lokal, -i lokale, -t	(m.)	dance hall; coffee house; restaurant; bar
marinár, -i marinarë, -t	(m.)	sailor, seaman
i, të maskuem e, të maskueme	(adj. m.&f.)	masked
me u-ndalue (unë ndalohem)	(v.)	to stop; to be prohibited, banned, forbidden
i, e, të panjoftun të panjoftuna	(adj. m.&f.)	unknown
papritmas	(adv.)	suddenly, unexpectedly, all of a sudden
periferí, -ja periferí, -t	(f.)	suburb
me përcjellë (unë përcjell)	(v.)	to accompany; to show to (door); to see off (at the airport, etc.)
përshkrim, -i përshkrime, -t	(m.)	description
me përshkrue (unë përshkruej)	(v.)	to describe
portier, -i portierë, -t	(m.)	doorman; goalkeeper
portofol, -i portofole, -t	(m.)	wallet
propozim, -i propozime, -t	(m.)	proposition, proposal
qarkore, qarkorja qarkore, -t	(f.)	circular (memorandum)

me sigurue (unë siguroj)	(v.)	to assure, insure, guarantee
me u-shoqnue (unë shoqnohem)	(v.)	to be escorted, accompanied, associated with
shpejtësi, -ja	(f.)	speed, velocity
veturë, -a vetura, -t	(f.)	taxi
xhevahír, -i xhevahire, -t	(m.)	diamond, gem, jewel
me zbarkue (unë zbarkoj)	(v.)	to land (on shore from a ship)
me u-zhdukë (unë zhdukem)	(v.)	to disappear

Shënime:

Mbeti pa asnji lek në xhep.	He remained broke.
numërorator telefonik	telephone directory
tue e pá veten ngusht	seeing himself in a tight spot
S'pati çka me bâ.	He had no choice.
pa pritë e pa kujtue	suddenly, unexpectedly, all of a sudden

Dimni

1. Ditët janë zvoqlue shumë e kjo d.m.th. se dimni nuk është fort larg.
Po, jam tue e pritë dimnin me kënaqësi të madhe.
2. Pse, a ju pëlqen dimni?
Shumë! Për mue dimni është stina më e bukur e vjetit.
3. Ashtu? Dimni ka shumë të këqija, mos harroni: malevet e pyjevet u humb bukurija, fushat janë pa gjallëni dhe...
Qielli është i vrënë, fryn erë e ftohtë, ka akull e borë, por ka edhe shumë sende të tjera të mira.
4. Nga cili vend i Shqipërisë jeni ju?
Unë kam lë në Kavajë, ku nuk bën të ftohtë, por kam jetue për shumë kohë në malet e Shqipërisë së Veriut.
5. A janë të nalta malet atje?
Janë mjaft të nalta dhe dimni është i ashpër, por i shëndoshë.
6. Atëherë atje duhet të ketë edhe bishë t'egra!
Po, ka pak aty-këtu; nuk e di pse, por këto kohë e fundit bishët kanë fillue me u-zhdukë në të gjithë Shqipërinë.
7. A ngrijnë edhe liqëjt?
Jo, nuk bën aq të ftohtë sa me ngrin liqëjt.
8. Çka bëjnë banorët e atyne vendeve gjatë kohës që bën të ftohtë?
Asgjë, rrijnë në shtëpit e tyre pranë zjarrit ase merren me gjueti.
9. Kur fillon me rë borë n'ato vende?
Zakonisht në tetuer; në kallnuer e fruer bora merrin deri në dy metra dhe pothuajse të gjitha rrugët janë të mbylluna.
10. Si bëjnë me blë ushqime dhe ku i kullosin kafshët?
Njerzit i kanë blë ushqimet me kohë; kafshët mbahen në grazhd.

REVIEW OF PASSIVE VOICE (VERBS)

Passive verbs were discussed at length in Lesson 43, Volume IV. Today we will have a brief review of passive verbs and an explanation of how to form passive and reflexive verbs (which have the same endings in Albanian) from active verbs.

Review: The passive voice is the verb form in which the subject does not act, but is acted upon. When the reflexive verb is used, the action is carried out by the subject and is reflected on it. In other words, the subject and object refer to the same person.

Explanation: An active verb usually has to be transitive in order to become either passive or reflexive. A transitive verb expresses an action upon a direct object. Here is how it is formed: Take the present tense indicative, second person plural of any verb and remove the ending -ni; what is left is the verb root or stem. Add to this stem the passive present tense verb endings you have already learned. These are: hem, he(sh), het, hemi, heni, hen for verbs whose stems end with vowels or diphthongs; and em, e(sh), et, emi, eni, en for verbs whose stems end in consonants.

Examples:

Verb with a vowel stem ending:

me zgjue
(to wake up some-
body else)

unë zgjoj
ti zgjon
ai, ajo zgjon
na zgjojmë
ju zgjoni
ata, ato zgjojnë

me u-zgjue
(to wake up)

unë zgjohem
ti zgjohe(sh)
ai, ajo zgjohet
na zgjohemi
ju zgjoheni
ata, ato zgjohen

Verb with a consonant stem ending:

me nisë
(to send, dispatch;
to start)

me u-nisë
(to leave, depart)

unë nis
ti nis
ai, ajo nis
na nisim
ju nisni
ata, ato nisin

unë nistem
ti nise(sh)
ai, ajo niset
na nisemi
ju niseni
ata, ato nisen

This rule applies not only to the present tense, but to many other tenses of passive and reflexive verbs. All you have to do is attach their endings, which you already know, to the stems!



Në dimën ditët zvoglohen e netët zmadhohen. Dielli lén vonë, e mbaron udhëtimin e vet shpejt e prendon heret. Malevet e pyjevet, fushavet e aravet u humb stolija e gjallëniya; ajo rrobe e bukur që u ka falë natyra zhduket.

Qielli është i mbuluem me ré dhe prandej i vrânët. Dielli nuk është i ngrohtë dhe era, mjaft e ftohtë, frÿn pa i a dá; bryma është e trashë, uji nëpër vija është shumë i ftohtë e aty-këtu shifet akull mbi të.

Kafshët e shtëpís mbahen në grazhdet e ngrohta. Anijet qëndrojnë në limã e nuk lundrojnë veç në rasa tepër të nevojshme. Tÿmtarët, si të qytetevet ashtu edhe të katundevet, qesin tym pa prã. Njerzit duken rrallë në rrugë. Të gjithë të veshun me rrobe të trasha, vrapojnë që të mrrijnë në shtëpit e tyre që të ngrohen pranë zjarrit. Vetëm të vobektit, pa bukë e pa zjarr, të veshun me zhele, dridhen prej të ftohtit e prej urís. Nuk durohen të këqijat e dimnit! Veriu frÿn i ftohtë e ngrin gjithçka gjindet mbi dhé. Edhe deti e tregon ashpërsin e vet me valët e egra plot shkumbë të bardhë.

Bishët e pyjevet habiten, dridhen, e me bisht ndër shalë, ngasin andej e këndej për t'i ikë të ftohtit, për t'u-futë në ndonji shpellë e për t'u-mbrojtë nga furija e dimnit.

Përrjashta bje bora fjolla-fjolla dhe e mbulon sipërfaqen e dheut. Kur pushon së rami, çunat e gocat, e nganjihërë edhe të mëdhajt, rrihen me topa bore. Mbi liqë të ngrim shihen njerëz tue rrëshqitë mbi akull. Edhe dimni e ka bukurin e vet!

QUESTIONS-PYETJE

A zvoglohen ditët e zmadhohen netët në dimën? Kur zvoglohen ditët e zmadhohen netët? A lén dielli vonë? A e mbaron udhëtimin e tij shpejt e prendon heret? Cili e mbaron udhëtimin e tij shpejt e prendon heret? Kur prendon dielli në dimën? A u humb stolija e gjallëniya malevet e pyjevet, fushavet e aravet? Çka u humb malevet e pyjevet, fushavet e aravet? A zhduket ajo rrobe e bukur që u ka falë natyra? Cila rrobe zhduket? A është qielli i mbuluem me ré dhe prandej i vrânët? Çka është i mbuluem me ré dhe prandej i vrânët? A është dielli i ngrohtë në dimën? Si është dielli në dimën? A është era mjaft e ftohtë? A frÿn pa i a dá? Kur është era mjaft e ftohtë dhe frÿn pa i a dá? Qysh frÿn era në dimën? A është bryma e trashë? Kur është bryma e trashë? A është uji shumë i ftohtë nëpër vija e aty-këtu shifet akull mbi të? Çka është shumë i ftohtë? Kur është uji nëpër vija shumë i ftohtë e aty-këtu shifet akull mbi të? A mbahen në grazhdet e ngrohta kafshët e shtëpís? Në çfarë grazhdesh mbahen kafshët e shtëpís? Kur mbahen kafshët e shtëpís ndër grazhdet e ngrohta? A qëndrojnë anijet në limã e nuk lundrojnë veç në rasa tepër të nevojshme? Çka bëjnë anijet në limã e nuk lundrojnë veç në rasa tepër të nevojshme? Ku qëndrojnë anijet e nuk lundrojnë veç në rasa tepër të nevojshme? Tyntarët, si të qytetevet ashtu edhe të katundevet, a qesin tym pa prã? Kur nxjerrin tym tyntarët e qytetevet ashtu edhe të katundevet? A duken njerzit rrallë në rrugë? Ku duken njerzit rrallë? Pse duken njerzit rrallë në rrugë? Të gjithë

të veshun me rrobe të trasha, a vrapojnë që të mrrijnë në shtëpít e tyne? Çka bëjnë të gjithë për të mrrijtë në shtëpít e tyne? A ngasin të gjithë që të mrrijnë në shtëpít e tyne, që të ngrohen pranë zjarrit? Pse vrapojnë njerzit tue shkue në shtëpít e tyne? Të vobektit, pa bukë e pa zjarr e të veshun me zhele, a dridhen prej të ftohtit e prej urís? Kush dridhet prej të ftohtit e prej urís? Pse dridhen të vobektit? A durohen të këqijat e dimnit? Çfarë të këqijash nuk durohen? A frÿn i ftohtë veriu e ngrín gjithçka? Çka frÿn i ftohtë e ngrín gjithçka gjindet mbi dhé? Qysh frÿn veriu e ngrín gjithçka gjindet mbi dhé? A e tregon ashpërsín e tij edhe deti me valët e egra plot shkumbë të bardhë? Qysh e tregon deti ashpërsín e tij? A habiten e dridhen bishët e pyjevet? A vrapojnë andej e këndej me bisht ndër shalë për t'i ikë të ftohtit? Çka bëjnë bishët e pyjevet? Pse vrapojnë andej e këndej me bisht ndër shalë? A ngasin për t'i ikë të ftohtit e për t'u futë në ndonji shpellë për t'u-mbrojtë nga furija e dimnit? Pse vrapojnë bishët e pyjevet? Përrjashta, a bje bora fjolla-fjolla dhe e mbulon sipërfaqen e dheut? Ku bje bora fjolla-fjolla? Çka mbulon bora që bje përrjashta fjolla-fjolla? Çka ngjån përrjashta? Kur bora pushon së rami, a rrihen me topa bore çunat a gocat e nganjherë edhe të mëdhajt? Kur rrihen me topa bore çunat e gocat e nganjherë edhe të mëdhajt? Cilët rrihen me topa bore kur pushon bora së rami? Përveç çunavet dhe gocavet, edhe kush tjetër rrihet me topa bore nganjherë? Çka bëjnë çunat e gocat e nganjherë edhe të mëdhajt, kur

pushon bora së rami? Mbi liqë të ngrîm, a shihen njerëz tue rrëshqitë mbi akull? Kush shihet mbi liqë të ngrîm tue rrëshqitë mbi akull? Çka shihen njerzit tue bâ mbi liqë të ngrîm? Ku shihen njerëz tue rrëshqitë mbi akull? Mbi cilin liqë shihen tue rrëshqitë njerëz mbi akull? Çka bâjnë njerzit mbi akullin e liqenit të ngrîm? A e ka edhe dimni bukurín e vet? Cila stinë, megjithëqë e ftohtë dhe plot borë e akull e ka bukurín e vet?

Në ç'orë lén dielli në dhetuer? Ku lén dielli mâ heret, në Kaliforní, apo në Nju Jork? A e dini sa fëmijë lejnë në ditë në Shtetet e Bashkueme t'Amerikës? Kur âsht qielli me shumë ré, a thuhet se âsht i vrânët? Po një fytyrë që nuk qesh kurrë, a thuhet se âsht e vrânët? Kur frÿn shumë erë, a rrijnë anijet në limâ? Zakonisht, a frÿn burija për t'i zgjue ushtarët? Dimni i ftohtë, por i thatë, a âsht i shëndoshë? A âsht e shëndoshë klima e Monterejt? A keni udhëtue ndonjiherë me anije? A bje brymë në kët qytet gjatë dimnit? Ku bje brymë shpesh gjatë dimnit? Si quhet çuni i Zotní Lubonjës? Po goca e Zojës Daka, si quhet? A âsht luani një kafshë e egër? A âsht e mbyllun syza? Si quhet uji i ngrîm? A veshim rrobe të holla në verë? Çfarë rrobesh veshim në dimën? A ka kali i tij shalë? A ju pëlqen birra me shkumbë apo pa shkumbë? A keni hÿ ndonjiherë në ndonji shpellë? A âsht i veshun Zotní Miloti me rrobe vere? Me çfarë rrobesh âsht i veshun ai? A âsht i vobekët Zotní Ohri? Kush nuk âsht i vorfën? A âsht

zmadhuesh shkollat jone këto kohët e fundit? Cila shkollë është
zmadhuesh këto kohët e fundit? A është zvogëluar departamenti i
shqipësisë? Cili departament është zvogëluar?



Qëndrueshmëria gjatë dimrit është traditë shqiptare.

Translate the following sentences into Albanian:

1. The Durrësi Harbor was damaged during the war.
2. In Korçë it gets cold, but it's a dry cold which I like very much.
3. Look here! This water is frozen!
4. I was surprised that he could come in such a short time.
5. Are hotels expensive in Albania?
6. What ancient civilization is famous in world history?
7. The largest lake in Albania is Lake Shkodra.
8. Thousands of years ago men lived in caves.
9. He slipped and broke his leg.
10. What is the area of this field?

PJESA E PESTË
FJALORI

LESSON 81
PART V
VOCABULARY

akull, -i akuj, -t	(m.)	ice
anije, anija anije, -t	(f.)	ship
i, e, t'ashpër t'ashpra	(adj. m.&f.)	rough, severe, harsh
ashpërsí, -ja	(f.)	roughness, severity, harshness
bishë, -a bishë, -t	(f.)	beast
brymë, -a	(f.)	frost
burí, -ja burí, -t	(f.)	bugle, trumpet
çun, -i çuna, -t	(m.)	boy (up to 14 years old)
me u-durue (unë durohem)	(v.)	to be endured, tolerated
fjollë, -a fjolla, -t	(f.)	flake
fort	(adv.)	very, very much
gocë, -a goca, -t	(f.)	girl
grazhd, -i grazhde, -t	(m.)	stable, manger
gjallëní, -ja	(f.)	liveliness, energy
gjuetí, -ja	(f.)	hunting, hunt
me u-habitë (unë habitem)	(v.)	to be surprised, amazed; to be confused, distracted
kënaqësí, -ja	(f.)	satisfaction, pleasure
me kullotë (unë kullos)	(v.)	to graze

limã, -ni limane, -t	(m.)	port, harbor
luan, -i luaaj, -t	(m.)	lion
me lundrue (unë lundroj)	(v.)	to sail, navigate
i madh, -i të mëdhaj, -t	(m.)	adult; the oldest (of the children); the large one, the big one, the great one
i, e, të mbyllun të mbylluna	(adj. m. & f.)	closed, shut
natyrë, -a	(f.)	nature
me ngrî (unë ngrîj)	(v.)	to freeze; to be cold
i ngrim, të ngrimë e, të ngrime	(adj. m. & f.)	frozen
me u-ngrohë (unë ngrohem)	(v.)	to warm oneself
me u-rrahë (unë rrihem)	(v.)	to fight (not in a war); to be beaten, thrashed, spanked
me rrëshqitë (unë rrëshqas)	(v.)	to skate, slide, slip, glide
sipërfaqe, sipërfaqja sipërfaqe, -t	(f.)	surface, area
stolî, -ja stolî, -t	(f.)	decoration, ornament, adornment
shalë, -a shalë, -t	(f.)	the inner part of the upper leg
shalë, -a shala, -t	(f.)	saddle
shkumbë, -a	(f.)	foam, froth, lather, suds
tymtár, -i tymtarë, -t	(f.)	chimney, smokestack

i, e, të veshun të veshuna	(adj. m.&f.)	dressed
i, e, të vobektë të vobekta	(adj. m.&f.)	poor (not rich)
i, e, të vrânët të vrânta	(adj. m.&f.)	overcast, cloudy; gloomy
me vrapue (unë vrapoj)	(v.)	to run
me zgjue (unë zgjoj)	(v.)	to awaken, to wake up
zjarr, -i zjarre, -t	(m.)	fire
me u-zmadhue (unë zmadhohem)	(v.)	to be enlarged; to get bigger
me u-zvoglu (unë zvoglohem)	(v.)	to become smaller; to decrease, dwindle
zhele, zhelja zhele, -t	(f.)	rag

Shënime:

andej e këndej	here and there
aty-këtu	here and there; at random
këto kohët e fundit	recently
pa i a dá	continuously
pa prâ	continuously; incessantly

Pranvera

1. Qysh është pranvera në Shqipëri?
Pranvera në Shqipëri është shumë e bukur. Bora zhduket prej faqes së dheut e vetëm nëpër majat e malevet të nalta duket aty-këtu pak borë.
2. Po era, a fryn e ftohtë?
Jo, sepse era e ftohtë pran dhe ulurima e drëjvet të lëkundun prej forcës së saj pushon.
3. A ngrihni akull në Shqipëri?
Po, por kur vjen pranvera, ujnat e lumejvet dhe të vijavet pastrohen prej akujvet dhe rrjedhin lirisht, tue shkëlqye si pasqyra prej rrezet të diellit.
4. Si duket, i gjithë vendi bleron me rrobën e blertë të natyrës!
Po, është e vërtetë. Vendi e heshtjes që mbretnon gjatë dimnit anë e mb'anë, e zë lëvizja dhe gjallëria.
5. A keni zogj shtegtarë në Shqipëri?
Po, kemi. Dallëndyshat e zogjt tjerë që largohen në vjeshtë këthehen përsëri dhe e mbushin ajrin me ato zane të bukura e këngë të mallëngjeshme.
6. A bje vesë në mëngjes?
Po; vesa e mëngjesit shkëlqen si xhevahër mbi barin e njomë, mbi lulet e gonxhet e tyne. Mëngjesi është shumë i bukur dhe i freskët. Gjithë natyra shëndrit prej bukurisë.
7. Po prendimi, a është i bukur?
Po, prendimi është i mrekullueshëm! Rét kuqen e marrin gjithfarë ngjyrash të bukura. Hëna, me at shkëlqim t'argjendte e lëshon dritën e saj mbi male, mbi fusha e mbi banimet e njerëzvet. Miliona hyjsh xixëllojnë në hapsinë.

8. A shifen bishë t'egra ndër pyje?
Po, bishët e egra dalin prej shpellavet e strofujvet ku kalojnë dimnin. Dhelpna e ujku fillojnë grabitjen e vjedhjen, tue rá pré ndër pula e tufa dhensh.
9. Po gjera, a keni?
Po, kemi. Gjerat shifen tue u hypë e tue u zdrypë pemëvet me një shkathtësi të pashoqe.
10. Ku i kullosin delet?
Delet i kullosin nëpër livadhe të blerta. Asht një bukurí e papërshkrueshme me i pá qingjat që u turren nánavevet për të thithë qumësht prej gjivet të tyne.
11. Po sorra, korba e laraska, a keni?
Këta zogj shifen mbi shpinë të delevet tue shkulë lesh me sqep për ndërtimin e çerdhevet të tyne.
12. Të gjithë frymorët e ndiejnë gjallënin e pranverës, por unë besoj se fëmijët e ndiejnë më fort se të gjithë.
Po, edhe kjo është e vërtetë. Djelmt e gocat i zbukurojnë rrobat me lule dhe vënë mbi krye kunora lule shqerre. Bletët shifen tue fluturue lule më lule, tue mbledhë landën e duhun, prej së cilës bëjnë mjaltin e dyllin.

ANTONYMS

In Lesson 67 (Volume VII), we dealt with some Albanian verbal prefixes like c-, sh-, and zh- that change some verbs into their opposites or negatives, creating antonyms.

Examples:

Mbasi jeni lodhë, çlodhuni!
(Since you are tired, take a break/relax!)

Kur bijmë me fjetë xhvishemi e mbasi dalim nga shtrati vishemi.
(We undress when we go to bed and get dressed after we get out of bed.)

There are other types of antonyms formed with nouns, adjectives, adverbs and prepositions.

Examples:

Emni idhnim është antonimi i emnit gëzim.
(The noun "grief" is the antonym of the noun "happiness.")

Ajo ishte e bukur nga trupi, por e shëmtuet nga fytyra.
(She had a beautiful figure, but an ugly face.)

Agimi ishte keq dje, por sot është pak më mirë.
(Agim was in bad shape yesterday, but he is a little bit better today.)

Unë jetoj këndej lumit, kurse ai jeton matanë lumit.
(I live on this side of the river, whereas he lives on the other side of the river.)

Bora u-zhduk prej faqes së dheut; vetëm nëpër majat e malevet të nalta duket, aty-këtu, pak borë. Era e ftohtë prâni dhe ulurima e drûjvet të lëkundun prej forcës së saj pushoi. Ujnat e lumejvet e të vijavet u-pastruen prej akujvet e rrjedhin lirisht, tue shkëlqye si pasqyra prej rrezevet të diellit.

Gjithë vendi bleron me rrobën e blertë të natyrës!

Vendin e heshtjes, që mbretonte gjatë dimnit anë e mb'anë, e zûni lëvizja e përgjithshme dhe gjallënija. Dallëndyshat e zogjt tjerë, që u-larguen në dimën, u-këthyen përsëri dhe e mbushin ajrin me ato zane të bukura e këngë të mallëngjyeshme. Gjithë natyra shëndrit prej bukuris. Mëngjesi është shumë i bukur dhe i freskët. Vesa e mëngjesit shkëlqen si xhevahir mbi barin e njomë, mbi lulet e mbi gonxhet e tyne. Nga të gjitha anët ndigjojmë këngët e zogjvet. N'orën e prendimit rêt kuqen e marrin gjithfarë ngjyrash të bukura. Hâna, me at shkëlqim t'argjendtë, e lëshon dritën e saj mbi male, mbi fusha e mbi banimet e njerëzvet. Miliona hyjsh xixëllojnë në hapsinë. Bishët e egra dalin prej shpellavet e strofujvet, ku e kishin kalue dimnin. Dhelpna e ujku fillojnë grabitjen e vjedhjen, tue rá pré ndër pula e tufa dhensh. Gjери shifet tue u hypë e tue u zdrypë pemëvet me një shkathtësi të pashoqe.

Delet kullosin nëpër livadhet e blerta. Qingjat këcejnë andej e këndej dhe u turren nânavet me thithë qumësht prej

gjivet të tyne. Ndonji sorrë, korb a grizhël (laraskë) shifet mbi shpinën e delevet, ende të paqethuna, tue shkulë lesh me sqep për ndërtimin e çerdhevet të tyne. Djelmt e gocat i zbukurojnë rrobat me lule dhe vënë mbi krye kunora lule shqerre.

Të gjithë frymorët e ndiejnë gjallënin e pranverës. Bletët fluturojnë lule më lule, tue mbledhë landën e duhun, prej së cilës bājnë mjaltin e dyllin.

QUESTIONS - PYETJE

A u-zhduk bora prej faqes së dheut? Prej nga u-zhduk bora? Çka u-zhduk prej faqes së dheut? A duket aty-këtu pak borë vetëm nëpër maqat e malevet të nalta? Ku duket aty-këtu pak borë? Nëpër cilat male duket aty-këtu pak borë? A prāni era e ftohtë? Çka prāni? Cila erë prāni? A pushoi ulurima e drūjvet të lëkundun prej forcës s'erës? Ulurima e cilës pushoi? A u-pastruen prej akujvet dhe tash rrjedhin lirisht ujnāt e lumejvet e të vijavet? Çka u-pastrue prej akujvet? Cilët ujna u-pastruen prej akujvet? Qysh rrjedhin ujnāt e lumejvet e të vijavet që u-pastruen prej akujvet? A shkëlqejnë si pasqyra prej rrezetvet të diellit? Çka shkëlqen si pasqyrë prej rrezetvet të diellit? Prej se shkëlqejnë ujnāt e lumejvet e të vijavet si pasqyra? Pse shkëlqejnë ujnāt e lumejvet e të vijavet si pasqyra? A bleron gjithë vendi me rrobën e ré të natyrës? Çka bleron me rrobën e ré të natyrës? A e zūni lëvizja e përgjithshme dhe gjallënija vendin e

heshtjes? Çka e zûni vendin e heshtjes? Cila lëvizje e zûni vendin e heshtjes? Vendin e cilës e zûni lëvizja e përgjithshme dhe gjallënia? A e zûni lëvizja e përgjithshme dhe gjallënia vendin e heshtjes që mbretnonte gjatë dimnit anë e mb'anë? A u-këthyen përsëri dallëndyshat e zogjt tjerë? Çka bënë dallëndyshat e zogjt tjerë? A ishin largue në dimën dallëndyshat e zogjt tjerë dhe u-këthyen përsëri në pranverë? Kur ishin largue dallëndyshat e zogjt tjerë që u-këthyen përsëri në pranverë? A e mbushin ajrin me ato zane të bukura e me këngë të mallëngjyeshme? Cilët e mbushin ajrin me zane të bukura e me këngë të mallëngjyeshme? A shëndrit gjithë natyra prej bukuris? Prej se shëndrit gjithë natyra? A është shumë i bukur dhe i freskët mëngjesi? Çka është shumë i bukur dhe i freskët? Si është mëngjesi në pranverë? A shkëlqen si argjend vesa e mëngjesit mbi barin e njomë, mbi lulet e mbi gonxhet e tyne? Mbi çfarë bari shkëlqen si argjend vesa e mëngjesit? Mbi çka tjetër shkëlqen si argjend vesa e mëngjesit? Nga të gjitha anët, a ndigjojmë këngët e zogjvet? A kuqen rët n'orën e prendimit? Cilat kuqen n'orën e prendimit? Në ç'kohë kuqen rët? A marrin rët prej diellit gjithfarë ngjyrash të bukura? Cilat marrin prej diellit gjithfarë ngjyrash të bukura? Kur marrin rët prej diellit gjithfarë ngjyrash të bukura? A e lëshon dritën e ëmbël mbi male, mbi fusha e mbi banimet e njerëzvet hâna me at shkëlqim t'argjendte? Çka lëshon hâna mbi male, mbi fusha e mbi banimet e njerëzvet? Çfarë drite lëshon hâna me at shkëlqim t'argjendte mbi male, mbi fusha e mbi banimet e njerëzvet? A xixëllojnë në hapsinë miliona hyjsh? Sa hyj xixëllojnë në

hapsinë? A dalin bishët e egra prej shpellavet e strofujvet?
 Prej nga dalin bishët e egra? Kur dalin bishët e egra prej
 shpellavet e strofujvet ku kishin kalue dimnin? Çka kishin
 kalue bishët e egra në shpella e në strofuj, prej të cilëve
 dalin në pranverë? A fillojnë grabitjen e vjedhjen dhelpna
 e ujku? Cilët e fillojnë grabitjen e vjedhjen tue rá pré
 ndër pula e tufa dhensh? Ku bijnë pré dhelpna e ujku? A shifet
 gjeri tue u hypë e tue u zdrypë pemëvet me një shkathtësi të
 pashoqe? Çka bân gjeri me një shkathtësi të pashoqe? Cilave
 u hypën dhe u zdryp gjeri me një shkathtësi të pashoqe? Me
 çfarë shkathtësije u hypën dhe u zdryp gjeri pemëvet? A kullo-
 sin delet nëpër livadhet e blerta? Ku kullosin delet? Në çfa-
 rë livadhesh kullosin delet? A këcejnë qingjat andej e këndej?
 Ku këcejnë qingjat? A u turren nânavet me thithë qumësht prej
 gjivet të tyne? Cilave u turren qingjat? Pse u turren qingjat
 nânavet të tyne? A shifet ndonji sorrë, korb a grizhël mbi
 shpinën e delevet ende të paqethuna tue shkulë lesh me sqep?
 Ku shifen, tue shkulë lesh me sqep, sorra, korbi e laraska? Në
 shpinën e cilave shifet, tue shkulë lesh me sqep, ndonji sorrë,
 korb ase grizhël? Me çka shkul lesh ndonji sorrë, korb a gri-
 zhël mbi shpinën e delevet ende të paqethuna? A u duhet leshi
 për ndërtimin e çerdhevet të tyne? Cilave u duhet leshi për
 ndërtimin e çerdhevet të tyne? A i zbukurojnë rrobat me lule
 djelmt e gocat? Kush i zbukuron rrobat me lule? A vënë mbi
 krye kunora lule shqerre? Cilët vënë mbi krye kunora lule
 shqerre? Çka vënë mbi krye djelmt e gocat? A e ndiejnë gjallë-
 nín e pranverës të gjithë frymorët? Kush e ndien gjallënin e

pranverës? Çka ndiejnë të gjithë frymorët? A fluturojnë bletët lule më lule? Cila fluturon lule më lule tue mbledhë landën e duhun, prej së cilës bân mjaltin e dyllin? Çka mbledhin bletët lule më lule? Çka bâjnë bletët me landën që mbledhin lule më lule?

A ka fytyra e njeriut dy faqe? Sa faqe ka fytyra e njeriut? A ka ky libër...faqe? Sa faqe ka ky libër? A është e vërtetë se shumë kafshë, që kanë ekzistue shumë shekuj mâ parë, janë zhdukë sot prej faqes së dheut? Prej nga janë zhdukë shumë kafshë që kanë ekzistue shumë shekuj mâ parë? Kur pushon era, a pushon edhe ulurima e drûjvet? A pushon era, bora dhe shiu në pranverë? A ka shumë njerëz që nuk pushojnë kurrë së foluni? Kur jeni i lodhun, a uleni me pushue? Sa orë pushoni para se të filloni me studjue? Nji tufë dhensh, a d.m.th. disa dhen së bashku? Disa lule së bashku, a formojnë nji tufë lule? Kur ju është prishë shumë nji dhâmb, a e shkulni? A duhen shkulë gozhdat që janë në mûr e që nuk lypsen? A është i pastër ajri ndër male? Qysh është ajri ndër male? Çka na apin bletët? A ka shumë anije në gjiun e Monterejt? Sa anije ka në gjiun e Monterejt? A keni blé dje katër metra stofë leshi? Sa metra stofë leshi do të bleni nesër? A kanë të gjithë zogjt sqep? Cilët kanë sqep? Ku ka mâ shumë lëvizje, në San Fransisko, apo në Nju Jork? Sa hyj ka flamuri i Shtetevet të Bashkueme t'Amrikës? A është qeni nji frymuer? Çka janë qeni, maca, kali, lopa, delja etj? A është gjeri nji kafshë? Çka është gjeri?

Translate the following sentences into Albanian:

1. The swallows leave in autumn and come back in spring.
2. The wolf is a dangerous animal for sheep.
3. He is in prison for theft and robbery.
4. The Americans have gone to the moon several times.
5. The crow and the raven are birds that damage crops.
6. I bought a cotton shirt, a woolen coat, and two pairs of silk socks.
7. I broke my mirror; they say it's bad luck (a bad sign).
8. The Albanian flag is red with a black double-headed eagle in the middle.
9. You can't undo what you did; therefore, don't worry.
10. It's not a bad job; on the contrary, I should say it's a good one (job).

i, e, t'argjendtë t'argjendta	(adj. m.&f.)	of silver, silvery
banim, -i banime, -t	(m.)	residence, dwelling
bár, -i barëna, -t	(m.)	grass, herb; medicine
me blerue (bleron)	(v.)	to turn green
bletë, -a bletë, -t	(f.)	bee
dallëndyshë, -a dallëndysha, -t	(f.)	swallow (bird)
dele, delja dele, -t	(f.)	sheep, ewe
i, e duhun	(adj. m.&f.)	necessary; appropriate
dyllë, -i	(m.)	wax
faqe, faqja faqe, -t	(f.)	face (surface); cheek; page
flamur, -i flamuj, -t flamurë, -t	(m.)	flag, standard
me fluturue (unë fluturoj)	(v.)	to fly
frymuer, frymori frymorë, -t	(m.)	being (human and animal)
gonxhe, gonxhja gonxhe, -t	(f.)	bud (flower)
grizhël, grizhla grizhla, -t	(f.)	magpie
gjer, -i gjera, -t	(m.)	squirrel
hënë, -a	(f.)	moon

hapsinë, -a	(f.)	open space, space
heshtje, -a	(f.)	silence
hýll, -i hyj, -t	(m.)	star
korb, -i korba, -t	(m.)	raven
kunorë, -a kunora, -t	(f.)	crown, wreath, coronet, garland
me u-kuqë (unë kuqem)	(v.)	to turn red; to blush; to be roasted
laraskë, -a laraska, -t	(f.)	magpie
i, e, të lëkundun të lëkunduna	(adj. m.&f.)	shaken
lirisht	(adv.)	freely
livadh, -i livadhe, -t	(m.)	meadow
lule shqerre	(f.)	daisy
me u-lypsë (unë lypsem)	(v.)	to be needed, to be necessary
i, të mallëngjyeshëm e, të mallëngjyeshme	(adj. m.&f.)	touching, moving, sentimental
me mbretnue (unë mbretnoj)	(v.)	to reign
i, të papërshkrueshëm e, të papërshkrueshme	(adj. m.&f.)	indescribable
i, e, të paqethun të paqethuna	(adj. m.&f.)	unshorn; in need of a haircut
i, të pashoq e, të pashoqe	(adj. m.&f.)	unequaled, unparalleled, peerless
me prâ (unë prâj)	(v.)	to stop, cease
sorrë, -a sorra, -t	(f.)	crow

sqep, -i sqepa, -t	(m.)	beak, bill
stofë, -a stofëna, -t	(f.)	material (fabric)
strofull, -i strofuj, -t	(m.)	lair
shkathtësi, -ja shkathtësi, -t	(f.)	agility
shkëlqim, -i	(m.)	brilliance, brightness
me shkëlqye (unë shkëlqej)	(v.)	to shine, brighten
me shkullë (unë shkull)	(v.)	to pluck; to pull out, uproot
shtegtár, -e shtegtarë	(adj. m.&f.)	migratory
tufë, -a tufa, -t	(f.)	herd, flock; bouquet, bunch
me u-turrë (unë turrem)	(v.)	to rush, dash, attack
ujk, -u ujq, -it	(m.)	wolf
ulurimë, -a ulurima, -t	(f.)	howl
vesë, -a	(f.)	dew
me xixëllue (xixëllon)	(v.)	to sparkle, spark
me zbukurue (unë zbukuroj)	(v.)	to beautify, adorn, enhance, embellish
me zdrypë (unë zdryp)	(v.)	to descend, climb down, dismount, come down

Shënime:

anë e mb'anë

throughout

me rá pré

to plunder, raid, sack


Unaza

1. Bij të dashun, tre muej
mâ parë ju pata thënë se
unazën e kushtueshme do
t'a fitonte, ndër jû të
tre, ai që do të bënte
nji burrëni të madhe.
Po, ashtu është, babë! Tash
që u-këthvem kemi me t'i
tregue, fill e për për, peri-
petit tona e punët e mira
që kemi krye.
2. Besoj se tre muej kanë
qenë të mjaftueshëm me
vû në dukje virtytet
tueja. Fillo ti, Lekë,
që je mâ i madhi!
Nji ditë u-takova me nji
bujar; ky do të çonte në
nji vend të largët nji kar-
van kuajsh të ngarkuem me
mall.
3. Paska qenë shumë i pasun!
Po, ashtu m'u-duk edhe mue.
Më la që t'i ruejshem nji
arkë plot me dupje, vathë
të kushtueshëm e margaritarë
të panumërt.
4. A të kërkoi diftesë?
Jo! Fare lehtë do të kishem
mundë me e përvetue at arkë,
por i a dorëzova të zotit
ashtu si m'a kishte lânë.
A nuk është kjo nji burrëni
e madhe, babë?
5. Po bër, ke nderue veten,
por s'ke bër asgjâ mâ
tepër se ç'duhet të bëjë
çdo njeri i ndershëm.
Po ti, Skënder?
Unë, babë, ishem tue ecë
bregut të nji lumi të thellë
e të rrëmbyeshëm; rá mbrendë
nji fëmijë e gati qe tue e
përpí rryma...
6. E marr me mend, bër, ti
pa ngurrue u-zhyte n'ujë.
Po, babë, u-hodha n'ujë pa
marrë parasÿsh aspak rrezikun
e madh për jetën time.
Vetmohimi im është i rrallë,
babë!
7. Jo, nuk është i rrallë!
Edhe ti ke bër detyrën
tande e asgjâ mâ tepër.
Po ti, Genc, ç'ke për të
tregue?
Ishin mâ se katër orë që po
i ngjiteshem nji shpati të
Malit të Thatë plot me
shkrepa.

8. E dij edhe unë çfarë mali
 është ai; përveç shkrepavet
 ka edhe shumë gremina.
9. Si veprore mandej?
10. Kush ishte?
11. A mos e shtëne, vallë?
12. Të lumtë, bër! Kjo është
 burrëni! Qe unazën se
 e ke fitue!
- Tamam në buzë të një greminë
 pashë një njeri që e kishte
 marrë gjumi; të kishte
 lëvizë pak gjë, do të kishte
 rënë poshtë i vdekun.
- I u-afrova dhe e njofta kush
 ishte.
- Anmiku im, ai që s'donte të
 më shifte gjallë.
- Jo, babë! Përkundrazi, që
 të mos trembesh e zgjova
 lehtë e lehtë dhe e largova
 nga ai rrezik.



Zbukurime ilire (shekulli VI-II p.e.sonë) Mat.



Objekte zbukurimi ilire.

THE PRESENT AND PAST (PERFECT) CONDITIONAL

We have explained the conditional mode in Lessons 50 and 52, Vol. V. Today we are going to review it in order to refresh our memories.

The conditional has only two tenses: the present and the past (perfect). The present tense is formed using the particle do of the future plus the imperfect subjunctive tense: të shkojshem, të niseshem.

Examples (for the present tense conditional):

Do të shkojshem po të kishem të holla.
(I would go if I had money.)

Do të niseshem sot po ta kishem pasaportën në xhep.
(I would leave today if I had the passport in my pocket.)

The past conditional is formed also using the particle do plus the pluperfect subjunctive: të kishem shkue, t'ishem nisë.

Examples (for the past or perfect tense conditional):

Do të kishem shkue po të kishem pasë leje.
(I would have gone if I had had leave.)

Do t'ishem nisë po të mos kishem genë i sëmunë.
(I would have left if I hadn't been sick.)

The examples above represent most of the Albanian verbs: active and passive voices.

Nji babë u a dau pasunin të tre djelmvet të vet. I kishte mbetë edhe një unazë e kushtueshme. U tha djelmvet se unazën do t'a fitonte ai që do të bënte një burrinë të madhe.

Djelmt u-shpërdanë gjithandej dhe erdhën prap mbas tre muejsh.

I pari tregoi se një zotni i kishte lënë një arkë plot me pare të verdha që t'i a ruente pa i lypë diftesë. Tha se do të kishte mundë me i përvetue, por nuk e kishte shpërdorue besimin e atij zotnije; tha se kur erdhi i a kishte këthye arkën si i a kishte lënë, pa prekë kurrgjâ.

I ati i tha se punë të mirë kishte bërë, por asgjâ më tepër se çka i ishte dashë të bënte.

I dyti tha se kishte shkue një ditë bregut të një lumi dhe kishte pë tue rënë mbrendë një fëmijë të vogël. Po mos t'i a kishte ngjitur dorën, fëmija do t'ishte mbytur mbrendë; prandej ishte zhytur në ujë, e kishte kapë për krahu dhe e kishte shpëtue.

Edhe këtij i tha i ati se punë të mirë kishte bërë, por asgjâ më tepër se çka duhet të bëjmë të gjithë, dhe shtoi se secili e ka për detyrë me i ndihmue shoqit (shokut) kur është në rrezik.

I treti tregoi se një ditë, kur po shetite, kishte pë prej së largu një njeri, i cili s'donte t'a shifte gjallë. Atë e kishte marrë gjumi në buzë të një mali, e pak gjâ po të kishte lëvizë, do të kishte rënë poshtë i vdekun; tha se e kishte zgjue ngadalë-ngadalë dhe se e kishte largue nga ai rrezik.

I ati e mori ngrykë dhe e puthi tue i thënë:

"Të lumtë, ti e ke fitue unazën!"

QUESTIONS - PYETJE

Kush u a kishte dá pusunín të tre djelmvet të vet? Çka u kishte dá një babë të tre djelmvet të vet? Kujt i a kishte dá një babë pasunín e vet? Kujt i kishte mbetë edhe një unazë e kushtueshme? Çfarë unaze i kishte mbetë? Kush u tha djelmvet se unazën do t'a fitonte ai që do të bante një burrëni të madhe? Çka do të bante ai që do t'a fitonte unazën? Çfarë burrënie do të bante ai që do t'a fitonte unazën? A u-shpërdanë djelmt gjithandej? Çka bënë djelmt? A erdhën prap mbas tre muejsh? Kur erdhën prap djelmt? Kush tregoi se një zotní i kishte lënë një arkë plot me pare të verdha që t'i a ruente pa i lypë diftesë? Çka i kishte lënë një zotní? Pse i a kishte lënë një zotní arkën plot me pare të verdha? A i kishte lypë diftesë? A kishte pasë besim në të dhe prandej nuk i kishte lypë diftesë? A tha se kishte mundë me i përvetue ato pare, por nuk e kishte shpërdorue besimin e atij zotnije? Çka kishte mundë me përvetue? Pse nuk e kishte bënë at gjá? A tha se kur erdhi i a kishte këthye arkën si i a kishte lënë pa prekë asgjá? Në ç'gjendje i a kishte këthye arkën? A i tha i ati se punë të mirë kishte bënë, por kurrëgjá më tepër se çka i ishte dashë të bante? Çka i tha i ati? Cili djalë tha se një ditë kishte shkue bregut të një lumi dhe kishte pá tue rá mbrendë një fëmijë të vogël? Çka kishte bënë ky një ditë? Kë

kishte pá tue rá mbrendë? Kush do t'ishte mbytë mbrendë po mos t'i a kishte ngjitë dorën? A ishte zhytë n'ujë dhe e kishte kapë fëmijën për krahu dhe e kishte shpëtue? Ku ishte zhytë? Kë kishte kapë për krahu? Kë kishte shpëtue? Çka kishte bâ ky, kur e kishte pá fëmijën e vogël tue rá në lumë? A i tha i ati edhe këtij se punë të mirë kishte bâ, por asgjâ mâ tepër se çka duhet të bâjmë të gjithë? Çka i tha i ati të dytit? A tregoi i treti se një ditë kur po shetitte kishte pá prej së largu një njeri, i cili s'donte t'a shifte gjallë? Kë kishte pá prej së largu? Kë kishte marrë gjumi në buzë të një mali? Ku e kishte marrë gjumi anmikun e tij? Po të kishte lëvizë pak gjâ, a do të kishte rá poshtë i vdekun? Çka do t'i kishte ngjâ anmikut po të kishte lëvizë pak gjâ? A e kishte zgjue ngadalë-ngadalë? Çka kishte bâ? A e kishte largue nga ai rrezik? Kë kishte largue nga ai rrezik? Kush e mori ngrykë dhe e puthi? Çka bâni i ati? A i tha: "Të lumtë! Ti e ke fitue unazën"? Kujt i tha baba: "Të lumtë! Ti e ke fitue unazën"? Çka i tha i ati të tretit? Mbas mendimit tuej, cili prej tre djelmve e ka bâ burrënin mâ të madhe? Po ju çka mendoni, Zotni...?

Sa të holla në javë fiton një punëtuer, zakonisht? Kush e fitoi luftën e fundit, Amerika apor Japonija? Kur merrni uhá të holla prej ndokujt, a i lëshoni diftesë? Kur i dërgoni valixhet me tren, a merrni diftesë prej nëpunësit të stacionit? Në ç'orë bini me fjetë? Në ç'orë ju merr gjumi? Po juve, a ju merr gjumi posa të bini me fjetë? A do t'a merrni ngrykë

nânën kur t'a shifni? A e merr nâna fëmijën ngrykë? Qysh e mba nâna fëmijën? Kur një ngjarje tregohet me të gjitha hollësit, a thuhet se ngjarja u-tregue fill e për për? A bleu vllai im një kuti lapsa? Kush do të blejë një kuti shkumës? Kush bleu një kuti krypë e një kuti mish derri? A bleva unë dy arka molla e një arkë dardha? A shiten këpucët e reja në kuti? A shiten portokallat me arkë? A ka shkrepë gjatë bregut të detit? Ku ka mjaft shkrepë? A është i thellë gjiu i Monterejt? Cili gji është i thellë? Sa i thellë është gjiu i Monterejt?



Enë balte në trajtën e një koke fëmije (shk. I të erës sonë) Tren, Korçë

Translate the following sentences into Albanian:

1. I gave him \$800, and he gave me a receipt.
2. It's dangerous to dive into this river because it isn't so deep.
3. Don't touch that box!
4. I don't trust him.
5. The sergeant told the recruits to spread out because it started to rain.
6. The company fired him because he had embezzled the sum of 10,000 leks.
7. Although he is a rich man, he is not happy.
8. I wouldn't buy it if I were you.
9. I wouldn't have sold it if I had had money.
10. We are not going to (will not) stop here; it's a sleepy town.




Foto : Nikolin Bano

besim, -i besime, -t	(m.)	trust, faith, confidence; religion
bujár, -i bujarë, -t	(m.)	nobleman; a generous person
me dá (unë dáj)	(v.)	to divide, separate, split; to distribute; to share
i, e, të dashun të dashuna	(adj. m.&f.)	dear (in forms of address); congenial; loving
diftesë, -a diftesa, -t	(f.)	receipt
dupje, -a dupje, -t	(f.)	gold coin
greminë, -a gremina, -t	(f.)	ravine, precipice, abyss
me u-hjedhë (unë hidhem)	(v.)	to jump, leap, to throw oneself
karvan, -i karvane, -t	(m.)	caravan
(prej së) largu	(adv.)	from afar
me lypë (unë lyp)	(v.)	to ask for; to beg one's pardon; to beg for alms
me marrë ngrykë (unë marr ngrykë)	(v.)	to embrace; to carry a baby in one's arms
me u-mbytë (unë mbytem)	(v.)	to get drowned; to be sunk
me ngurrue (unë ngurroj)	(v.)	to hesitate
me ngjitë (unë ngjis)	(v.)	to stick, paste; to attach
me u-ngjitë (unë ngjitem)	(v.)	to climb up, ascend; to be stuck, pasted

i, e, të panumërt të panumërta	(adj. m.&f.)	innumerable
peripetí, -ja peripetí, -t	(f.)	unexpected turn, vicissitude; ups and downs
me përpí (unë përpíj)	(v.)	to swallow; to suck in
me përvetue (unë përvetoj)	(v.)	to embezzle
i, të rrëmbyeshëm e, të rrëmbyeshme	(adj. m.&f.)	swift; hasty; temperamental
shkrep, -i shkrepa, -t	(m.)	boulder, rock, cliff
shoq, -i shokë, -t	(m.)	friend
shpat, -i shpate, -t	(m.)	slope
me u-shpërdá (shpërdahet)	(v.)	to be dispersed, scattered, spread; to be distributed
me shpërdorue (unë shpërdoruj)	(v.)	to abuse; to misuse
i, e, të thellë të thella	(adj. m.&f.)	deep, profound
uhá, -ja uhana, -t	(f.)	loan
vath, -i vathë, -t	(m.)	earring
i, e, të vdekun të vdekuna	(adj. m.&f.)	dead; clumsy; sleepy (town)
vetmohim, -i	(m.)	self-denial
virtyt, -i virtyte, -t	(m.)	virtue

Shënime:

fíll e për pë	in detail
lehtë e lehtë	gently
ngadalë-ngadalë	gradually; very slowly
po mos t'i a kishte ngjité dorën	if he had not helped him; if he had not given him a hand
me rá me fjetë (unë bij me fjetë)	to go to sleep



Një valle myzeqare në skenën e shtëpisë së kulturës.

(Fotografitë PIRO NAÇE)

Bora e Parë

1. Paska rá borë!
Vërtetë? E kam parapá se do të binte, sepse mbrámë ka qenë të ftohtë dhe rét ishin tepër poshtë.
2. Hajde në dritore dhe shife kopshtin si ka ndryshue! Vullájt dhe rruga e kopshtit nuk shifen má!
Sa e bukur ást natyra me këtë rrobë të bardhë! Shifi pemët, duken sikur kanë vù një qeleshe të bardhë.
3. Po, i shof; bile degët janë përkulë aq shumë prej peshës së borës sa mund të thyhen.
Me sa madhështí e kujdes ást tue ecë maca jonë! Në çdo çap kujdeset e çuditet.
4. Dishroj me shkue me bâ ski, në kodrën që gjindet në jug të qytetit!
Më vjen shumë keq, por nuk mund të të lá me shkue vetëm.
5. Unë di me bâ ski mirë, por megjithatë, sigurisht do të shkojnë edhe shokë tjerë.
Edhe me ata je vetëm! Mund të shkojsh të shtunden me babën. Tash për tash kënaqu tue luejtë me topa bore.
6. Do të dojshem me blé një triko të re; a do të m'a blejsh?
Ndoshta, por besoj se kam me të thurë unë një të bukur; dimni ást i gjatë!
7. Kam nevojë edhe për një palë dorëza.
Edhe dorëzat do të t'i bâj unë bashkë me trikon. Për çka tjetër ke nevojë?
8. Të falem nderës, s'kam nevojë për asgjá tjetër.
A i ke pá këpucët me qafa në se kanë nevojë për t'u-ndreqë?
9. Do t'i shof, por nuk besoj se kanë nevojë me u-goditë.
Në goftë se kanë nevojë çoji te këpuctari. Ki durim deri të shtunden!

PREPOSITIONS AND CASES THEY TAKE

As you learned in Lesson 53, Volume V, most prepositions go with the ablative case (prej kujt). A small number govern the objective case (kê). Very few go with the nominative case (kush). This is clearly reflected in the Frequency List of Prepositions and Prepositional Phrases that you have already received.

PREPOSITIONAL PHRASES

In this lesson, a good number of simple prepositions are used. It is through these that prepositional phrases are formed (preposition plus the case article e or të plus noun) and most go with the possessive case (i, e, të kujt).

Examples:

I mbeti automobili në mes të rrugës.
(His car got stuck in the middle of the road.)

Lajmin e mora me anën e nji miku.
(I received the news through a friend.)

Ju bāj të fala edhe n'emën të motrës.
(Greetings also on behalf of my sister.)

Ky fitim duhet të përdoret në dobi të shkollës.
(This profit should be used for the benefit of the school.)

Eja ti në vend të Fatosit.
(You come instead of Fatos.)

Ai mori punë në saje të zotësis së tij.
(He got the job because of his ability.)

Shumica votoi në favor të kandidatit tonë.
(The majority voted in favor of our candidate.)

Ishte dimën dhe era e veriut kishte fry për mjaft ditë. Nji natë, pa pritë e pa kujtue, rá bora e parë. U-çudita kur e pashë gjithë natyrën me at rrobë të bardhë. Kopshti ishte ndryshue krejt: rruga dhe vullajt e kopshtit ishin fshehë nën petkun e bardhë; vetëm aty-këtu dukesh ndonji gjeth i blertë i barishteve të mëdhaja. Bimët e mëdhaja dukeshin sikur kishin vû nji qeleshe të bardhë e degët e tyre ishin përkulë prej peshës së rëndë që bajshin.

Maca e zezë e shtëpis sonë ecte nëpër kopsht ngadalë e me madhështi; në çdo çap kujdesesh e çuditësh. Mâ në fund i u-afrue derës së shtëpis, bâni disa këcime e hyni mbrendë. Çunat e gocat luejshin me topa bore, tue u-dëfrye e tue u-kënaqë.

Nëpër rrugë shifeshin grumbuj djelmsh të rij e vajzash të reja, me skit e tyre mbi sup, të veshun me fanela leshi shumë ngjyrash, tue shkue nëpër kodra me bâ ski. Skiatorët e presin me padurim borën e parë, t'imtë e të butë për t'i u-ngjité kodravet e mandej për të shkitë teposhtë.

Njerzit e shtëpis po rrijshin pranë oxhakut: nâna po thurte nji triko, baba po lunte shah me xhajën, dikush po lexonte e dikush tjetër po bisedonte me zâ t'ulët. Unë u-ula pranë vllait dhe i thash diçka në vesh. Ai qeshi me zâ të naltë. Të tjerët na shikuen si me dashë me na tërhjekë vrejten për prishjen e qetësis, por nuk thanë gjâ, sepse në shtëpin tonë nji shikim i të mëdhajvet mjaftonte.

QUESTIONS - PYETJE

A ishte dimën dhe era e veriut kishte frÿ për mjaft ditë? Ç'stinë ishte? Cila erë kishte frÿ për mjaft ditë? A rá nji natë, pa pritë e pa kujtue, bora e parë? Çka rá nji natë pa pritë e pa kujtue? A u-çudita kur e pashë gjithë natyrën me at rrobë të bardhë? Kush u-çudit kur e pá gjithë natyrën me at rrobë të bardhë? Çka pashë që u-çudita? A ishte ndryshue kopshti krejt? Çka ishte ndryshue krejt? A ishin fshehë nën petkun e bardhë rruga e vullajt e kopshtit? Çka ishte fshehë nën petkun e bardhë? Në çka ishin fshehë rruga e vullajt e kopshtit? A dukesh vetëm aty-këtu ndonji gjeth i blertë i barishteve të mëdhaja? Çka dukesh vetëm aty-këtu? Ku dukesh ndonji gjeth i blertë i barishteve të mëdhaja? A dukeshin bimët e mëdhaja sikur kishin vû nji qeleshe të bardhë? Cilat bimë dukeshin sikur kishin vû nji qeleshe të bardhë? Si dukeshin bimët e mëdhaja? A ishin përkulë degët e tyne prej peshës së rëndë që bajshin? Cilat degë ishin përkulë prej peshës së rëndë që bajshin? Pse ishin përkulë degët e bimëveve të mëdhaja? Çka u kishte ngjã degëveve të bimëveve të mëdhaja prej peshës së rëndë që bajshin? A ecte nëpër kopsht ngadalë e me madhështí, maca e zezë e shtëpís sonë? Cila macë ecte nëpër kopsht ngadalë e me madhështí? Si ecte nëpër kopsht maca e zezë e shtëpís sonë? A kujdesesh e çuditësh në çdo çap që bënte? Çka bënte maca në çdo çap? A i u-afrue mã në fund derës së shtëpís? Çka bënte mã në fund maca? A bënte disa këcime dhe hÿni mbrendë? Çka

bāni maca e zezë e shtëpís sonë? A luejshin çunat e gocat me
 topa bore tue u-dëfrye e tue u-kënaqë? Kush luente me topa
 bore tue u-dëfrye e tue u-kënaqë? Me çka luejshin çunat e
 gocat? Çka bājshin çunat e gocat tue u-dëfrye e tue u-kënaqë?
 A shifeshin nëpër rrugë grumbuj djelmsh të rij e vajzash të
 reja? Çfarë djelmsh e çfarë vajzash shifeshin nëpër rrugë?
 A i bajshin skit e tyne mbi sup? Cilët i bajshin skit e
 tyne mbi sup? A ishin të veshun me fanela leshi shumë
 ngjyrash? Cilët ishin të veshun me fanela leshi shumë
 ngjyrash? Me çka ishin të veshun djelmt e vajzat që shi-
 feshin nëpër rrugë? A ishin tue shkue nëpër kodra me bā
 ski? Pse ishin tue shkue djelmt e vajzat nëpër kodra? A
 e presin skiatorët me padurim borën e parë për t'i u-ngjité
 kodravet e mandej për të shkitë teposhtë? Cilët e presin me
 padurim borën e parë, për t'i u-ngjité kodravet e mandej për
 të shkitë teposhtë? Qysh e presin skiatorët borën e parë?
 A është e përshtatshme për të bā ski bora e imtë dhe e butë?
 Çfarë bore është e përshtatshme për të bā ski? A po rrijshin
 pranë oxhakut njerzit e shtëpís? Cilët po rrijshin pranë
 oxhakut? Ku po rrijshin njerzit e shtëpís? A po thurte nāna
 nji triko? Çka po bānte nāna? A po luente baba me xhajën
 shah? Çfarë loje po luejshin baba dhe xhaja? Me kê po luente
 shah baba? Po dikush tjetër, a po bisedonte me zā t'ulët?
 A u-ula pranë vllait? Ku u-ula unë? Çka i thash vllait në
 vesh? A qeshi ai me zā të naltë? Si qeshi ai? A na shikuen
 të tjerët si me dashë me na tërhjekë vrejten? Kush na shikoi

si me dashë me na tërhjekë vrejrtjen për prishjen e qetësis?
 Çka bënë të tjerët kur qeshi vllai? Qysh na shikuen të tje-
 rët? Çka u prishëm na njerëzvet të shtëpis? A thanë gjâ?
 Kush nuk tha gjâ? A mjaftonte nji shikim i të mëdhajvet në
 shtëpin tonë? Nji shikim i kujt mjaftonte në shtëpin tonë?

A veshen njerzit në dimën me rroba të trasha? Me çfarë
 rrobash veshen njerzit në dimën? Po në verë, a veshen njerzit
 me rroba të lehta? Me çfarë rrobash veshen njerzit kur bân
 të nxehtë? Nji degë kur përkulet tepër, a thyhet? A janë
 pothuej njizet çapa prej këtu deri në ndërtesën tjetër? Sa
 çapa janë prej këtu deri në dyqanin ushtarak? A keni shkue
 ndonjiherë me bâ ski? A keni ju ski? A dini me bâ ski? A
 prishet shpesh nji automobil i vjetër? A punon sahati juej,
 apo është prishë? A mendoni se sot do të prishet moti? Çfarë
 ngjyre janë gjethët e pemëvet në verë? Ku i çoni këpucët kur
 kanë nevojë për t'u-ndreqë? Çfarë ngjyre janë qeleshet e
 shqiptarëvet? A dini me luejtë shah? Si quhet vllai i
 nânës? Po vllai i babës? Si quhet motra e nânës? Po motra
 e babës? A keni ndonji palë këpucë me qafa? A ka hekur
 Shqipnija?

Translate the following sentences into Albanian:

1. Does it snow much on these mountains?
2. Where do you have your suits pressed?
3. In these last years, this country has changed a lot.
4. Do all the trees shed their leaves in winter?
5. Has the wind bent all the branches of the apple tree?
6. Give this note another look (glance).
7. In some states in the U.S.A., the temperature drops below zero in winter.
8. Why don't you call their (the) attention to those who don't work?
9. On whose behalf are you talking now?
10. Instead of going to school, he went to the movies.

me b̄a ski (unë b̄aj ski)	(v.)	to ski
me bajtë (unë b̄aj)	(v.)	to carry, bear
bimë, -a bimë, -t	(f.)	plant
çap, -i çapa, -t	(m.)	step, pace
dorëz, -a dorëza, -t	(f.)	glove; handle; cuff of a shirt
me u-goditë (unë goditem)	(v.)	to be fixed, repaired; to be constructed, built; to come to an agreement
grumbull, -i grumbuj, -t	(m.)	group; crowd; pile, heap
hekur, -i	(m.)	iron
me hekurosë (unë hekuros)	(v.)	to iron (clothes)
i, e, t'imtë t'imta	(adj. m. f.)	fine (not coarse)
këpuctár, -i këpuctarë, -t	(m.)	shoemaker
me u-kujdesë (unë kujdesem)	(v.)	to take care of, pay attention to, attend to, see about, take trouble over
madhështí, -ja	(f.)	pride; arrogance; grandeur, splendor
me u-ndreqë (unë ndreqem)	(v.)	to be repaired, fixed, adjusted; to be reconciled
me ndryshue (unë ndryshoj)	(v.)	to change, differ, vary
me u-ndryshue (unë ndryshohem)	(v.)	to be changed; to change

padurim, -i	(m.)	impatience
me padurim	(adv.)	impatiently
me parapá (unë parashof)	(v.)	to foresee, foretell, predict
peshë, -a pesha, -t	(f.)	weight, load
petk, -u petka, -t	(m.) (f.)	dress (sing.) suit (pl.)
me u-përkulë (unë përkulem)	(v.)	to bend oneself; to bow to be bent; to droop
ski, -t	(m.)	ski
skiator, -i skiatorë, -t	(m.)	skier
sup, -i supe, -t	(m.)	shoulder
shah, -u	(m.)	chess
shikim, -i	(m.)	look
me shkitë (unë shkas)	(v.)	to glide, slide, slip, skate
teposhtë	(adv.)	downhill, downwards
triko, -ja triko, -t	(f.)	sweater
me thurë (unë thur)	(v.)	to knit; to fence in; to enclose
vullâ, -ni vullâj, -t	(m.)	garden bed

Shënime:

këpucë me qafa

boots (high shoes)

Lufta në Koré

1. A e dini kur dhe ku u-fundos "Grizhla", mina pastruese e Shtetevet të Bashkueme t'Amerikës?
Po, "Grizhla" u-fundos n'ujënat e Korés, pak kohë mbasi pati fillue lufta në Koré.
2. Pse u-fundos?
U-fundos sepse hasi në një minë ruse që qëndron pezull n'ujë.
3. Sa anije janë fundosë prej këso lloj minash?
"Grizhla" ka qenë e para anije që u-fundos, por e treta që hasi në mina që qëndrojnë pezull n'ujë.
4. Çfarë lloj anijesh kanë qenë dy të tjerat?
Një koracatë dhe një kryqë-zuer.
5. Sa vetë munguen nga mina pastruese "Grizhla"?
Njëzet e një vetë. Nuk u-muer vesh deri vonë se cilët prej tyre u-mbytën dhe cilët ishin gjallë.
6. A njifni ndonji prej atyne që u-mbytën?
Po, një prej tyre ishte edhe Toger Personi, i biri i Zotní dhe i Zojës R.L.Person.
7. A është e vërtetë se Rusia i ka ndihmue komunistat e Korés Veriore?
Po. Rusia i ka pajisë me armë, municion, aeroplana, aviatora e ushtarë nga Kina komuniste.
8. A është provue kjo gjâ?
Po, është provue edhe se të gjitha këto armë, jo vetëm që ishin fabrikue në Rusí, por edhe se kishin dalë nga depot ruse pak kohë mbasi filloi lufta.
9. Përveç komunistavet të Korés së Veriut, çfarë ushtarësh tjerë kanë luftue kundër forcavet të Kombevet të Bashkueme?
Patën qenë dërgue, gjithnjë të shtymë prej Rusís, edhe ushtarë kinezë, të pajisun me gjithfarë armësh.

- | | |
|--|---|
| <p>10. Si përfundoi çashtja e minavet që qëndrojnë pezull n'ujë?</p> | <p>Nuk e di; një gjeneral pati deklarue se përdorimi i tyre ishte i paligjshëm.</p> |
| <p>11. Kur i u-pré hovi komunistavet?</p> | <p>Mbasi kambësorija amerikane zbarkoi në Koré; më vonë u-bâ një armëpushim.</p> |
| <p>12. Si është tash gjendja atje?</p> | <p>E turbullt.</p> |



THE PAST AND THE FUTURE PROGRESSIVE

The progressive form has three tenses: past, present and future. The auxiliary verb "to be" is used with all three.

In Lesson 73, we reviewed the present progressive (the particle tue plus the participle). We also dealt with another form of the present progressive (the particle po followed by the indicative present).

Today we are going to learn the past and the future progressive.

Past progressive: To form the past progressive, use the imperfect tense of the verb "to be" plus the particle tue and the participle of the verb you wish to use. Another way to do this is to use the particle po plus the imperfect of the verb you wish to use. The examples that follow should make this a little easier to understand. The English, in this case, uses the simple past.

Example:

Na ishim tue pá (po shifshim) nji program televiziv kur rá tërmeti.

(We were watching a TV program when we felt the earthquake.)

Future progressive: The future progressive is formed using the future (in Albanian the present future) of the verb "to be" plus the present participle.

Example:

Nuk duhet të vemi tash sepse jam i sigurt se do të jenë tue fjetë.

(We shouldn't go now because I am sure they will be sleeping (they are asleep).)

The future progressive has only one form. There is no alternative using po as in the past and present progressive.

Pak kohë mbasi filloi lufta në Koré, "Grizhla", anije për pastrim minash, e Shtetevet të Bashkueme t'Amerikës, u-fundos n'ujënat e Korés nga një minë ruse. "Grizhla" që e para anije që u-fundos në luftën e Korés, por e treta që hasi në mina që qëndrojnë pezull n'ujë. Nji kryqëzuer dhe nji koracatë u-damtuen keqas prej këso minash.

Nga "Grizhla" munguen njizet e nji vetë; a ishin gjallë e ndoshta rob në duer t'anmikut, apo u mbytën nuk u-dijt deri vonë. Familjet e tyre nuk u-njoftuen fíll mbas aksidentit, mbasi kishte mundësi se, në mos të tănë, nji pjesë mund të kishte shpëtue.

Nji prej njizet e nji burravet që u-mbytën ishte edhe Toger Personi. Toger Personi ishte i biri i Zotní dhe i Zojës R.L.Person që banojshin në Rrugën e Pishës në Pasifik Grovë. Toger Personi kishte krye me lavd Shkollën Navale në Monterej. Kishte lindë me 23 prill 1924, n'Illinois.

Pothuej menjherë mbasi filloi lufta në Koré s'mbeti asnji dyshim se Rusija ishte tue i pajisë tërthorazi komunistat e Korés Veriore me armë, municion, aeroplana, aviatora e ushtarë nga Kina e Kuqe. Tanksa të lehtë e të rëndë u-zënë nga ushtrit e Kombevet të Bashkueme. U-provue se, jo vetëm që këta ishin të fabrikuem në Rusí, por edhe se kishin dalë nga depot ruse porsa pati fillue lufta. Përveç tanksavet u-zënë edhe topa, mitraloza e pushkë; edhe këto armë të bame në Rusí.

Nji nga gjeneralat e fuqivet të Kombevet të Bashkueme

deklaroi se përdorimi i minavet që qëndrojnë pezull n'ujë ishte i paligjshëm.

Zbarkimi i papritun i kambësoris amerikane e shkatrroi ushtrinë komuniste, e cila u-vû në t'ikun përtej paralelit të 38-të. Ky paralel e dën Korën e Veriut nga ajo e Jugut.

Hovi i komunizmit u-ndalue megjithëqë Kina e Rusija u erdhën në ndihmë komunistavet të Korës, por situata vazhdon të jetë e turbullt edhe sot.

QUESTIONS - PYETJE


A ishte "Grizhla" një anije për pastrim minash? Çfarë anije ishte "Grizhla"? E kujt ishte kjo anije? A u-fundos n'ujënat e Korës, pak kohë mbasi filloi lufta në Korë? N'ujënat e cilit shtet u-fundos anija "Grizhla"? Kur u-fundos "Grizhla"? A u-fundos nga një minë ruse? Cila anije u-fundos n'ujënat e Korës nga një minë ruse? A që "Grizhla" e para anije që u-fundos, n'ujënat e Korës? Cila që e para anije që u-fundos, n'ujënat e Korës? A që "Grizhla" e treta anije që hasi në mina që qëndrojnë pezull n'ujë? Sa anije tjera kanë hasë në mina që qëndrojnë pezull n'ujë? A u-damtuen keqas prej këso minash, një kryqëzuer dhe një koracatë? Prej çfarë minash u-damtuen keqas një kryqëzuer dhe një koracatë? Çfarë anijesh tjera u-damtuen keqas prej këso minash? A munguen nga "Grizhla" 21 vetë? Sa vetë munguen nga "Grizhla"? A u-dijt menjherë në se ishin gjallë apo jo? Çka nuk u-dijt deri vonë? Në se ishin gjallë, a mund t'ishin ndoshta robë në duer

t'anmikut? Cilët prej 21 vetëve që munguen mund t'ishin robë në duer t'anmikut? A u-njoftuen familjet e tyne fíll mbas aksidentit? Cilat familje nuk u-njoftuen fíll mbas aksidentit? A është e vërtetë se nuk u-njoftuen mbasi kishte mundësi se, në mos të tănë, një pjesë mund të kishte shpëtue? Pse nuk u-njoftuen menjherë familjet e tyne? Sa vetë prej tyne mund të kishin shpëtue? A është Toger Personi një prej 21 burravet që u-mbytën? Cili është një prej 21 burravet që u-mbytën? A ishte Toger Personi i biri i Zotní dhe i Zojës R.L.Person që banojshin në Rrugën e Pishës në Pasifik Grovë? I biri i kujt ishte Toger Personi? Ku banojshin prindët e tij? A e kishte krye me lavd Shkollën Navale në Monterej? Cilën shkollë kishte krye me lavd? Ku dhe kur kishte lindë Toger Personi? A ishte Rusia tue i pajisë tërthorazi komunistat e Korës Veriore? Kur s'mbeti asnjë dyshim se Rusia ishte tue i pajisë tërthorazi komunistat e Korës së Veriut? Si i pajiste Rusia komunistat e Korës Veriore? Cilët pajiste Rusia tërthorazi? A i pajiste me armë, municion, aeroplana, aviatora e ushtarë nga Kina e Kuqe? Me çka i pajiste Rusia komunistat e Korës Veriore? A u-zënë nga ushtrit e Kombevet të Bashkueme tanksa të lehtë e të rëndë? Nga cilat ushtri u-zënë tanksa të lehtë e të rëndë? Çka u-zû nga ushtrit e Kombevet të Bashkueme? A u-provue se, jo vetëm që këta ishin të fabrikuem në Rusí, por edhe se kishin dalë nga depot ruse porsa pati fillue lufta? Çka u-provue? Ku ishin të fabrikuem këta tanksa? Nga cilat depo kishin dalë dhe kur kishin dalë? A deklaroi

nji nga gjeneralat e fuqivet të Kombevet të Bashkueme se përdorimi i minavet që qëndrojnë pezull n'ujë ishte i paligjshëm? Çka deklaroi një nga gjeneralat e Kombevet të Bashkueme? Kush deklaroi se përdorimi i minavet që qëndrojnë pezull n'ujë ishte i paligjshëm? A e shkatërroi ushtrinë komuniste zbarkimi i papritun i kombësoris amerikane? Çka e shkatërroi ushtrinë komuniste? Cili zbarkim e shkatërroi ushtrinë komuniste? A u-vû në t'ikun përtej paralelit të 38-të ushtria komuniste? Cila ushtri u-vû në t'ikun përtej paralelit të 38-të? Përtej cilit paralel u-vû në t'ikun ushtria e Korës së Veriut? Ç'i ngjau ushtrisë komuniste kur zbarkoi kombësoria amerikane? Cili paralel e dën Korën e Veriut nga ajo e Jugut? A u-ndalue hovi i komunizmit, megjithëqë Kina e Rusia u erdhën në ndihmë komunistavet të Korës? A vazhdon të jetë edhe sot e turbullt situata? Si vazhdon të jetë situata në Korë?

A ka ngjã ndonji aksident mbrãmë? Çka ka ngjã mbrãmë në Sisajd? A u-nënshkrue armëpushimi në Korë më 1953? Në ç'vjet u-nënshkrue armëpushimi në Korë? A kemi ndonji aviator në këtë klasë? Në cilin qytet t'Amerikës fabrikohen më shumë automobila? Ku fabrikohen automobilat "Ford"? A keni pa ndonji anije tue u-fundosë? A keni hypë ndonjiherë në një koracatë? Po në një kryqëzuer, a keni hypë ndonjiherë? A ka mundësi të shkoni për Krishtlindje në shtëpi? A është e paligjshme në SHBA me e ngã automobilin n'anën e majtë të rrugës? A qëndrojnë hyjt pezull në hapësinë? Ku qëndrojnë hyjt pezull?

Sa robë lufte zûnë fuqit e Kombevet të Bashkueme gjatë Luftës Koreane? Cilat fuqit zûnë shumë robë lufte gjatë Luftës Koreane? A u-shkatrruen shumë qytete, gjatë Luftës së Dytë Botënore? A është uji i lumit Drin i turbullt? Qysh është uji i lumit Drin?



Modele t'anijeve "Limba" e "Brigantina."

Translate the following sentences into Albanian:

1. Is there any possibility that you'll go to Europe after you finish this course?
2. He told me indirectly that he couldn't do anything.
3. Is it legal to drive (the car) 65 mph on California's highways?
4. Would you say that the infantry achieved good results in World War II?
5. Is this another alley like the others?
6. The armies that fought in Korea were under the command of the UN.
7. When was the Korean armistice signed?
8. We found her setting the dining table.
9. What were those soldiers doing?
10. They were cleaning the machine guns.

PJESA E PESTË
FJALORI

LESSON 85
PART V
VOCABULARY

armëpushim, -i armëpushime, -t	(m.)	armistice
aviator, -i aviatora, -t	(m.)	pilot
me u-damtue (unë damtohem)	(v.)	to be damaged, harmed
me u-dërgue (unë dërgohem)	(v.)	to be sent
me u-dijtë (dihet)	(v.)	to be known
dyshim, -i dyshime, -t	(m.)	doubt, suspicion
me u-fabrikue (fabrikohe)	(v.)	to be manufactured
i, të fabrikuem e, të fabrikueme	(adj. m.&f.)	manufactured
fíll	(adv.)	straight
me u-fundosë (unë fundosem)	(v.)	to be sunk, submerged
gjeneral, -i gjenerala, -t	(m.)	general
me hasë (unë has)	(v.)	to bump into, encounter; to meet
höv, -i hove, -t	(m.)	impetus, momentum
Kinë, -a	(f.)	China
komb, -i kombe, -t	(m.)	nation
komunizëm, komunizmi	(m.)	communism
koracatë, -a koracata, -t	(f.)	battleship
Koré, Koreja	(f.)	Korea

kryqëzuer, kryqëzori kryqëzorë, -t	(m.)	cruiser
lavd, -i lavde, -t	(m.)	praise
me lindë (unë lind)	(v.)	to be born; to rise (for the sun)
me u-marrë vesh (unë merrem vesh)	(v.)	to be found out; to understand (one another)
minë, -a mina, -t	(f.)	mine
mitraloz, -i mitraloza, -t	(m.)	machine gun
munition, -i munitione, -t	(m.)	ammunition
me u-nënshkrue (nënshkruhet)	(v.)	to be signed
me u-njoftue (unë njoftohem)	(v.)	to be notified
me pajisë (unë pajis)	(v.)	to equip, furnish; to endow
i, të paligjshëm e, të paligjshme	(adj. m.&f.)	illegal, unlawful
i, e, të papritun të paprituna	(adj. m.&f.)	unexpected, sudden
paralel, -i paralele, -t	(m.)	parallel
pastrim, -i	(m.)	cleaning
pastrues, -e	(adj. m.&f.)	cleaning, cleansing, sweeping
pezull	(adv.)	afloat; aloft; pending
pishë, -a pisha, -t	(f.)	pine (tree)

me u-pré (unë pritem)	(v.)	to cut oneself; to be cut
rob, -i (rob lufte) robë, -t	(m.)	prisoner of war; slave
rus, -e rusë	(adj. m.&f.)	Russian
Rusí, -ja	(f.)	Russia
rrugicë, -a rrugica, -t	(f.)	not a through street, alley
situatë, -a situata, -t	(f.)	situation
me u-shkatrrue (unë shkatrrohem)	(v.)	to be destroyed, ruined; to break down
i shtÿm, të shtÿmë e, të shtÿme	(adj. m.&f.)	instigated, egged on
i, e, të tănë të tana	(adj.&pron. m.&f.)	all, whole
tanks, -i tanksa, -t	(m.)	tank (mil.)
tërthorazi	(adv.)	indirectly
i, e, të turbullt të turbullta	(adj. m. f.)	turbulent; troubled; stirred up; confused; muddy
verior, -e	(adj. m.&f.)	north, northern
zbarkim, -i zbarkime, -t	(m.)	landing (on shore from a ship)
<u>Shënime:</u>		
mina pastruese		mine sweeper
I u-pré hovi.		It was stopped. They were stopped.
me u-vû në t'ikun (unë vëhem në t'ikun)		to be routed

Vjeshta

1. Sa e dashun dhe e buzëqeshun është vjeshta!
Po, vërtetë! Vjeshta ka, përveç të miravet tjera, edhe bekimet e Perëndisë.
2. Si është vjeshta në vendin tuej?
Pothuej si kudo; dielli shëndrit butë e ngroftë dhe nuk t'i merr shtëpi në verë.
3. A ka mot të bukur?
Më të shumtën e kohës po, por aty-këtu ka edhe mjegull, pak a shumë të dendun.
4. A ka shumë pemë ke ju?
Mvaret nga krahina, por mollat, dardhat, pjeshkat, kumbullat e arrat rriten pothuajse kudo.
5. Çfarë rrushi rritet atje?
Bujqt i apin rëndësi të madhe rrushit të zë, që është shumë i mirë për venë.
6. Në ç'kohë fillon puna për bëmjen e venës së ré?
Nga fillimi i tetorit dhe kremtohet me një drekë gazmore.
7. Po barishte, a ka shumë?
Ka çdo lloj barishtesh, sidomos lakna, sallata, qepë, groshë etj.
8. Unë s'kam pá kurrë zgjoj; a keni shumë ju në vendin tuej?
Pothuej çdo katundar ka zgjojt e tij në kopsht; kalamajt u rrijnë gjithmonë afër dhe u çohet goja lang.
9. A çelin shumë lule në vjeshtë?
Jo shumë; aty-këtu shifen lulekuqe, lule kumbonë e disa tjera.
10. Ku kullosin grigjat?
Nëpër livadhe; grigja që kullot qetësisht, paraqet një pamje të këndshme.

11. Kujtoj se në vjeshtë
fillon edhe koha e
gjuetís.

Po, ndër pyje e lugina
ndigjohen, herë mbas here,
të shtimet e gjuetarëvet.

12. Çka tjetër mund të më
thoni për vjeshtën?

Pothuej asgjâ; dielli du-
ket më rrallë, derisa vjen
dimni me borë e akull.

2



3



THE SECOND AND THE THIRD FUTURE FORMS

As we explained in Lesson 29 Volume III, the number one form of the Albanian future tense uses the particle do plus the present tense subjunctive: do të shkoj, for example. This form is used throughout Albania.

In the conjugation of key verbs (see the reference book "Verbs"), you will actually see two more future forms. Both use the present tense of "to have" (me pasë or për të pasë) as an auxiliary, followed by the infinitive of the verb in use.

Examples:

2nd form: kam me shkue, or

3rd form: kam për të shkue

Both forms mean I'll go.

Even though these two forms are considered dialectical, they are used quite extensively. The number two form is used in the north and the number three form in Southern Albania and some parts of the north.

The second and third forms of the future sometimes have the additional meaning of necessity or need. This corresponds to the English verb "to have to." See Lesson 64, Volume VII.

Vjeshta është ndoshta më e buzëqeshuna e më e erandshmja stinë e vjetit. Kjo stinë nuk është e hijshme, e shkëlqyeshme dhe e këndshme si pranvera, por është e dashun, e ëmbël dhe plot bekime të Perëndisë.

Dielli i vjeshtës nuk djeg si dielli i verës, por shëndrit butë e ngroftë; drita e tij nuk është aq e shkëlqyeshme sa me t'i marrë syt. Mëngjesi është i freskët, dielli lufton me mjegullën e dendun dhe vetëm afër mesdite e shpërdan këtë; atëherë duket qielli i qartë dhe dielli shëndrit kudo: ndër pyje, ndër liqëj dhe ndër lugina, ku kullot grigja.

Në kopsht e në vneshtë drujt janë plot me kokrra; bujqat çojnë ndër shtëpi kosha plot me molla faqekuqe, me dardha të verdha si florini, me pjeshka me lëkurë si kadife, me kumbulla dhe me arra ende të mbulueme me lëvore: rrushi i zif dhe i bardhë është gati për t'u-vjelë e shpejt do të kremtohet të lemit e venës së ré. Bujkeshja, me fytyrë gazmore vren laknat e harlisuna, sallatën e blertë e qepët e mëdhaja. Kalamajt i çelin me gëzim bishtajat e groshëvet dhe u çohet goja lang kur u afrohen zgjojvet të bletëvet, që janë plot me mjaltë.

Lulet e pranverës e të verës, prej të cilave bletët punëtore kanë mbledhë nektar, janë thá. Era e tyne nuk e mbush më kopshtin, por megjithëkëtë nuk mungojnë dhuntit e fundit të kohës së bukur të lulevet: aty-këtu lulëzon ndonji lulekuqe, kacaviret ndonji lule kumbonë. Mjerisht, mjafton vetëm një natë e ftoftë bryme me i mbytë të gjitha përnjiherë;

në mëngjes, porsa të lejë dielli, mbaron kjo bukuri.

Në livadh, pamjen më të këndshme të vjeshtës na e paraqet grigja, që kullot në qetësi; përmallshëm tingëllon prej së largu cingarja e lopëvet.

Fluturimi i zogjvet nuk i ep më jetë pyllit. Disa nga këngëtarët e këndshëm kanë ikë; disa të tjerë i përgatiten udhëtimit. Për së shpejti ka për të mbretnue heshtje e plotë në pyll; nëpër ato vende të shurdhëta do të jehojnë vetëm të shtimet e gjuetarëve.

Nga mbarimi i vjeshtës dielli fillon të duket më rrallë; rë të denduna kalojnë në qiell dhe shiu nuk pushon për shumë ditë me radhë. Shpejt ka për t'ardhë dimni me borë e akull.

QUESTIONS-PYETJE

Cila stinë është ndoshta më e buzëqeshuna e më e erandshmja e vjetit? Çfarë stine është vjeshta? Cila stinë nuk është e hijshme, e shkëlqyeshme dhe e këndshme si pranvera? Si cila stinë nuk është vjeshta e hijshme, e shkëlqyeshme dhe e këndshme? A është vjeshta e dashun, e ëmbël dhe plot bekime të Perëndisë? Qysh është vjeshta? Plot çka është vjeshta? A djeg dielli i vjeshtës si dielli i verës? Çka bënë dielli i vjeshtës butë e ëmbël? Si shëndrit dielli i vjeshtës? A është drita e diellit në vjeshtë aq e shkëlqyeshme sa me t'i marrë syt? Kur nuk t'i merr syt drita e diellit? Qysh është mëngjesi në vjeshtë? Kur është mëngjesi i freskët? Me çka lufton

dielli në vjeshtë? Me çfarë mjegulle lufton dielli në vjeshtë? Kur e shpërdán dielli mjegullën? Çka bân dielli afër mesdite? Kur duket qielli i qartë dhe dielli shëndrit kudo? Çka shëndrit kudo: ndër pyje, ndër liqëj dhe ndër lugina, ku kullot grigja? Ku janë drūjt plot me kokrra? Plot me çka janë drūjt e kopshtit? Cilët çojnë ndër shtëpí kosha plot me molla faqekuqe, me dardha të verdha si florfini e me kumbulla? Çka çojnë bujqt ndër shtëpí plot me pjeshka me lëkurë si kadife e me arra ende të mbulueme me lëvore? Si është rrushi i zí dhe i bardhë? Çka është gati për t'u-vjelë? Kur do të kremtohet të lemit e venës së ré? Çka do të kremtohet shpejt? Kush i vren me fytyrë gazmore laknat e harlisuna, sallatën e blertë e qepët e mëdhaja? Me çfarë fytyre i vren bujkesha laknat e harlisuna, sallatën e blertë dhe qepët e mëdhaja? Qysh janë laknat dhe sallata që vren bujkesha? Cilët i çelin me gëzim bishtajat e groshëvet? Cilat bishtaja çelin kalamajt me gëzim? Çka bëjnë kalamajt me gëzim? Cilëve u çohet goja lang kur u afrohen zgjojvet të bletëvet, që janë plot me mjaltë? Çka u ngjân kalamajvet kur u afrohen zgjojvet të bletëvet, që janë plot me mjaltë? Plot me çka janë zgjojt e bletëvet, të cilëve u afrohen kalamajt? A janë thá lulet, prej të cilave bletët punëtore kanë mbledhë nektár? Çka u ka ngjá lulevet, prej të cilave bletët punëtore kanë mbledhë nektár? Cila erë nuk e mbush kopshtin? Çka nuk e mbush má kopshtin? Por megjithëkëtë, a mungojnë dhuntít e fundit të kohës së bukur të lulevet? Çka nuk mungon,

megjithëqë era e lulevet nuk e mbush mǎ kopshtin? Çka lulëzon aty-këtu? Mjerisht, çfarë nate mjafton me i mbytë të gjitha përnjiherë? Çka u bǎn lulevet të vjeshtës nji natë e ftoftë bryme? Kur mbaron kjo bukuri? Çka ngjǎn në mëngjes, porsa të lejë dielli? Në livadh, çka na e paraqet pamjen mǎ të kandshme të vjeshtës? Çka paraqet grigja në livadh? Si kullot grigja? Çka tingëllon përmallshëm prej së largu? Si tingëllon prej së largu cingarja e lopëvet? Çka nuk i ep mǎ jetë e gjallëni pyllit? Çka kanë bǎ disa nga këngëtarët e këndshëm? Sa zogj kanë ikë? Po disa tjerë, çka bǎjnë? Çka ka për të mbretnue në pyll për së shpejti? Ku ka për të mbretnue për së shpejti heshtje e plotë? Çka do të jehojë nëpër ato vende të shurdhëta? Të shtimet e kujt do të jehojnë nëpër ato vende të shurdhëta? Qysh fillon të duket dielli nga mbarimi i vjeshtës? Kur fillon të duket dielli mǎ rrallë? Çfarë rësh kalojnë në qiell nga mbarimi i vjeshtës? Po shiu, a pushon shpejt? Çka bǎn shiu për shumë ditë me radhë? Cila stinë ka për t'ardhë me borë e akull? Çka bie me vete dimni?

A e djeg dorën nji copë hekur shumë i nxehtë? A t'i merr sÿt, natën, drita e nji automobili? A i ngjǎn kadifes lëkura e pjeshkavet? A janë të mbulueme arrat me lëvore kur janë në pemë? A u bje lëvorja arravet kur pigen? Nji pemë e vjetër që nuk bǎn mǎ pemë, a thuhet se është thá? A bje brymë natën në kët qytet? Në ç'stinë bje zakonisht brymë? Thoni emnat e disa langjeve!

Translate the following sentences into Albanian:

1. When I see sweets (pastries), my mouth waters.
2. In what season do the days become shorter and the nights longer?
3. In that room, there is a large basket full of peaches.
4. Tomorrow I'll get up (1st future form) early because I have to go (3rd future form) to Elbasan.
5. The new highway will pass through that valley.
6. What kind of milk do they use mostly in America?
7. It depends on him; I have accepted it.
8. The women of Korça make beautiful rugs.
9. He comes to see us very seldom; he should come more often.
10. It has rained a lot these last days.

arrë, -a arra, -t	(f.)	walnut
bâmje, -a	(f.)	making
bekim, -i bekime, -t	(m.)	blessing
bujkeshë, -a bujkeshë, -t	(f.)	the farmer's wife
butë	(adv.)	softly, gently
i, e, të buzëqeshun të buzëqeshuna	(adj. m.&f.)	smiling
cingare, cingarja cingare, -t	(f.)	small bell (used on cattle)
i, e, të dendun të denduna	(adj. m.&f.)	dense; compact; frequent
dhuntí, -ja dhuntí, -t	(f.)	gift, present
i, t'erandshëm e, t'erandshme	(adj. m.&f.)	fragrant
faqekuq, -e	(adj. m.&f.)	rosy-cheeked
fluturim, -i fluturime, -t	(m.)	flight
gazmuer, gazmore	(adj. m.&f.)	festive, happy
grigjë, -a grigja, -t	(f.)	flock, herd
gjuetar, -i gjuetarë, -t	(m.)	hunter
i, e, të harlisun të harlisuna	(adj. m.&f.)	well-grown
i, të hijshëm e, të hijshme	(adj. m.&f.)	beautiful, handsome

me jehue (jehon)	(v.)	to echo
me u-kacavjerrë (unë kacavirem)	(v.)	to clamber
kadife, kadifja	(v.)	velvet
kalama, -ni kalamaj, -t	m.)	a child from 8 to 9 years old; a small child
i, të kandshëm e, të kandshme	(adj. m. f.)	pleasant
kângëtár, -i kângëtarë, -t	(m.)	singer
kokërr, kokrra kokrra, -t	(f.)	anything with a round or oval shape, especially fruit
kosh, -i kosha, -t	(m.)	a large basket
me u-kremtue (kremtohet)	(v.)	to be celebrated
kumbull, -a kumbulla, -t	(f.)	plum (tree & fruit)
të lém, -it	(neut.)	birth; sunrise
lëvore, lëvorja lëvore, -t	(f.)	skin, peel, rind
luginë, -a lugina, -t	(f.)	valley
lule kumbonë, -a lule kumbona, -t	(f.)	morning glory
lulekuqe, lulekuqja lulekuqe, -t	(f.)	poppy
me lulëzue (lulëzon)	(v.)	to blossom; to flourish
mesditë, -a	(f.)	noon, midday; lunch

e mirë, -a të mira, -t	(f.)	(the) nice, good thing
mot, -i	(m.)	weather; year (one year only)
nektár, -i	(m.)	nectar
përmallshëm	(adv.)	longingly
përnjherë	(adv.)	at once, immediately; at the same time
me u-pjekë (unë piqem)	(v.)	to be ripened; to be baked; to meet
i, e, të plotë të plota	(adj. m.&f.)	complete, full
me u-pregatitë (unë përgatitem)	(v.)	to get ready; to be prepared
qetësisht	(adv.)	peacefully
i, të shkëlqyeshëm e, të shkëlqyeshme	(adj. m.&f.)	brilliant, excellent, shining
(për së) shpejti	(adv.)	soon, shortly
e shtime, e shtimja të shtime, -t	(f.)	shot, charge, report (of a gun)
i, e, të shurdhët të shurdhëta	(adj. m.&f.)	deaf
me tingëllue (unë tingëlloj)	(v.)	to ring, tinkle; to sound
me u-vjelë (vilet)	(v.)	to be harvested (fruit, corn, tobacco); to be collected (taxes)
me vrejtë (unë vrej)	(v.)	to observe
zgjue, zgjoni zgjoj, -t	(m.)	beehive

Shënime:

me u-çue goja lang (më çohet goja lang)	(v.)	to water one's mouth
me (të) marrë sýt (më merr sýt)	(v.)	to dazzle
me rá brymë (bje brymë)	(v.)	to be frosty



Llogaraja.

Çmimi i Heshtjes

1. Ç'të ré ka pasë sot
n'akademín tuej të
famshme, Zotní Kryetár?
Sot jam shumë i kënaqun,
Zotní Gjykatës! N'akademí
është pranue si anëtár nji
njeri me të vërtetë i zoti:
Dr. Zebi.
2. Personalisht nuk e njof,
por kam lexue kryeveprën
e tij që është nji libër
i shkëlqyeshëm.
Përveç zotësis, sot ka dhënë
edhe nji provë tjetër: se
është i urtë dhe i thjeshtë.
3. Nga e morët vesh këtë?
Ishim të mbledhun në sallë
kur shërbëtori më solli nji
pusullë, me të cilën Dr. Zebi
kërkonte me u-bâ anëtár.
4. Më falni se po ju a pres
fjalën! A mos u-zû disa
ditë më parë vendi që ki-
shi të lirë?
Tamam këtë desha të ju thom:
vendi i liruem u-zû prej nji
njeriu që s'ka merita të
veçanta.
5. Thonë se, kur do të prano-
hesh, mbajti nji fjalim
të bukur!
Po, për ata që nuk mendojnë
shumë thellë. Kur morëm pusu-
llën e Dr. Zebit, akademikët
dhe unë qemë të pikëlluem.
6. Pse?
Sepse na erdhi keq që qemë
të detyruem mos me e pranue.
Ka q u-turbullova sa nuk dijta
si me i u-përgjegjë.
7. Ç'mënyrë gjetët me i
thënë se akademija nuk
kishte më vend?
Porosita nji gotë, të cilën
e mbusha me ujë aq fort sa
me nji pikë tjetër uji do të
derdesh.
8. Nuk do të kishi mundë
me gjetë asnji fjalë
më kuptimplote se ç'ishte
ajo gotë e mbushun.
Thirra Dr. Zebin dhe i tre-
gova gotën; e kuptoi menji-
herë se ajo gotë donte me
thënë se n'akademí s'kishte
më vend për të.
9. Ç'tha ai?
Nuk tha gjë, por u-ul, mori
nji gjeth drandofillje që
ishte përdhë dhe e vûni mbi
sipërfaqen e ujit. Uji nuk
u-derdh.

10. Edhe Dr. Zebi nuk mund t'i gjente gotës një përgjegje më të hollë.

Për këtë përgjegje të gjithë duertrokitën dhe e pranuem Dr. Zebin anëtar, kundër rregullores.

11. A mbaroi me kaq?

Jo, në regjistër t'akademís, ku duhet të shkruente dy fjalë falënderimi shenoi numrin 100 dhe para këtij numri shtoi një zero dhe këto fjalë: "Nuk do të vlejë as më shumë as më pak".

12. Pse numrin 100?

Sepse 100 ishin anëtarët e akademís deri sot.

13. Po ju, qysh u-përgjegjët?

Unë e prisha zeron dhe i a shtova numrit 100; mandej shkrova edhe këto fjalë: "Do të vlejë 10 herë më shumë".



Pamje nga muri rrethues i Onesmit të lashtë.

THE USAGE OF THE PARTICLE pa WITH THE PRESENT PARTICIPLE

In Lesson 53, Volume V, we learned the use of the particle pa as a preposition governing the objective case (kê). In Lesson 69, Volume VII, we used pa as a negative prefix for nouns and adjectives. It is also used in mathematics to mean "minus," and in telling time, e.g., "ten minutes to ten." Pa is also used idiomatically with some imperative verb forms, but this will be explained in another phase of the course.

In this lesson, we find pa used as a negative preceding the present participle. In English, it corresponds to the preposition "without" followed by the present participle.

Examples:

E mori pa thënë asnji fjalë.
(He took it without saying a word.)

E ama e çoi me fjetë pa hangër.
(His mother sent him to bed without eating.)

Liriya nuk fitohet pa derdhë gjak.
(Freedom is not won without shedding blood.)

THE DECLENSION OF THE ALBANIAN INDEFINITE NOUN FOLLOWED BY A POSSESSIVE PRONOUN

Examples:

	nji shoku im (masc.) - nom. -	nji shoqja ime (fem.)
i, e, të	nji shoku tim - gen. -	i, e, të nji shoqje sime
	nji shoku tim - dat. -	nji shoqje sime
	nji shokun tim - acc. -	nji shogen time
prej	nji shoku tim - abl. -	prej nji shoqje sime

Në Hamadan, Persí, ishte një akademi e përmendun. Neni i parë i rregullores së kësaj akademije ishte ky: "Akademikët duhet të mendojnë shumë, të shkruajnë pak dhe të kuvendojnë (bisedojnë), sa të jetë e mundun edhe më pak". E quejshin Akademia e Heshtjes, dhe çdo dijetar i vërtetë në Persí e kishte për nder të merrte pjesë në të.

Doktor Zebi, autor i një libri fort të shkëlqyeshëm, mori vesh se në akademi ishte lirë një vend. U-nis menjherë, shkoi në Hamadan dhe kur vojtë ke dera e sallës ku ishin mbledhë akademikët, i u-lut shërbëtorit që t'i epte kryetarit një pusullë, në të cilën kishte shkruar këto fjalë: "Doktor Zebi kërkon përvujtnisht vendin e lirë".

Shërbëtori bëri si u-porosit, por fatkeqësisht doktori dhe shkresa e tij kishin marrëjtë me shumë vonesë, sepse vendi i çelun ishte zënë prej një tjetri.

Akademikët u-pikëlluen tepër për këtë vonesë. Këta kishin pranuar si anëtar, pak kundër dishirit të tyre, një njeri që nuk kishte aq shumë merita, i cili me një fjalim të lehtë dhe të nxehtë kishte fituar dashurinë e atyre që nuk mendojshin shumë thellë; tashti ishin të detyruar që të mos pranojshin një njeri me vleftë aq të madhe sa atë të Doktor Zebit.

Kryetari, që e kishte për detyrë t'i a epte doktorit këtë lajm të papëlqyeshëm, s'dinte si me i a filluar dhe prandaj u-turbulluar. Por mbasi mendoi pak urdhënoi që t'i bijshin një gotë të madhe, të cilën e mbushi aq plot me ujë, sa po të

shtohesh një pikë më tepër, uji do të derdresh. Mandej urdhënoi që të thërritshin mbrendë doktorin, i cili hyni me një të sjellun të matun e të thjeshtë, që tregon kurdoherë meritimin e vërtetë.

Kryetari u-çue më kambë dhe pa thënë asnjë fjalë i tregoi doktorit kupën e mbushun. Ky e kuptoi që donte me thënë se në akademi nuk kishte më vend, por pa u-idhnue u-mundue me i dhënë me kuptue kryetarit se një akademik më tepër nuk do të prishte punë. Pa përdhë një gjeth drandofillje; u-ul dhe e mori e me kujdes të veçantë e vëni mbi sipërfaqen e ujit, në mënyrë që nuk u-derdh asnjë pikë.

Për këtë përgjegje kaq të hollë, të gjithë duertrokitën; prishën rregulloren po at ditë dhe Doktor Zebi u-pranue me britma gëzimi. Mandej i vëni përpara regjistrin e akademisë, në të cilin çdo anëtar vënte nënshkrimin e tij dhe shkruente disa radhë falënderimi. Mbase e nënshkroi, Doktor Zebi shenoi në buzë të faqes së regjistrit numrin 100, që ishte numri i anëtarëve dhe përpara njishit shtoi një zero dhe shkroi këto fjalë: "Nuk do të vlejë as më shumë as më pak".

Kryetari u-përgjegj shumë bukur: vëni zeron mbase numrit 100 dhe shkroi këto fjalë: "Do të vlejë 10 herë më shumë".

QUESTIONS - PYETJE

Ku ishte një akademi fort e përmendun? Çfarë akademije ishte ajo që gjindesh në Hamadan? Cili ishte neni i parë i rregullores? Çka duhet të bëjshin anëtarët e akademisë? Si e quejshin

kët akademí? A e kishte për nder çdo dijetár të merrte pjesë në të? Çka e kishin për nder me bā dijetarët? Kush ishte Doktor Zebi? Çka kishte shkruar ky? Çka mori vesh Doktor Zebi? Në cilën akademí ishte lirue një vend? Kush u-nis e shkoi menjihërë në Hamadan? A vojti ke dera e sallës ku ishin mbledhë akademikët? Ke cila sallë vojti Doktor Zebi? Kujt i u-lut doktori që t'i epte kryetarit një pusullë? Çka kishte shkruar në at pusullë? Çka kërkonte Doktor Zebi me at pusullë? Në çfarë mënyre e kërkonte vendin e liruem? Çka bāni shërbëtori? A kishin mrrijtë me kohë doktori dhe shkresa e tij? Prej kujt ishte zānë vendi i liruem? Cili vend ishte zānë prej një tjetrit? Kur mrrijtën doktori dhe shkresa e tij, a qe i liruem vendi? Për çka u-pikëlluen akademikët? Kë kishin pranue akademikët si anëtar pak kundër dishirit të tyre? Çfarë njeriu ishte kandidati që u-pranue si anëtar i akademís? Çfarë fjalimi kishte mbajtë ai para se të pranohesh si anëtar? Dashunin e kujt kishte fitue kandidati me një fjalim të lehtë e të nxehtë? Si mendojshin disa prej anëtarëvet? Cilët ishin të detyruem të mos pranojshin në akademí një njeri me vleftë aq të madhe sa të Doktor Zebit? Çka ishin të detyruem të bājshin akademikët? Kush e kishte për detyrë t'i a epte këtë lajm të papëlqyeshëm Doktor Zebit? Çfarë lajmi duhet t'i epte kryetari i akademís Doktor Zebit? A dinte si me i a fillue? Kush u-turbullue? Mbasi u-mendue pak, çka urdhënoi t'i bijshin? Çka bāni me gotën e madhe që i prunë? Çka mbushi plot me ujë në mënyrë që një pikë uji më tepër po t'i shtohesh do

të derdheshe? Kë urdhënoi pastaj të thërritshin mbrendë? Si hyni mbrendë Doktor Zebi? Kush u-çue më kambë dhe i tregoi doktorit kupën e mbushun? A tha ndonji fjalë kryetari kur i tregoi kupën? Kush e kuptoi se ç'donte me thënë kupa plot me ujë? Çka donte me thënë kupa plot me ujë? Ku nuk kishte më vend për një anëtar tjetër? Kush u-mundue, pa u-zemrue, me i dhënë me kuptue kryetarit se një akademik më tepër nuk do të prishte punë? Çka po mundohesh me i dhënë me kuptue kryetarit t'akademis Doktor Zebi? Çka pa përdhë Doktor Zebi? Ku e vuni gjethin e drandofilles? Me çfarë kujdesi e vuni gjethin e drandofilles mbi sipërfaqen e ujit? Cilët duertrokitën për këtë përgjegje kaq të hollë? Pse duertrokitën anëtarët e akademis? Kur e prishën rregulloren e akademis? A u-pranue Doktor Zebi me britma gëzimi? Kë pranuen akademikët me britma gëzimi? Çka i vënë mandej përpara Doktor Zebit? Çka ishte zakon me bënë në regjistrin e akademis? Cilët vëjshin nënshkrimin e tyre në at regjistër? Kush nënshkroi në regjistër? A ishte zakon, simbas rregullores, me shkruë pak fjalë falënderimi? Çka ishte zakon me bënë kur pranohesh në akademi një anëtar i ri? Si veprroi Doktor Zebi për të falënderue anëtarët e akademis? Çka shkroi në buzë të faqes së regjistrit? Çka diftonte ai numër? Çka shtoi përpara njishit? Çka shkroi? Si u-përgjegj kryetari? Ku e vuni ky zeron dhe çka shkroi? Kush do të vlente 10 herë më shumë?

Si quhet Akademia Ushtarake e Shteteve të Bashkueme? Në cilin qytet gjindet Akademia Navale? Kur shkoni për të fjetë në një hotel, ku e shkrueni emnin tuej? A kishte vonesë treni mbramë?

Translate the following sentences into Albanian

1. He gave (held) a very good speech; all applauded.
2. Usually he talks without thinking.
3. Whenever you need me, let me know!
4. In Albanian, "he is a plain soldier" means that he doesn't have any rank.
5. How many names of flowers besides the rose do you know in Albanian?
6. Put your signature on this memorandum, please, and then give it to me.
7. He was declared innocent and released right away.
8. Don't do it; it's against the regulations.
9. We can't start without him (being here).
10. I went (me vojtë) to the hospital to see a friend of mine who is sick. (See GRAMMAR NOTES #2 of this lesson in order to translate the underlined English part of this sentence.)

PJESA E PESTË
FJALORI

LESSON 87
PART V
VOCABULARY

akademi, -ja akademi, -t	(f.)	academy
akademik, -u akademikë, -t	(m.)	academician (a member of an academy of arts, literature, etc.)
autor, -i autorë, -t	(m.)	author
britëm, britma britma, -t	(f.)	shout, shouting; call; cry
i, e, të çelun të çeluna	(adj. m.&f.)	vacant; open, opened
dijetar, -i dijetare, -t	(m.)	scholar, a learned person
drandofille, drandofillja drandofille, -t	(m.)	rose
me duertrokitë (unë duertrokis)	(v.)	to applaud
falënderim, -i falënderime, -t	(m.)	thanks
fjalim, -i fjalime, -t	(m.)	speech
gjeth, -i gjethë, -t	(m.)	leaf
me u-idhnue (unë idhnohem)	(v.)	to get angry; to get excited
i, e, të kënaqun të kënaquna	(adj. m.&f.)	satisfied; happy
kryevepër, kryevepra kryevepra, -t	(f.)	masterpiece
kupë, -a kupa, -t	(f.)	cup, glass; goblet
kuptimplot, -e	(adj. m.&f.)	meaningful

kurdoherë	(adv.)	always; whenever; at any time
me kuvendue (unë kuvendoj)	(v.)	to chat, talk, converse, discuss
i, të liruem e, të lirueme	(adj. m.&f.)	vacated, freed
i, e, të matun të matuna	(adj. m.&f.)	cautious, prudent; measured
i, e, të mbledhun të mbledhuna	(adj. m.&f.)	gathered, assembled; collected
meritë, -a merita, -t	(f.)	merit
meritim, -i meritime, -t	(m.)	deserving; worthiness
nen, -i nene, -t	(m.)	article (of law)
nënshkrim, -i nënshkrime, -t	(m.)	signature
i, të papëlqyeshëm e, të papëlqyeshme	(adj. m.&f.)	unpleasant
personalisht	(adv.)	personally
i, e, të përmendun të përmenduna	(adj. m.&f.)	renowned, well-known; mentioned
përvujtnisht	(adv.)	humbly
pikë, -a pika, -t	(f.)	drop; period (grammar); dot; point; apoplexy (stroke), heart attack
me u-pikëllue (unë pikëllohem)	(v.)	to be grieved, to be very sad.
i, të pikëlluem e, të pikëllueme	(adj. m.&f.)	grieved, bereaved
me u-porositë (unë porositem)	(v.)	to be instructed; to be ordered (things)

me u-pranue (unë pranohe)	(v.)	to be accepted, admitted
provë, -a prova, -t	(f.)	proof; rehearsal
regjistër, regjistri regjistra, -t	(m.)	register
të sjellun, -it	(neuter)	behavior; turn; bringing
shkresë, -a shkresa, -t	(f.)	official letter
tashti	(adv.)	now
me u-turbullue (unë turbullohe)	(v.)	to be confused; to be stirred up; to get muddy
thellë	(adv.)	deep, deeply, profound, profoundly
i, e, t'urtë t'urta	(adj. m. f.)	wise; sensible; nice; prudent; peaceful
me vjeftë (unë vlej)	(v.)	to be worth; to cost
vleftë, -a vlefta, -t	(f.)	value, cost
me vajtë (unë vete)	(v.)	to go
zotësi, -ja	(f.)	ability, capability

Shënime:

me dhënë me kuptue (unë ap me kuptue)	(v.)	to imply
me mbajtë fjalim (unë mbaj fjalim)	(v.)	to give a speech
E kishte për nder.		It was an honor for him.
Nuk do të prishte punë.		It wouldn't make any difference.
Ç'të ré kemi?		What's new?

Lëkura e Ariut

1. Nesër do të dal për gjah për arij, a do të vini edhe ju?
Më vjen keq, por mue nuk më pëlqen gjuetija e kafshëvet t'egra; preferoj gjuetin e shpendëvet.
2. Çfarë shpendësh gjueni?
Varet nga stina dhe nga zona ku shkoj me gjuejtë; zakonisht shepka ndër pyje e rosa t'egra ndër kënetat.
3. Çfarë pushke përdoroni?
Çifte me shasme. Po ju, ku shkoni me gjuejtë arij?
4. Në pyll, por nganjherë zbresin edhe afër kënetave ase lumejvet për të p'ujë.
Çfarë lloj arme përdoroni?
5. Kam mauzer dhe përdoroj fishekë me plumba.
A është e rrezikshme gjuetija e arijvet?
6. Sigurisht! Ariu e ka zakon me sulmue, prandej duhet t'a vrasish me të shtimen e parë ase të dytën.
Ku i kanë arijt strofujt e tyne?
7. Varet nga raca: disa ndër shpella e disa ndër pemë, ku bājnë edhe këlyshë.
Ndër pemë? Këta janë arij të një race të vogël dhe nuk janë të rrezikshëm.
8. Po, është e vërtetë.
Çfarë ngjyre i kanë qimet arijt që gjueni ju?
9. Kanë qime të murme.
Po arij të bardhë, a nuk gjueni ndonjiherë?
10. Jo, sepse arijt e bardhë jetojnë ndër zonat polare; ata duen klimë të ftoftë.
Ndër vende tona dimni është mjaft i ftoftë; pse të mos jetojnë edhe këtu?
11. Sepse vera është e ngroftë dhe arijt e bardhë do të ngordhshin me siguri.
E kuptoj! Tash më falni; ju uroj fat të mirë për nesër e kini kujdes të mos ju kafshojë befas ndonji ari.
12. Ju falem nderit.

THE OPTATIVE MODE

In Lesson 53, Volume VI, we talked indirectly about the optative mode while learning to form the conditional. But the optative mode itself has not really been explained in any lesson so far.

The optative mode is mostly used to congratulate people or to wish them well. On the other hand, it is also used to curse or damn people or to call them names. This mode does not exist in the English language.

The optative has two tenses: present and present perfect. The present tense is formed by adding the following endings to the stem of the verb. This rule covers the majority of the verbs in Albanian.

Examples:

Verb stems ending with
a vowel:

(to go)
shko-fsha
shko-fsh
shko-ftë
shko-fshim
shko-fshi
shko-fshin

Verb stems ending with
a consonant:

(to open)
hap-sha
hap-sh
hap-te
hap-shim
hap-shi
hap-shin

The present perfect is formed with the optative of either "to have" or "to be" plus the participle of the verb you wish to use.

Examples:

(to have + wash)

paça lá
paç lá
pastë lá
paçim lá
paçi lá
paçin lá

(to be + wash)

qofsha lá
qofsh lá
qoftë lá
qofshim lá
qofshi lá
qofshin lá

The present optative for a few verbs is formed by adding the endings sha, sh, të, shim, shi, shin to the participle.

Example:

(to receive, etc.)

marr-sha
 marr-sh
 marr-të
 marr-shim
 marr-shi
 marr-shin

A REVIEW OF THE FORMATION OF CONDITIONAL SENTENCES

In Lesson 58, you learned two forms of conditional sentences: one with the conjunction në followed by a verb in the optative; and another with the conjunction po plus a verb in the simple past.

There are at least three more conjunctions that can be used to form the conditional: në goftë se, po të, po qe se. All five of the conjunctions used in conditional sentences mean "if" in English.

Examples:

1. Në goftë se shkoj do t'a marr me vete. (The verb in present indicative.)
2. Po qe se shkoj do t'a marr me vete. (The same as the above.)
3. Po të shkoj do t'a marr me vete. (The verb in subjunctive.)
4. Po shkojë do t'a marr me vete. (The verb in the simple past.)
5. Në shkufsha do t'a marr me vete. (The verb in the optative mode.)

The meaning of each of these examples is the same: "If I go, I will take him/her/it with me."

Dy gjuetarë kishin ndigjue se, afër disa kënetave, rranzë një pylli, sillesh një arf. Porositën fishekë të posaçëm me më shumë barut e me plumba të mëdhaj, dhe një ditë prej ditësh u-nisën për t'a vrá harushën.

Rrugës, njëni prej tyre tha: "Posa t'a shof harushën do t'a qëlloj, do t'a vras dhe me lëkurën e saj do të bëj një gunë të trashë". Tjetri i u-përgjegj: "Po e vrava unë, do t'a shes lëkurën e ariut dhe me të hollat që do të marr do të shkoj me u-dëfrye".

Kështu, tue bisedue, mbasi kaluen disa kaçuba, morën një kthesë ku filluen të duken gjurmët e harushës. Ulën mauzeret që kishin krah-e-qafë, hoqën sigurecat dhe filluen me përgjue, në se po ndihesh harusha tue ecë. Mbas pak minutash, panë tue dalë nga një hendek, harushën që dojshin t'a vritshin. Nga frika filluen të dridhen. Ariu, mbasi u-suell pak, mori drejtim kah ishin ata.

Atëherë, ai që donte me e shitë lëkurën, hodhi pushkën, përdhë dhe me vrap u-ngjit në një pemë. Tjetri, tue mos pasë ku me hypë as ku me u-fshehë, u-kujtue se ariu nuk i nget njerzit e vdekun, prandej u-shtri për tokë dhe s'po merrte frymë. Ariu i u-afrue, i u-suell rrotull dhe mbasi nuhati pak mbi fytyrën e tij, vijoi udhën.

Mbasi u largue ariu, të dyve u doli frika; ai që ishte ngjité në pemë zbriti poshtë dhe ai që ishte shtri përdhë u-çue më kambë. Gjuetari që qe nalt në pemë e pyeti shokun

e tij: "Ç'të tha ariu në vesh?" - "Më tha shumë gjâna" i u-përgjegj tjetri "por nuk i mbáj në mend të gjitha. Sido që të jetë, këto dy gjâna i mbaj në mend me siguri. Në veshin e djathtë më tha se nuk duhet me e shitë lëkurën e ariut para se me e vrá; në veshin e majtë m'u-ankue tue thânë se ai që e lë shokun e tij në baltë âsht njeri i lig".

QUESTIONS - PYETJE

Kush kishte ndigjue se afër disa kënetave, rranzë një pylli, sillesh një arí? Çka kishin ndigjue dy gjuetarë? Ku sillesh ariu për të cilin kishin ndigjue gjuetarët? Cilët porositën fishekë të posaçëm me shumë barut e me plumba të mëdhaj? Çfarë fishekësh porositën? Cilët u-nisën një ditë prej ditësh për t'a vrá harushën? Çka bânë dy gjuetarët një ditë prej ditësh? Kur u-nisën dy gjuetarët? Cili prej tyre tha: "Posa t'a shof harushën do t'a qëlloj, do t'a vras dhe me lëkurën e saj do të bâj një gunë të trashë"? Çka tha njëri prej tyre? Çka do t'i bânë ariut njëri prej tyre, posa t'a shifte? Kur do t'a qëllonte harushën? Çka do të bântë me lëkurën e saj? Kush i u-përgjegj: "Po e vrava unë, do t'a shes lëkurën dhe me të hollat që do të marr do të shkoj me bâ qejf"? Çka do të bânë tjetri me lëkurën e harushës? Çka do të bânë me të hollat që do të merrte? Cilët mbasi kaluen disa kaçuba, morën një kthesë ku filluen të duken gjurmët e harushës? Çka filloi të duket mbasi dy gjuetarët morën një kthesë? Çka i bânë mauzeret që i kishin krah-e-qafë? Ku i kishin mauzeret

kur filluen të duken gjurmët e ariut? Mbasi u a hoqën sigurecat çka filluen me bâ? Çka po ndihesh tue ecë kur filluen me përgjue? Pse filluen dy gjuetarët me përgjue? Mbas pak minutash çka panë tue dalë nga një hendek? Prej nga e panë tue dalë harushën që dojshin t'a vritshin? Çka filluen me bâ nga frika? Pse filluen të dridhen? Në drejtim të kujt shkoi ariu, mbasi u-suell pak? Çka bâni ariu? Atëherë, çka bâni ai që donte me e shitë lëkurën? Çka hodhi përdhë e ku u-ngjiti me vrap? Qysh u-ngjiti në një pemë ai që donte me e shitë lëkurën e ariut? Kush u-kujtue se ariu nuk i nget njerzit e vdekun? Çka i rá në mend gjuetarit tjetër? Prandej, tue mos pasë se ku me u-fshehë, ku u-shtrif tue ndejtë pa marrë frymë? Çka bâni gjuetari i dytë, mbasi i rá në mend se ariu nuk i nget njerzit e vdekun? Pse u-shtrif tjetri përdhë? Kush i u-afrue atij që u-shtrif përdhë? Çka bâni ariu mbasi i u-suell rrotull dhe mbasi nuhati mbi fytyrën e tij? Çka bâni ariu mbasi i u-afrue? Cilëve u doli frika mbasi u-largue ariu? Kur u doli frika dy gjuetarëve? Cili zbriti poshtë e cili u-çue më kambë? Çka bâni ai që ishte ngjite në pemë dhe çka bâni ai që ishte shtrif përdhë? Kush e pyeti shokun e tij: "Çka të tha ariu në vesh"? Ç'e pyeti shokun e tij ai që qe nalt në pemë? Sa gjâna i kishte thânë ariu atij që qe shtrif përdhë? Kujt i kishte thânë ariu shumë gjâna? A i mbante në mend të gjitha? Kush nuk i mbante në mend të gjitha? Sa gjâna mbante në mend me siguri? Kujt i kishte thânë ariu në veshin e djathtë se nuk duhet me e shitë lëkurën e ariut para se me

e vrá? Çka i kishte thënë ariu në veshin e djathtë njânit gjuetar? Në cilin vesh i kishte thënë se ai njeri që e lë shokun e tij në baltë është njeri i lig? Çka i kishte thënë ariu në veshin e majtë? Çfarë njeriu është ai që e lë shokun e tij në baltë?

Ku gjinden kënetat përgjithësisht, ndër male a ndër fusha? A është i pijshëm uji i kënetave? A është mauzeri një lloj pushke gjermane? A mund të shtini me pushkë po mos t'i a keni hjekë sigurecën? A kanë rrugët zakonisht, hendeqe anash? Çka kanë rrugët zakonisht, anash? A ka shumë baltë ndër fusha kur bje shí? A është ariu një kafshë e egër? A bëjnë të gjitha kafshët këlyshë? Njerzit vdesin, po për kafshët si thomi? A ngordhin edhe shpendët? Thoni emnat e dy poleve? Me se janë të mbuluem shpendët? Po kafshët, me çka janë të mbulueme? Kur udhëtoni, a ju pëlqen me u-ndalë rrugës?

- A. Translate the following sentences into Albanian:
1. There are a lot of bears on the high mountains of Albania.
 2. I don't know for sure, but I think he had a cloak on.
 3. He breathed two or three times and then died.
 4. An honest man never leaves his friend in the lurch.
 5. I don't know why she was so angry.
 6. He is a very wicked man.
 7. We all lay on the ground.
- B. Use three of the five "ifs" mentioned in the Grammar Notes of this lesson to translate into Albanian the following conditional sentences:
8. If I know it, I'll tell you.
 9. If she knows it, she will tell me.
 10. If they know it, they will tell us.

anash	(adv.)	on the sides
me u-ankue (unë ankohe)	(v.)	to complain
ari, -u arij, -t	(m.)	bear
barut, -i	(m.)	gunpowder
befas	(adv.)	suddenly, unexpectedly
gjurmë, -a gjurmë, -t	(f.)	trace, track; footprint
harushë, -a harusha, -t	(f.)	bear
hendek, -u hendeqe, -t	(m.)	ditch
kaçubë, -a kaçuba, -t	(f.)	bush, shrub
me kafshue (unë kafshoj)	(v.)	to bite
këlysh, -i këlyshë, -t	(m.)	the young of a carnivorous animal
kënetë, -a këneta, -t	(f.)	swamp
mauzer, -i mauzere, -t	(m.)	rifle
i, të murmë e, të murme	(adj. m.&f.)	dark gray
me ngordhë (unë ngordh)	(v.)	to die (for animals)
me nuhatë (unë nuhas)	(v.)	to sniff
me përdorue (unë përdoruj)	(v.)	to use

plumb, -i plumba, -t	(m.)	bullet; lead
pol, -i pole, -t	(m.)	pole
polár, -e	(adj. m.&f.)	polar
me preferue (unë preferoj)	(v.)	to prefer
me qëllue (unë qëlloj)	(v.)	to shoot; to hit, strike; to happen
qime, qimja qime, -t	(f.)	hair, whisker; fur
racë, -a raca, -t	(f.)	race; breed
rranzë	(adv.)	at the base (of a wall); at the foot (of a hill, mountain)
rrotull	(adv.& prep.)	around
sigurecë, -a sigureca, -t	(f.)	safety catch; fuse
me u-sjellë (unë sillem)	(v.)	to turn oneself; to behave; to wander; to be turned, revolved, rotated
me sulmue (unë sulmoj)	(v.)	to attack
shasme, shasmja shasme, -t	(f.)	pellet
shepkë, -a shepka, -t	(f.)	woodcock
udhë, -a udhë, -t	(f.)	way, street, road, highway
me vrap	(adv.)	in a hurry

Shënime:

U doli frika.

They were not scared
anymore.


krah-e-qafë

slung over the
shoulder

me lânë në baltë
(unë lâ në baltë)

(v.)

to leave in the
lurch; to leave
someone holding
the bag



Berat.

Pjerini

1. Si e ke emnin, çun i vogël? Pjerin.
2. Ku është shtëpia jote? Ajo është shtëpia ime; në shtëpinë time ka një kopsht të madh me gjithfarë pemësh e bimësh.
3. Po e shof. Paska pjeshka, fiq, hardhi, bërë e lule! Shelqet që janë në kopshtin tim janë plot me çerdhe e ndër to ka edhe zogj të vogjël që çercërisin gjithë ditën.
4. Ashtu? Shtëpia jote qenka një parajsë e vërtetë! A të do fort nëna? Unë nuk kam nënë; nëna më ka vdekë kur kam qenë shumë i vogël.
5. Me kë jeton ti Pjerin? Me gjyshin dhe gjyshen. Unë i dua shumë ata.
6. E besoj. A ke ndonjë vllë a motër? Po, kam dy vllazën, por prej babe. Ai është i martuem dhe nuk banon me mue.
7. Kush t'a ka falë at biçikletë? Baba. Vjen shpesh me më për dhe sa herë që vjen më bje nga një peshqesh.
8. Ti qenke, me të vërtetë, një fëmijë i lumtun! Po, por do të dojshem të kishem edhe unë nënë si të gjithë fëmijët tjerë.
9. Mos u-trishto! Askush në botë nuk i ka të gjitha. A shkon përditë në shkollë? Po, jam në klasën V dhe jam i pari i klasës. Si e shef, jam edhe shumë modest!
10. Çka ke qejf me studjue kur të rritesh? Nuk e di ende; unë dishroj të bëhem pilot, por gjyshi thotë se është më mirë me studjue për mjek.

THE INDICATIVE IMPERFECT TENSE: FOR TELLING STORIES

In Lessons 32 (Volume III) and 44 (Volume IV), we explained most functions of the imperfect tense in Albanian: among them the habitual or repeated action in the past without indication of its beginning or ending. If you put a date or time of occurrence on an action, then you cannot use the imperfect. You must use the past tense.

Another important use of the imperfect not covered previously is in story-telling. The imperfect tense is used often to start a story, describe an incident or event (true or fictitious), as well as in narrative descriptions.

If you don't know the imperfect in Albanian, you won't be able to tell stories, describe events, or tell about something that happened to you repeatedly in the past. This last use corresponds to the English phrase "I used to."

Kur leu Pjerini, e âma i vdiq.

Mbas nji vjeti i ati u-martue prap, e Pjerinin e mori gjyshi në shtëpi të vet.

Shtëpia ishte e madhe e kishte edhe nji kopsht të madh krejt veshë në blerim me gjithfarë bimësh e landësh.

Në kët kopsht kishte pjeshka, fiq, hardhi e shumë pemë tjera të frytshme; nën disa shelqe shushuritte uji i nji kroi të freskët e mbi të gjitha këto pemë gjindeshin shumë çerdhe me zogj të vogjël që çercëritshin qetas e âmbël, dhe an'e kand shifeshin tue fluturue, nëpër bâr e lule më lule, flutura që i kishin krahët me mija ngjyrash.

Ai kopsht i madh me at blerim aq të kândshëm ishte përnjimend nji parriz për Pjerinin; dhe ky ishte shumë i kënaqun. Por kush do t'a ushqente? Nji dhí u-bâ si nânë për tē; e për vllá gjiu pati nji edh të bukur.

Edhi kishte nisë me u-rritë e hidhesh e bridhte nëpër bâr të njomë. Edhe çuni i vogël deshi t'ecte; dhe bāni të parin hap, e mbas të parit deshi të bānte edhe nji tjetër, dhe prap nji tjetër. Gjyshi i rrinte gjithnji afër. "Ruhu se rrëzohe", i thonte, dhe i vīnte rreth e i flitte e qeshte me tē.

Ndërkaq i ati i Pjerinit jetonte me gruen tjetër, dhe i kishte falë Zoti nji fëmijë. Pjerini nuk dinte gjā për të vllán; kishte gjyshin e vet e ishte i lumtun.

Nji mbrāmje gjyshi vdiq.

Shpesh, plaku i shkretë, tue e ndie veten të lodhun, i kishte thënë: "Pjerin, shpejt do të vdes. Të shkretin gjysh që të do kaq fort, s'ke për t'a pasë më".

Por çuni i vogël nuk kuptonte e qeshte; e kur e pá gjyshin të vdekun, kujtoi se ishte tue fjetë, dhe kur e çuen ndër vorre, shikonte me sÿ të habitun arkivolin ku e kishin ndrÿ, e nuk kuptonte, nuk dinte gjâ...

Shpejt mbas vdekjes së gjyshit, pá tue hÿ në shtëpí një burrë të panjoftun; ishte i ati; e mandej një grue me një foshnje ngrykë. Ai fëmijë ishte i vllai. Pjerini gjeti një ndryshim të madh tue pá një nânë me një zemër plot dashuní për foshnje të vet, por me një zemër guri për fëmijën e një tjetre.

Njerka nuk e donte aspak; nuk mund t'a shifte.

Të shkretin Pjerin, që e kishin dashë e përkëdhelë aq fort, tashti e kishin lânë në një anë; i bërtitshin gjithnji, e rrihshin pa prâ. Kishte qenë një engjull për gjyshin e vet, kurse për njerkën ishte një dreq.

E sa herë qau vetëm në një skaj pa e ndigjue kurrkush!

Askush nuk kujdesesh më për të, as i ati. Hante në një skaj krejt vetëm. Në mbrâmje e merrte gjumi me sÿ mbushë me lot; në mëngjes i çelte të kuqun prej vajit.

Një mbrâmje Pjerini u-zhduk. Ku kishte vojtë?

Ishte dimën; jashtë binte borë pa prâ e i kishte mbulue të gjitha rrugët e të gjitha fushat. E kërkuen për një copë herë, dhe e gjetën vetëm në mëngjes.

Pjerini kishte vojtë ndër vorre. Ishte shtrî përpara derës e ishte ngrî prej të ftohtit, mbasi e kishte gjetë mbyllë derën e vorrezavet.

E kishte marrë gjumi pak hapa larg gjyshit të vet dhe mâ në fund kishte vdekë në mes të borës.

QUESTIONS - PYETJE

Kush vdiq kur leu Pjerini? Kush leu, kur vdiq nâna e Pjerinit? Çka bâni i ati mbas një vjeti? Kush u-martue prap mbas një vjeti? Kê mori gjyshi në shtëpî të vet? Kush e mori Pjerinin në shtëpî të vet? Çka bâni gjyshi? Shtëpija e kujt ishte e madhe e kishte edhe një kopsht të madh krejt veshë në blerim? Qysh ishte shtëpija e gjyshit? Kopshti i shtëpîs së kujt kishte gjithfarë bimësh e landësh? Çka kishte kopshti i gjyshit të Pjerinit? Në cilin kopsht kishte pjeshka, fiq, hardhî e shumë pemë tjera të frytshme? Çka kishte në këtë kopsht? Ku shushuritte uji i një kroi të freskët? Çka shushuritte nën disa shelqe? Ku gjindeshin shumë çerdhe me zogj të vogjël? Çka gjindesh mbi të gjitha këto pemë? Cilët cërçeritshin getas e âmbël? Ku shifeshin flutura tue fluturue nëpër bâr e lule më lule? Çka shifesh an'e kand tue fluturue nëpër bâr e lule më lule? Qysh i kishin fluturat krahët? Çka kishin me mija ngjyrash fluturat që fluturojshin nëpër bâr e lule më lule? Çka ishte për Pjerinin ai kopsht i madh me at blerim aq të kândshëm? Për kê ishte një parajsë ai kopsht i madh me at blerim aq të kândshëm? Kush ishte shumë i

kënaqun? Si çka u-bâ nji dhí për têt? Kush u-bâ si nânë për têt? Kê pati për vllá gjiu? Çfarë edhi pati për vllá gjiu? Ku hidhesh e bridhte edhi që kishte fillue me u-rritë? Çka bante edhi nëpër bâr të njomë? Çka deshi të bante edhe çuni i vogël? Kush deshi t'ecte? Kush bani të parin hap, e mbas të parit deshi të bante edhe nji tjetër, dhe prap nji tjetër? Çka bani çuni i vogël? Kujt' i rrinte gjyshi gjithnji afër? Kush i vinte rreth e i flitte e qeshte me têt? Çka bante gjyshi? Ndërkaq kush jetonte me gruen tjetër? Me kê jetonte ndërkaq i ati i Pjerinit? Çka i kishte falë Zoti? Sa fëmijë i kishte falë Zoti? Kush nuk dinte gjâ për të vllán? Për kê nuk dinte gjâ Pjerini? Kê kishte Pjerini e ishte i lumtun? Kush vdiq nji mbrâmje? Çka ngjau nji mbrâmje? Kur i kishte thânë, plaku i shkretë: "Pjerin, shpejt do të vdes. Të shkretin gjysh që të do kaq fort, s'ke për t'a pasë mâ"? Çka i kishte thânë shpesh plaku i shkretë, tue e ndie veten të lodhun? Kush nuk kuptonte e qeshte? Çka bante çuni i vogël? Çka kujtoi kur e pá gjyshin të vdekun? Kush kujtoi se ishte tue fjetë kur e pá gjyshin të vdekun? Çka kujtoi çuni i vogël? Çka shikonte Pjerini me sÿ të habitun? Si e shikonte Pjerini arki-volin ku e kishin ndrÿ plakun? Kush nuk kuptonte e nuk dinte gjâ? Kê pá tue hÿ në shtëpí, shpejt mbas vdekjes së gjyshit? Ku pá tue hÿ nji burrë të panjoftun, shpejt mbas vdekjes së gjyshit? Kush ishte ai burrë? Kush pá mandej nji grue me nji foshnje ngrykë? Kê pá mandej Pjerini? Kush ishte ai fëmijë? Cili fëmijë ishte i vllai? Kush gjeti nji ndryshim të madh

tue pá nji nânë me nji zemër plot dashuní për foshnje të vet,
 por me nji zemër guri për fëmijën e nji tjetre? Kush nuk e
 donte aspak Pjerinin? Kë nuk donte njerka aspak? Cila nuk
 mund t'a shifte? Ku e kishin lânë tash të shkretin Pjerin
 që e kishin dashë e përkëdhelë aq fort? Kë kishin lânë në
 nji anë? Kujt i bërtitshin gjithnji? Kë rrihshin pa prâ?
 Kush kishte qenë nji engjull për gjyshin e vet? Çka kishte
 qenë Pjerini për gjyshin e vet? Çka ishte Pjerini për njer-
 kën? Kush ishte nji dreq për njerkën? Kush qau sa herë ve-
 tëm në nji skaj pa e ndigjue kurrkush? Çka bëni sa herë vetëm
 në nji skaj pa e ndigjue kurrkush? Kush nuk kujdesesh më për
 të? Çka nuk bënte as i ati? Çka bënte në nji skaj krejt
 vetëm? Ku hante krejt vetëm? Kë merrte gjumi në mbrâmje me
 sÿ mbushë me lot? Qysh e merrte gjumi në mbrâmje? Kur i çel-
 te sÿt të kuqun prej vajit? Qysh i kishte në mëngjes sÿt?
 Çka bëni Pjerini nji mbrâmje? Kur u-zhduk Pjerini? Çka binte
 jashtë pa prâ e i kishte mbulue të gjitha rrugët e të gjitha
 fushat? Qysh binte borë përjashta? Kë kërkuen për nji copë
 herë? Për sa kohë e kërkuen? Kur e gjetën? Kë gjetën vetëm
 në mëngjes? Ku kishte vojtë Pjerini? Kush kishte vojtë ndër
 vorreza? Çka kishte bâ përpara derës e ishte ngrí prej të
 ftohtit? Mbasi kishte gjetë mbyllë cilën portë ishte shtrí
 dhe ishte ngrí prej të ftohtit? Kë kishte marrë gjumi pak
 hapa larg gjyshit të vet? Ku e kishte marrë gjumi Pjerinin?
 Dhe, çka i kishte ngjá më në fund? Kush kishte vdekë në mes
 të borës?

Translate the following sentences into Albanian:

1. I'm afraid that he'll forget because he is absentminded.
2. He lives (together) with his grandparents (grandfather and grandmother) and his stepmother.
3. Slow down, please; the road is full of rocks.
4. He got married yesterday.
5. We were tired and thirsty; but fortunately we found a spring from which we drank a lot of cold water.
6. When she was a child, she used to eat a lot of sweets.
7. When I was much younger, I didn't shave (didn't use to shave) every day.
8. Do you know how to ride a bicycle? (Use the verb "to drive.")
9. I fell from the tree and broke my hand.
10. Did you lock the door?

âmbël	(adv.)	sweetly
an'e kand	(adv.)	throughout
arkivol, -i arkivola, -t	(m.)	coffin, casket
biçikletë, -a biçikleta, -t	(f.)	bicycle
blerim, -i	(m.)	greenness
me cërcëritë (cërcërit)	(v.)	to chirp
dreq, -i dreqën, dreqnit	(m.)	devil
edh, -i edha, -t	(m.)	kid (the young of the goat)
engjull, -i engjuj, -t	(m.)	angel
flutur, -a flutura, -t	(f.)	butterfly
i, të frytshëm e, të frytshme	(adj. m.&f.)	fruit-bearing; fruitful; fertile
të ftohët, të ftohtit	(neuter)	cold (weather)
gjysh, -i gjysha, -t	(m.)	grandfather
i, e, të habitun të habituna	(adj. m.&f.)	distracted; absent- minded
hardhí, -ja hardhí, -t	(f.)	grapevine
krue, kroi kroje, -t	(m.)	spring (source of water)
i, e, të kuqun të kuquna	(adj. m.&f.)	reddened; roast, roasted
lot, -i lot, -ët	(m.)	tear

i, e, të lumtun të lumtuna	(adj. m.&f.)	happy
me ndrÿ (unë ndrÿj)	(v.)	to lock
ndryshim, -i ndryshime, -t	(m.)	difference; change
me u-ngrî (unë ngrîhem)	(v.)	to be frozen; to get stiff
njerkë, -a njerka, -t	(f.)	stepmother
parajsë, -a	(f.)	paradise
parriz, -i	(m.)	paradise
me përkëdhelë (unë përkëdhel)	(v.)	to caress, fondle; to pamper, spoil
përnjimend	(adv.)	really, indeed
pilot, -i pilotë, -t	(m.)	pilot
prap	(adv.)	again
qetas	(adv.)	quietly, peaceably
me u-rrëzue (unë rrëzohem)	(v.)	to fall down; to crash (for an airplane); to be toppled
skaj, -i skaje, -t	(m.)	corner; tip; term
shelk, -u shelqe, -t	(m.)	willow tree
me shushuritë (shushurit)	(v.)	to murmur, gurgle (for water only)
me u-trishtue (unë trishtohem)	(v.)	to be sad
me ushqye (unë ushqej)	(v.)	to feed, nourish; to harbor
vorreza, -t	(f.)	cemetery, graveyard

Shënime:

nji copë herë

little while

I kishte falë zoti një fëmijë.

God had presented
him with a child.

E kishin lënë në një anë.

They had neglected
him.

i vinte rreth

looked after him

vllë gjiu

brother



RAPSODI POPULLOR

Vera

1. Mirë mëngjes! Ç'të ka ngjã sot që je çue kaq heret? Mirë mëngjes! Po tÿ ç'të ka ngjã që je zgjue kaq heret?
2. Je gabim; në verë unë zgjohem përherë pa lé dielli dhe vëhem me punue në kopsht. Ashtu? Sa herë e kam pyetë veten se si është e mundun që ti e ke kopshtin gjithmonë të pastër e në rregull. Punueke në mëngjes!
3. Rregulloj dhe ujis këto pak lule që kanë mbetë, si edhe barin e pemët. Ke të drejtë. Ditën s'është e mundun me punue në kopsht, sepse dielli të përcëllon.
4. Asht e pamundun me ndejtë në diell. Përveç të tjerave, unë djersem jashtëzakonisht shumë. Unë nuk djersem shumë, por e ndiej vetën të plogët në verë e nuk kam aspak dëshirë për punë.
5. Pak a shumë kjo gjã u ngjãn të gjithëve. Sidoqoftë na duhet të jemi të lumtun sepse jemi afër detit. Asht e vërtetë! Vendet që janë mã larg nga deti kanë vapë të padurueshme; atje nuk frÿn erë pothuejse kurrë.
6. Ku do të shkojsh për pushime sivjet? Në mal. Fëmijvet nuk u bënë mirë vjet banjat e detit; prandej vendosa t'i dërgoj në bjeshkë.
7. Kur ke vendosë të shkojsh? Sot, prandej jam zgjue pak mã heret. Do të nis me tren gruen dhe fëmijët.
8. Po ti? Unë do të shkoj mbas nji mueji për nja 10 ditë.
9. Pse kaq pak? Sepse vjet e shpenzova të gjithë lejen që kishem mbledhë; sivjet s'kam mã shumë se 10 ditë.
10. A është e kënaqun grueja që po shkon në bjeshkë? Jo fort! Asaj nuk i pëlqen jeta monotone e bjeshkëvet, por po shkon për hatër të shëndetit të fëmijëvet.

11. Të fala zojës dhe të gjithëve u qoftë udha e mbarë!

Të falem nderit. Tash që do të jesh vetëm do të vij në mbrëmje me të bezdisë më shpesh.

12. Mirë se të vijsh! Do të më bëhet qejfi me ndejtë së bashku pak më shpesh.

Të mirë u-pafshim!



«THE ALBANIAN JEANNE D'ARC»

ALBANIAN IDIOMS

A Brief definition: the idiom is a word or an expression that cannot be translated verbatim into another language because it would be meaningless as a whole. In order to learn an idiom, one has to memorize the expression and its meaning.

The more idioms a language has, the more effort is involved in learning that language. It is also a reason why a language may be considered a "difficult" one to master.

Naturally Albanian has idioms, but it has fewer than many other languages. So we dare say that this is one reason why Albanian is not considered difficult to learn.

Today's lesson has a few idioms, such as me (më, të, i etj.) bâ mirë, keq (qjella, pija etj.), me i u-shtrua punës, i a therret kângës, me u-vû me punue, etc. If you translate these expressions word-for-word into English, they mean nothing. You have to memorize the idiom and its meaning.

In previous lessons, we have given you some idioms, but only a few because there are not very many.

Në verë ditët janë të gjata dhe netët të shkurta; dielli shëndrit mja shumë.

Në mëngjes ajri është i freskët, zogjt këndojnë, lulet e gjethët tregojnë gjallëni; por, tue kalue dita shtohet vapa, atëherë edhe zogjt fshehen nëpër degët e pemëve e pushojnë së kënduari. Lulet kërrusen, kafshët lëvizin me përtim, u merret fryma, i merr eti e rendin shpesh nëpër ujënat e ftofta të burimeve e të lumenjve që të shuejnë etin. Njerzit i përtojnë punës, janë të plogët e djersen. Të gjithë sa jetojnë e lëvizin u fshehen rrezet të diellit që përcëllojnë. Vetëm gjinkalla i a thërret këngës pa i a dë, deri sa pëlçet.

Në kohë të mbrëmjes, kur fillon dielli t'i thyejë rrezet e veta, vapa pakësohet, zogjt çohen përsëri fluturim e me harë mbledhen nëpër gardhiqe e nëpër degët e pemëve; lulet drejtohen e kafshët dalin nga skutat e hijet e freskëta për të kullotë nëpër livadhe. Njerzit i mbushin rrugët përsëri, shlodhen buzës së detit, tue u-kënaqë prej ajrit të tij.

Prendimi i diellit ka një pamje të mrekullueshme. Edhe mbrëmja është e bukur: një mori hyjsh e mbulon hapsinën e qiellit, tue shëndritë e xixëllue si margaritarë. Hana, me dritën e saj t'ambël, ndrit e gëzon gjithë dhën.

Në verë pyjet e shpeshta e buzët e lumenjve gjelbërojnë me gjethët e njomë, por fushat thahen, verdhen e zhariten; arat mbushen me grunë, misër, elb, tërshanë, pambuk etj. Këtu bujqat përgatiten për korrje e për të mbushë grunarët

plot me të lashta. Gjatë kësaj stine gjithë frymorët i shtrohen punës; mbi të gjithë dallohen për zëll e aktivitet bu-burrecat, bletët e insektet tjerë.

QUESTIONS - PYETJE


Si janë ditët në verë? Kur janë ditët të gjata dhe netët të shkurta? Çka bân dielli m̄a shumë? Qysh është ajri në mëngjes? Kur është ajri i freskët? Cilët këndojnë? Çka bëjnë zogjt? Çka tregojnë lulet e gjethët? Por, tue kalue dita çka shtohet? Kur shtohet vapa? Atëherë ku fshehen zogjt? Çka bëjnë atëherë zogjt nëpër degët e pemëvet? Cilët pushojnë së kënduemi? Çka bëjnë lulet? Cilat kërrusen? Qysh lëvizin kafshët? Pse u merret fryma? Ku rendin shpesh që të shuejnë etin? Qysh janë ujënat e burimevet e të lumejvet? Cilët i përtojnë punës, janë të plogët e djersen? Çka bëjnë njerzit? Cilave rreze u fshehen të gjithë sa jetojnë e lëvizin? Cilët u fshehen rrezet të diellit që përcëllojnë? Çka bân gjinkalla deri sa pëlçet? Cila i a thërret këngës deri sa pëlçet? Çka ngjân në kohë të mbrëmjes, kur fillon dielli t'i thyejë rrezet e veta? Kur pakësohet vapa? Çka bëjnë zogjt përsëri e me harë mblidhen nëpër gardhiqe e nëpër degët e pemëvet? Cilët çohen përsëri fluturim e me harë mblidhen nëpër gardhe e nëpër degët e pemëvet? Çka bëjnë lulet? Prej nga dalin kafshët për të kullotë nëpër livadhe? Ku kullosin kafshët që dalin nga skutat e hijet e freskëta? Cilët i mbushin rrugët përsëri? Çka bëjnë njerzit?

Ata shlodhen buzës së detit tue u-kënaqë prej cilit ajër?
 Çka bājnë njerzit buzës së detit tue u-kënaqë prej ajrit të
 tij? Çfarë pamje ka prendimi i diellit? Çka ka një pamje
 të mrekullueshme? Si është mbrëmja? Çka mbulon një mori
 hyjsh? Sa hyj e mbulojnë hapsinën e qiellit? Cilët shëndri-
 sin e xixëllojnë si margaritarë? Qysh shëndrisin e xixëllojnë
 hyjt? Çka ndrit e gëzon gjithë dhën me dritën e saj t'ambël?
 Çka bān hāna me dritën e saj t'ambël? Në cilën stinë gjelbë-
 rojnë pyjet e shpeshta e buzët e lumejvet? Cilat thahen,
 verdhen e zhariten? Çka u ngjān fushavet në verë? Kur tha-
 hen, verdhen e zhariten fushat? Cilat mbushen me grunë, mi-
 sër, elb, tērshanë, pambuk etj.? Me çka mbushen arat? Kush
 përgatitet për korrje e për të mbushë grunarët plot me të
 lashta? Çka bājnë bujq? Çka bājnë gjithë frymorët gjatë
 kësaj stine? Cilët i shtrohen punës gjatë kësaj stine? Cilët
 dallohen mbi të gjithë? Për çka dallohen mbi të gjithë bu-
 burrecat, bletët e insektet tjerë?

A bje shumë borë në dimën ndër bjeshkë? Ku bje shumë borë
 në dimën? A është gjinkalla një insekt? Çka është gjinkalla?
 A ka qenë moti kët verë jashtëzakonisht i bukur? Kur ka qenë
 moti jashtëzakonisht i bukur? Çka hani mā fort: bukë misri,
 apor bukë gruni? A keni pā nën pemë një mori buburrecash?
 Ku keni pā një mori buburrecash? A janë gjethët e asaj peme
 të shpeshtë? Gjethët e cilës pemë janë të shpeshtë? A keni
 hangër ndonjiherë bukë tērshane? Kush e ujit barin e kopshtit
 tuej? Barin e cilit kopsht ujitni ju?

Translate the following sentences into Albanian:

1. He distinguished himself on the battlefield.
2. Last year they planted only corn on that farm.
3. A crowd had gathered in front of the building.
4. His behavior is unbearable.
5. It's impossible to walk (to go on foot).
6. I always go by bus.
7. When I told him that he wasn't right, he became pale.
8. The way he walks looks very clumsy.
9. I told you not to bother him.
10. Would you mind closing the window, please?



Vizatim nga Guljem Mosi

PJESA E PESTË
FJALORI

LESSON 90
PART V
VOCABULARY

me bezdisë (unë bezdis)	(v.)	to bother
bjeshkë, -a bjeshkë, -t	(f.)	a high mountain with grazing land
buburrecë, -a buburreca, -t	(f.)	ant
me u-djersë (unë djersem)	(v.)	to perspire, sweat
elb, -i	(m.)	barley
et, -i	(m.)	thirst
gardh, -i gardhe, -t gardhiqe, -t	(m.)	fence
me gëzue (unë gëzoj)	(v.)	to make someone happy; to enjoy (life, etc.)
me gjelbërue (gjelbëron)	(v.)	to turn green
gjinkallë, -a gjinkalla, -t	(f.)	cricket (cicada)
haré, -ja	(f.)	joy, happiness
insekt, -i insekte, -t	(m.)	insect
të kënduem, -it	(neuter)	singing; reading
me u-kërrusë (unë kërrusem)	(v.)	to bend oneself; to stoop; to droop
korrje, -a korrje, -t	(f.)	harvesting, harvest
të lashta, -t	(f.)	grains (wheat, oats, etc.) not yet harvested
me u-mbushë (mbushet)	(v.)	to be filled (out)

monoton, -e	(adj. m.&f.)	monotonous
morí, -ja	(f.)	swarm; crowd, mass
me ndritë (unë ndris)	(v.)	to shine; to illuminate
me nisë (unë nis)	(v.)	to send, dispatch; to start
përherë	(adv.)	always, all the time
i, të padurueshëm e, të padurueshme	(adj. m.&f.)	unbearable; impatient
me u-pakësue (paksohet)	(v.)	to diminish, lessen; to reduce
i, e pamundun	(adj. m.&f.)	impossible; indisposed
me pëlcitë (unë pëlcas)	(v.)	to burst; to explode; to crack
me përcëllue (unë përcëlloj)	(v.)	to singe; to scorch
përtim, -i	(m.)	laziness
me përtue (unë përtoj)	(v.)	to feel lazy; to mind
i, e, të plogët të plogta	(adj. m.&f.)	sluggish; clumsy
me rendë (unë rend)	(v.)	to run
skutë, -a skuta, -t	(f.)	corner; nook
shëndet, -i	(m.)	health
me u-shlodhë (unë shlodhem)	(v.)	to relax, rest
me shpenzue (unë shpenzoj)	(v.)	to spend
i, e, të shpeshtë të shpeshta	(adj. m.&f.)	thick; dense; frequent

tërshanë	(f.)	oats
me u-verdhë (unë verdhem)	(v.)	to become pale; to turn yellow; to turn brown (as grass, etc.)
zëll, -i	(m.)	zeal, diligence
me u-zharitë (unë zharitem)	(v.)	to be scorched
<u>Shënime:</u>		
me (më, të, i etj.) bã mirë (keq)	(v.)	to agree (about something) with me, you, him, her, etc.
do të më bâhet qejfi për hatër të...		I'll be pleased, glad for the sake of....
me (më) marrë eti (më merr eti)	(v.)	to be thirsty
me m'u-marrë fryma (më merret fryma)	(v.)	to be out of breath
me qënë gabim (unë jam gabim)	(v.)	to be wrong; to be mistaken
me i u-shtrua punës (unë i shtrohem punës)	(v.)	to start working (hard)
I përtojnë punës.		They don't feel like working.
i a thërret këngës		starts singing
Mirë se të vijsh.		You are welcome.
me u-vû me punue (unë vëhem me punue)	(v.)	to start working